ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – SHSKUK

Për Aktivitetin e Prokurimit: Nr. 220-26-7028-5-1-1dhe numër te brendshëm: 220-26-072-511

Sa i përket tenderit për: "Renovimi i Objektit të Hemodializës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës"

ANKESË

1. **Identifikimi i ankuesit***

Grupi i Operatorëve Ekonomikë EGO ELSA SH.P.K. dhe Horn & Co. Kosova SH.P.K.

Rr. E Pejës, p.nr. Llapllasele,
(Adresa)

Prishtinë 10500

+383(0) 49/230-122 N/A

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

z. Egon Hoti – Drejtor

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

egoelsa.shpk@gmail.com

(Adresa elektronike) *Datë: 23/11/2026*

Në emër të Grupit të OE, nga Lideri i Grupit: EGO ELSA SH.P.K.

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontratë – 20.08.2026
- Hapja e tenderit – 02.10.2026
- Njoftimi mbi vendimin e AK – 13.11.2026
- Kërkesa për Rishqyrtim – 18.11.2026
- Vendimi i AK-së ndakj kërkesës per rishqyrtim - 19.11.2026
- Parashtrimi i ankesës ne OSHP- 23.11.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Jemi njoftuar përmes platforme elektronike te prokurimit publik me hapjen e tenderëve

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Vendimi i autoritetit kontraktues ne raport me kërkesën për rishqyrtim është refuzuar.
Te bashkangjitur ne kete ankesë gjeni vendimin e ndërmarr nga Autoriteti kontraktues

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

I. BAZA LIGJORE E SHKELUR

Në mbështetje të fakteve, dokumentacionit të ofertës dhe veprimeve të ndërmarra nga Autoriteti Kontraktues gjatë procedurës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, grupi i operatorëve ekonomikë pretendon se vendimi për eliminimin e ofertës sonë dhe rekomandimin e një operatori tjetër ekonomik për kontratë cenon dispozitat e mëposhtme ligjore si ne vijim:

A. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik

Neni 1 – Qëllimi

Përcakton qëllimin e LPP-së për të siguruar përdorimin efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike, duke garantuar integritetin dhe përgjegjshmërinë në procesin e prokurimit publik.

Neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti

Obligon autoritetet kontraktuese që fondet publike t'i përdorin në mënyrë sa më ekonomike dhe efikase, duke siguruar vlerën më të mirë për paranë publike dhe duke mos lejuar veprime që cenojnë konkurrencën dhe rezultatet e procedurës.

Neni 7 – Barazia në trajtimin e operatorëve ekonomikë

Kërkon që të gjithë operatorët ekonomikë të trajtohen në mënyrë të barabartë, të drejtë dhe jodiskriminuese. Autoriteti Kontraktues duhet të zbatojë të njëjtat standarde dhe kritere për të gjithë ofertuesit, pa favorizuar apo diskriminuar asnjërin prej tyre.

Neni 10 – Mjetet për promovimin e transparencës

Përcakton detyrimin për transparencë në procesin e prokurimit publik, përfshirë publikimin dhe ofrimin e informatave përkatëse, në mënyrë që procesi të jetë i hapur, i kontrollueshëm dhe i verifikueshëm.

Neni 11 – Informatat sekrete afariste

Rregullon mbrojtjen e informatave që përbëjnë sekrete afariste, duke përcaktuar kufijtë e ruajtjes së konfidencialitetit. Kjo dispozitë nuk duhet të përdoret si arsyetim i përgjithshëm

për të mohuar qasjen në dokumentacionin që nuk i plotëson kushtet ligjore për t'u konsideruar sekret afarist.

Neni 27 – Dosja e tenderit

Përcakton rëndësinë dhe përmbajtjen e dosjes së tenderit, e cila duhet t'i përmbajë kërkesat, kriteret, kushtet dhe specifikimet përkatëse të aktivitetit të prokurimit. Autoriteti Kontraktues është i detyruar të veprojë në përputhje me kërkesat që vetë i ka përcaktuar në dosjen e tenderit.

Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Përcakton detyrimin e Autoritetit Kontraktues që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat ligjore. Vlerësimi duhet të jetë objektiv, profesional dhe i mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë.

Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Rregullon mundësinë e kërkimit të dokumentacionit ose informacionit shtesë nga operatorët ekonomikë, kur kjo është e nevojshme për sqarimin dhe verifikimin e ofertave, në përputhje me kufizimet ligjore. Kjo dispozitë nuk lejon ndryshimin e ofertës apo plotësimin e mangësive thelbësore në kundërshtim me ligjin.

B. Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 7 – Informatat sekrete afariste dhe qasja në dokumentacion

Përcakton se pas publikimit të njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, palët e interesuara kanë të drejtë të kenë qasje në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit. Vetëm informatat që janë klasifikuar dhe pranuar ligjërisht si sekrete afariste mund të mbeten konfidenciale. Autoriteti Kontraktues duhet të mundësojë qasje të shpejtë dhe të arsyeshme në dokumentacionin tjetër të procedurës.

Neni 40 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Përcakton se vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve duhet të bëhet në përputhje me parimet themelore të LPP-së dhe kriteret e përcaktuara paraprakisht në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk mund të ndryshojë, modifikojë, heqë apo shtojë kritere dhe kërkesa gjatë procesit të vlerësimit. Të gjithë operatorët ekonomikë duhet të vlerësohen sipas standardeve të njëjta.

Neni 97, paragrafi 1, nënparagrafi c) – Shkeljet e rënda

E klasifikon si shkelje të rëndë moslejimin ose neglizhimin e qasjes në dokumentet zyrtare, sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesuar, kur kërkesa për qasje është në përputhje me nenet 10 dhe 11 të LPP-së. Kjo dispozitë është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur Autoriteti Kontraktues refuzon ose kufizon pa bazë ligjore qasjen në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

II. Grupi i Operatorëve Ekonomikë **EGO ELSA SH.P.K. dhe Horn & Co. Kosova SH.P.K.**, me lider të grupit EGO ELSA SH.P.K., në cilësinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit me numër **220-26-7028-5-1-1** dhe numër të brendshëm **220-26-072-511**, me objekt të kontratës **"Renovimi i Objektit të Hemodializës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës"**, paraqet këtë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit kundër vendimit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), me të cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim dhe është lënë në fuqi eliminimi i ofertës së Grupit të Operatorëve Ekonomikë.

Pas publikimit të rezultateve të vlerësimit të ofertave, Autoriteti Kontraktues ka vendosur për eliminimin e ofertës së ankuesit, duke u mbështetur në disa konstatime lidhur me përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit për personelin profesional dhe teknik, kualifikimet, përvojën e punës dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur në ofertë.

Duke konsideruar se këto konstatime nuk pasqyrojnë në mënyrë të drejtë dhe të plotë dokumentacionin e dorëzuar, Grupi i Operatorëve Ekonomikë ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, përmes së cilës ka kundërshtuar arsyet e eliminimit dhe ka argumentuar se dokumentet e paraqitura në ofertë dëshmojnë përmbushjen e kërkesave përkatëse të Dosjes së Tenderit.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues, me vendimin e datës **19.11.2026**, e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim, pa i trajtuar në mënyrë të plotë dhe të individualizuar argumentet dhe provat e paraqitura nga ankuesi. Sipas vlerësimit të ankuesit, Autoriteti Kontraktues kryesisht ka përsëritur arsyetimin e vendimit të eliminimit, pa dhënë përgjigje të mjaftueshme për çështjet thelbësore të ngritura në kërkesën për rishqyrtim.

Në thelb, ankesa mbështetet në këto çështje:

1. Vlerësimi i dokumentacionit të ekspertit Suad Bushi

Në ofertë është paraqitur dokumentacioni profesional i ekspertit Suad Bushi, përfshirë diplomën Master në Menaxhimin e Emergjencave, certifikatën e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për Ekspert të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, me vlefshmëri deri më 31.03.2028, certifikatën NEBOSH, CV-në, marrëveshjen e angazhimit dhe listën e stafit. Pavarësisht kësaj, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se nuk është dëshmuar certifikimi përkatës. Ankuesi konsideron se ky konstatim është në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar, pasi certifikata zyrtare e ekspertit të sigurisë dhe shëndetit në punë gjendet në ofertë dhe është dashur të merret parasysh gjatë vlerësimit.

2. Vlerësimi i dokumentacionit të ekspertit Avni Beqiri

Për ekspertin Avni Beqiri është paraqitur diploma Master i Shkencave Teknike, CV-ja dhe dokumentacioni që dëshmon përvojën e punës mbi pesë (5) vjet. Sipas ankuesit, kërkesa e Dosjes së Tenderit për këtë pozitë ka përcaktuar diplomën përkatëse dhe përvojën minimale

të punës, pa kërkuar shprehimisht një certifikatë të veçantë. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur bazë që të kërkojë dokumentacion shtesë që nuk është përcaktuar si kusht në Dosjen e Tenderit.

3. Vlerësimi i dokumentacionit të ekspertit Egon Hoti

Për ekspertin Egon Hoti është paraqitur diploma Bachelor në Inxhinieri të Makinerisë, certifikata e trajnimit nga prodhuesi Medicop për instalimin, servisimin dhe testimin e sistemeve të gazrave medicinale sipas standardit ISO 7396-1, dokumentacioni për përvojën profesionale, referenca që dëshmon pjesëmarrjen në mbi 25 kontrata për sisteme të gazrave medicinale në QKUK/SHSKUK, si dhe certifikata e trajnimit përgatitor 150-orësh për Ekspert të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, së bashku me licencën e ofruesit të trajnimit. Ankuesi konsideron se ky dokumentacion është dashur të vlerësohet në tërësi dhe se Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm lidhur me mospranimin e dëshmive të paraqitura.

4. Vlerësimi i dokumentacionit për shtatë punëtorët teknikë

Në ofertë janë paraqitur kontratat e punës dhe deklarimet përkatëse të Administratës Tatimore të Kosovës për shtatë punëtorët teknikë: Fadil Hoti, Valton Aliu, Avni Hoti, Fledi Hoti, Egon Hoti, Besian Murati dhe Ferid Shabani. Autoriteti Kontraktues ka ngritur çështjen e mospërputhjeve ndërmjet datave të nënshkrimit të kontratave dhe datave të fillimit të marrëdhënieve të punës. Ankuesi konsideron se këto dokumente është dashur të shqyrtohen së bashku, duke marrë parasysh mundësinë e përditësimit ose formalizimit të kontratave të punës, deklarimet zyrtare të ATK-së dhe sqarimet e paraqitura për ndryshimin e mbiemrit të njërit prej punëtorëve. Çdo paqartësi konkrete është dashur të vlerësohet në mënyrë individuale dhe në raport me të gjitha provat në dispozicion.

5. Kufizimi i qasjes në dokumentacionin e ofertës së grupit të rekomanduar për kontratë

Ankuesi ka kërkuar qasje në dokumentacionin e ofertës së grupit të rekomanduar për kontratë, por dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk ka përfshirë disa prej dëshmive thelbësore profesionale dhe teknike, si diplomat, licencat, certifikatat, CV-të, dëshmitë e përvojës, kontratat dhe referencat për punë të ngjashme, si dhe dëshmitë për disponueshmërinë e pajisjeve të kërkuara. Për më tepër, në dokumentacion janë paraqitur deklarata për sekret afarist, përmes të cilave është kërkuar që në mënyrë të përgjithshme i gjithë dokumentacioni i tenderit të trajtohet si konfidencial. Ankuesi konsideron se këto deklarata është dashur të shqyrtohen konkretisht dhe të mos shërbejnë si bazë për kufizimin e përgjithshëm të qasjes në dokumentet që janë relevante për verifikimin e ligjshmërisë së vlerësimit.

6. Mangësitë e raportit të vlerësimit

Gjatë qasjes në dokumentacion, ankuesi ka konstatuar se kopja e raportit të vlerësimit e pranuar në USB nuk përmban nënshkrimet e anëtarëve të komisionit të vlerësimit dhe nuk ofron arsyetim të mjaftueshëm e të individualizuar për mënyrën se si janë verifikuar kërkesat profesionale dhe teknike të grupit të rekomanduar për kontratë. Në këtë kontekst, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe mendimit kundërshtues të anëtarit të komisionit të vlerësimit, të evidentuar në faqen 10 të raportit, ku janë ngritur shqetësime lidhur me dëshmitë për punë të ngjashme në fushën e osmozës dhe dëshmitë për pajisjet e nevojshme për sistemet e gazrave medicinale sipas standardit DIN EN ISO 7396-1. Kjo rrethanë e bën

të domosdoshëm shqyrtimin e dokumentacionit përkatës të grupit të rekomanduar, në mënyrë që të verifikohet nëse kërkesat e Dosjes së Tenderit janë përmbushur.

Përfundimisht, ankuesi vlerëson se gjatë vlerësimit të ofertës së tij dhe trajtimit të kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë një shqyrtim të plotë, objektiv dhe të individualizuar të dokumentacionit dhe argumenteve të paraqitura. Po ashtu, mënyra e kufizimit të qasjes në dokumentacionin e ofertës së rekomanduar dhe mangësitë e konstatuara në raportin e vlerësimit krijojnë nevojën për kontroll të mëtejshëm të ligjshmërisë së kësaj procedure nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Për këto arsye, Grupi i Operatorëve Ekonomikë kërkon nga OSHP-ja që, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të aktivitetit të prokurimit dhe pretendimeve ankimore, të konstatojë ligjshmërinë e veprimeve të Autoritetit Kontraktues dhe të marrë vendim në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Ankuesi kërkon që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe që çështja të kthehet në rivlerësim, me obligimin që Autoriteti Kontraktues të shqyrtojë dokumentacionin e ofertës në tërësi, të zbatojë vetëm kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe të japë arsyetim të plotë për secilin konstatim.

Statusi i operatorit ekonomik si palë me interes

Grupi i Operatorëve Ekonomikë EGO ELSA SH.P.K. dhe Horn & Co. Kosova SH.P.K., në cilësinë e ofertuesit në aktivitetin përkatës të prokurimit, konsiderohet palë me interes juridik dhe ekonomik për të kërkuar rishqyrtimin e vendimit të Autoritetit Kontraktues.

Ky interes buron nga fakti se grupi i operatorëve ekonomikë ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit, ka përgatitur dhe dorëzuar ofertën e tij në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ndërsa më pas është eliminuar nga procedura dhe Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për kontratë një operator tjetër ekonomik.

Rrjedhimisht, vendimi i kontestuar ndikon drejtpërdrejt në të drejtat dhe interesat legjitime të grupit të operatorëve ekonomikë, pasi eliminimi i tij e ka privuar nga mundësia për vazhdimin e pjesëmarrjes në procedurë, vlerësimin e ofertës dhe mundësinë reale për t'u shpërblyer me kontratë.

Për më tepër, grupi ka interes të drejtpërdrejtë në verifikimin e ligjshmërisë, objektivitetit dhe transparencës së procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, përfshirë mënyrën se si janë trajtuar dokumentet dhe dëshmitë e operatorëve të tjerë ekonomikë.

Prandaj, në bazë të pozitës së tij si pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit dhe pasojave të drejtpërdrejta juridike dhe ekonomike të vendimit të kontestuar, grupi i operatorëve ekonomikë ka legjitimitet të plotë për të paraqitur këtë kërkesë ankesë dhe për të kërkuar rivlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të Autoritetit Kontraktues.

Në emër të Grupit të Operatorëve Ekonomikë:

EGO ELSA SH.P.K. – Lider i Grupit

Duke u bazuar në faktet e paraqitura më lart, në dokumentacionin e dorëzuar gjatë procedurës së prokurimit, si dhe në argumentet faktike dhe juridike të elaboruara në këtë

ankesë, Grupi i Operatorëve Ekonomikë EGO ELSA SH.P.K. dhe Horn & Co. Kosova SH.P.K., me lider të grupit EGO ELSA SH.P.K., konsideron se veprimet dhe vendimmarrja e Autoritetit Kontraktues përmbajnë shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik dhe akteve nënligjore përkatëse.

Andaj, në vijim, ankuesi paraqet pretendimet ankimore, përmes të cilave kundërshton vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe argumenton në mënyrë të veçantë shkeljet e pretenduara, duke kërkuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit shqyrtimin dhe vlerësimin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III. PRETENDIMET ANKIMORE

PRETENDIM 1

KUNDËRSHTIM NDAJ ARSYETIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM

Autoriteti Kontraktues, në Vendimin e datës 19.11.2026, është mjaftuar me ripërsëritjen mekanike të arsyetimit të Njoftimit mbi Eliminimin (Formulari B42), duke injoruar provat zyrtare të dorëzuara në ofertë dhe duke lënë plotësisht pa përgjigje pretendime thelbësore juridike dhe faktike të Ankuesit. Më poshtë paraqesim kundërshtimin e arsyetuar ndaj secilit konstatim të AK-së:

1. Kundërshtimi lidhur me pozitën e Masterit të Emergjencave – z. Suad Bushi (Kërkesa 3, pika i)

Qëndrimi i AK-së në Vendimin e datës 19.11.2026: AK deklaron shprehimisht se *"nuk e konteston dokumentacionin"* tjetër për z. Suad Bushi, por vlerëson se kandidati *"nuk e posedon çertifikatën HSE (Health, Safety and Environment)"*, me arsyetimin se certifikata e prezantuar **NEBOSH** gjoja është larguar nga Dosja e Tenderit me Formularin standard B54 të datës 28.08.2026.

Kundërshtimi i Ankuesit: Ky arsyetim i Autoritetit Kontraktues është faktikisht i pasaktë, logjikisht kontradiktor dhe juridikisht i paqëndrueshëm:

a) **Certifikata e MPMS-së mbulon fushën e Sigurisë, Shëndetit në Punë dhe Mjedisit:** Në ofertën e Ankuesit është dorëzuar **Certifikata e lëshuar nga MPMS për Ekspert të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë nr. 0318280323** (e vlefshme deri më 31.03.2028), së bashku me Diplomën Master në Menaxhim të Emergjencave nr. 126/16. Sipas Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, certifikimi nga MPMS është certifikimi i vetëm zyrtar dhe ligjor në Republikën e Kosovës për këtë fushë.

b) **Certifikata NEBOSH International General Certificate (nr. 00254610/1285582, datë 06.05.2022) është standardi më i lartë ndërkombëtar për HSE:** Edhe nëse AK me Formularin B54 të datës 28.08.2026 ka larguar obligimin ekskluziv për certifikatën NEBOSH për të lehtësuar konkurrencën, kjo nënkupton se çdo certifikatë e fushës HSE (përfshirë vetë NEBOSH-in si certifikim ndërkombëtar në Health, Safety & Environment) është më se e vlefshme. Heqja e detyrimit ekskluziv për NEBOSH nuk e bën NEBOSH-in të pavlefshëm për fushën e HSE-së — përkundrazi, vërteton se z. Suad Bushi i plotëson të dyja kërkesat kumulativisht (edhe certifikatën e MPMS-së edhe certifikatën ndërkombëtare HSE/NEBOSH).

c) **Mungesa e kërkesës për sqarim (Neni 72 i LPP-së):** Nëse Komisioni i Vlerësimit kishte ndonjë paqartësi mbi ekuivalencën e certifikatës NEBOSH me kërkesën për

HSE, kishte detyrimin ligjor të kërkonte sqarim sipas nenit 72 të LPP-së, e jo të eliminonte ofertën.

2. Kundërshtimi lidhur me pozitën e Masterit të Shkencave Teknike – z. Avni Beqiri (Kërkesa 3, pika j)

Qëndrimi i AK-së në Vendimin e datës 19.11.2026: AK citon vetë kërkesën e Dosjes së Tenderit: *"j) Një Master i Shkencave Teknike, min. 5 vite përvojë pune"*, por menjëherë më poshtë konstaton se *"ju nuk e keni ofruar Certifikatën sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit... j) Një master i shkencave teknike min 5 vite përvojë pune"* — pa dhënë asnjë arsyetim të vetëm për Pretendimin 2 të kërkesës sonë për rishqyrtim.

a) **Heshtja e plotë dhe shkelja e nenit 108/A të LPP-së:** AK ka injoruar plotësisht argumentin se për pozitën 3.j nuk është kërkuar asnjë certifikatë në Dosjen e Tenderit. Vetë teksti i cituar nga AK në vendimin e refuzimit vërteton se për pikën j) kërkohet vetëm diploma Master i Shkencave Teknike dhe minimum 5 vite përvojë pune.

b) **Shtimi i kritereve të paqena gjatë vlerësimit:** Te dëshmitë e kërkuara në DT është përcaktuar shprehimisht: *"Diplomat kopje, certifikatat kopje (për inxhinierët që është kërkuar të kenë certifikata)"*. Grupi ynë ka dorëzuar Diplomën Master i Shkencave Teknike nr. 282 (datë 15.03.2017) nga Universiteti i Prishtinës, CV-në dhe dëshmitë e përvojës mbi 5-vjeçare. Eliminimi i ofertës për mungesë të një certifikate që nuk ekziston në Dosjen e Tenderit përbën shkelje flagrante të neneve 27 dhe 59 të LPP-së dhe nenit 40 të Rregullores Nr. 001/2022.

3. Kundërshtimi lidhur me pozitën e Bachelorit të Makinerisë – z. Egon Hoti (Kërkesa 3, pika k)

Qëndrimi i AK-së në Vendimin e datës 19.11.2026: AK ripërsërit tekstin e kërkesës 3.k dhe e rendit këtë pozitë nën paragrafin *"Ndërsa ju nuk e keni ofruar Certifikatën sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit..."*, pa analizuar dhe pa përmendur asnjë nga shtatë (7) dokumentet e dorëzuara në ofertë për z. Egon Hoti.

a) **Vendim i paarsyetuar (Shkelje e Nenit 108/A të LPP-së dhe Nenit 48 të LPPA-së):** AK nuk tregon se cila certifikatë gjoja mungon dhe pse nuk janë pranuar dokumentet ekzistuese në ofertë.

b) **Përmbushja e plotë e çdo nën-elementi të pikës 3.k:** Për z. Egon Hoti janë dorëzuar: (i) Diploma Bachelor në Inxhinieri të Makinerisë (UP, nr. 1304, datë 21.12.2021); (ii) Certifikata e trajnimit nga prodhuesi **Medicop** për instalimin, servisimin dhe testimin përfundimtar të sistemeve të gazrave medicinale sipas standardit **ISO 7396-1** (datë 16.06.2022, e vlefshme deri më 16.06.2027 – mbi 4 vite përvojë pas certifikimit, duke tejkaluar kërkesën prej 3 vitesh); (iii) Referenca e datës 13.06.2025 për mbi 25 kontrata të realizuara në fushën e gazrave medicinale në QKUK/SHSKUK; dhe (iv) Certifikata e trajnimit 150-orësh për Ekspert të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (nr. SSHP1004-02/25, datë 05.06.2025) e lëshuar nga European College of Kosovo, së bashku me **Licencën e ofruesit të trajnimit nr. 05/2018 (datë 18.07.2018) të lëshuar nga MPMS**.

c) **Përputhshmëria e plotë me DT-në:** Dosja e Tenderit te pika 3.k kërkon shprehimisht: *"Të jetë i certifikuar si ekspert për siguri dhe shëndet në punë nga një kompani e licencuar nga MPMS"*. Pikërisht këtë dokumentacion e kemi dorëzuar në ofertë.

4. Kundërshtimi lidhur me datat e kontratave dhe dëshmitë e ATK-së për shtatë (7) punëtorët teknikë (Kërkesa 4)

Qëndrimi i AK-së në Vendimin e datës 19.11.2026: AK konstaton se për shtatë (7) punëtorët teknikë (Fadil Hoti, Valton Aliu, Avni Hoti, Fledi Hoti, Egon Hoti, Besian Murati,

Ferid Shabani) ekziston mospërputhje ndërmjet datës së fillimit të punës dhe datës së nënshkrimit të kontratës, duke injoruar plotësisht listën e deklarimeve të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) dhe sqarimet për emrat.

a) **Anashkalimi i provave zyrtare shtetërore (Dëshmitë e ATK-së):** Në ofertë janë dorëzuar deklarimet zyrtare të ATK-së për secilin punëtor (nr. 11, nr. 26, nr. 3, nr. 14, nr. 9, nr. 8 dhe nr. 13), të cilat vërtetojnë në mënyrë të pakontestueshme ekzistimin dhe vazhdimësinë reale të marrëdhënies së punës dhe pagesën e kontributeve pensionale e tatimore.

b) **Kuptimi juridik i riformalizimit / përditësimit të kontratave të punës:** Kur punëdhënësi dhe punëmarrësi nënshkruajnë një kontratë të re të përditësuar (p.sh. më 20.02.2026) për të harmonizuar kushtet ose pagën, në tekstin e kontratës shënohet data kur punëtori ka filluar punën fillimisht në kompani (p.sh. 12.01.2021 për Fadil Hotin, 22.10.2020 për Egon Hotin, etj.), në mënyrë që t'i njihet stazhi i vazhdueshëm i punës. Edhe te rasti i punëtorit Ferid Shabani (data e nënshkrimit 01.01.2024 vs. data e fillimit 01.10.2024), bëhet fjalë për një gabim të thjeshtë teknik të shkrimit (lapsus calami), i cili verifikohet lehtësisht nga regjistri zyrtar i ATK-së (nr. 13).

c) **Shtrembërimi i fakteve në Vendimin e AK-së:** AK në vendim shkruan: *"Nuk kemi ofruar kontratat sipas kërkesës..."*, ndonëse kontratat janë dorëzuar dhe Dosja e Tenderit nuk ka përcaktuar ndonjë datë specifike të nënshkrimit të tyre, por vetëm dëshmimin e angazhimit të stafit teknik. Po ashtu, AK ka injoruar sqarimin e dorëzuar që në ofertë për ndryshimin e mbiemrit të Avni Hotit (ish-Kalina) dhe gabimin e vet në shkrimin e emrit të Valton Aliut (të shkruar gabimisht si "Valon Aliu").

5. Kundërshtimi lidhur me mohimin e paligjshëm të qasjes në dokumentacionin e GOE të rekomanduar (HARST Group SH.P.K. & Hexagon Construction SH.P.K.), paligjshmërinë e kërkesave për sekret afarist (Aneksi 3) dhe mospajtimin brenda Komisionit të Vlerësimit

Qëndrimi i AK-së në Vendimin e datës 19.11.2026: AK arsyeton mosdhënien e dokumentacionit kryesor teknik, profesional dhe të pajisjeve të GOE të rekomanduar me faktin se të dyja kompanitë e konsorciumit (HARST Group SH.P.K. dhe Hexagon Construction SH.P.K.) kanë dorëzuar formularin "Aneksi 3 – Kërkesa për Sekret Afarist", ku kanë kërkuar që *"GJITHË DOKUMENTACIONI I TENDERIT SIPAS NENIT 68 DHE 69 TË LIGJIT TË PROKURIMIT PUBLIK"* të ruhet si sekret afarist. Për më tepër, AK nuk i është përgjigjur fare konstatimeve të anëtarit të Komisionit të Vlerësimit, **z. Pajtim Mustafa** (faqe 10 e Raportit të Vlerësimit), i cili ka votuar kundër dhe ka konstatuar se GOE i rekomanduar është i papërgjegjshëm.

A. Analiza e paligjshmërisë së Kërkesave për Sekret Afarist (Aneksi 3) të dorëzuara nga HARST Group SH.P.K. dhe Hexagon Construction SH.P.K.

Autoriteti Kontraktues në Vendimin e datës 19.11.2026 (faqet 27–28) ka bashkëngjitur dy formularë të **Aneksit 3 – Kërkesa për Sekret Afarist**, të nënshkruar më datë 01.10.2026 nga përfaqësuesit e dy anëtarëve të GOE të rekomanduar (Sadik Ramadhi për HARST Group SH.P.K. dhe Zenun Alimusaj për Hexagon Construction SH.P.K.), me anë të të cilëve ka tentuar ta arsyetojë bllokimin e qasjes në dokumentacionin teknik, profesional dhe të pajisjeve të ofertës së tyre. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtyre dy kërkesave vërehet se ato janë **plotësisht të kundërligjshme, të paarsyetuara dhe juridikisht të pavlefshme** për katër (4) arsye thelbësore:

1. **Shpallja e përgjithshme ("en bloc") e të gjithë ofertës si sekret afarist (Shkelje e Nenit 11, par. 1 dhe 2 të LPP-së):** Në rubrikën *"Identifikimi i informacioneve sekrete afariste dhe referimi në pjesët e dokumenteve të dërguara"*, të dy operatorët kanë shënuar me shkronja të mëdha formulimin e përgjithshëm dhe shabllon: *"GJITHË*

DOKUMENTACIONI I TENDERIT SIPAS NENIT 68 DHE 69 TË LIGJIT TË PROKURIMIT PUBLIK". Sipas **nenit 11 të LPP-së** dhe **nenit 7, paragrafët 4 dhe 5 të Rregullores Nr. 001/2022**, operatori ekonomik nuk mund ta deklarojë të gjithë ofertën si sekret afarist; ai detyrohet të identifikojë konkretisht secilin dokument dhe secilën faqe/pjesë që pretendon se përbën sekret afarist. Deklarimi i të gjithë dokumentacionit në tërësi e bën kërkesën juridikisht të pavlefshme.

2. **Mungesa e plotë e arsyetimit mbi natyrën e dëmit material (Shkelje e Nenit 11, par. 2 të LPP-së dhe Nenit 7.5 të Rregullores Nr. 001/2022):** Në rubrikën *"Deklaratë mbi natyrën e dëmit të tillë material dhe arsyet pse do të duhej të shfaqet"*, të dyja kompanitë kanë përdorur një tekst identik (kopje të njëra-tjetrës) me një fjali të vetme abstrakte: *"SHFAQJA E KËTYRE INFORMACIONEVE TE PALËT TJERA DO TË NA SHKAKTONTE DËME MATERIALE DHE MORALE NGA MUNDËSIA E KEQPËRDORIMIT TË DOKUMENTACIONIT DHE INFORMACIONIT TË KOMPANISË TONË"*. Kjo deklaratë nuk përmban asnjë arsyetim konkret se çfarë sekreti tregtar, formule teknologjike, patente apo know-how mbrohet dhe si konkretisht do të dëmtohej pozita e tyre konkurruese në treg. Për më tepër, referimi në *"dëme morale"* dhe *"nenet 68 dhe 69 të LPP-së"* (të cilat rregullojnë kriteret e përshtatshmërisë dhe kapacitetit teknik/profesional!) dëshmon se këto kërkesa janë përpiluar vetëm si mburojë formale për të fshehur mungesën e dokumentacionit të kualifikimit.

3. **Dokumentet e kualifikimit sipas Neneve 68 dhe 69 të LPP-së nuk përbëjnë sekret afarist:** Sipas praktikës së konsoliduar të OSHP-së dhe nenit 7 të Rregullores Nr. 001/2022, dokumentet publike ose dokumentet që dëshmojnë përmbushjen e kritereve minimale të Dosjes së Tenderit — siç janë **diplomat universitare, licencat profesionale të lëshuara nga institucionet shtetërore, certifikatat ISO, referencat e punëve publike të realizuara dhe dëshmitë mbi posedimin e pajisjeve** — nuk gëzojnë statusin e sekretit afarist. Shumica e referencave të tyre janë kontrata publike të financuara nga buxheti i shtetit, të cilat sipas ligjit janë dokumente publike.

4. **Dështimi i AK-së për të ushtruar kontrollin ligjor dhe për të ofruar versionin e pastruar (Shkelje e Nenit 11, par. 3 të LPP-së dhe Neneve 7.6.1 – 7.6.3 të Rregullores Nr. 001/2022):** Autoriteti Kontraktues nuk është ndërmjetës pasiv i kërkesave të operatorëve ekonomikë. Sipas **nenit 11, paragrafi 3 të LPP-së** dhe **nenit 7.6.1 të Rregullores Nr. 001/2022**, AK ka detyrimin ligjor të vlerësojë nëse kërkesa e OE-së për konfidencialitet është e bazuar dhe **të refuzojë klasifikimin** kur nuk përmbushen kushtet ligjore. Po ashtu, sipas **nenit 7.6.2**, nëse ndonjë dokument përmban të dhëna personale (si numrat personalë apo pagat), AK ka pasur detyrimin t'i redaktojë ato të dhëna dhe t'i ofrojë Ankuesit **versionin e pastruar të dokumenteve**. Duke pranuar verbërisht një kërkesë të përgjithshme e të paarsyetuar për "gjithë dokumentacionin e tenderit", AK ka kryer **shkelje të rëndë** sipas **nenit 97, paragrafi 1, nënparagrafi c) të Rregullores Nr. 001/2022**.

B. Fshehja e papërgjegjshmërisë së GOE të rekomanduar (Vërejtjet e anëtarit të Komisionit z. Pajtim Mustafa)

Arsyeja e vërtetë pse AK ka bllokuar qasjen në dokumentacionin teknik të GOE HARST Group SH.P.K. & Hexagon Construction SH.P.K. dëshmohet nga vetë **faqja 10 e Raportit të Vlerësimit**, ku anëtari i Komisionit të Vlerësimit, **z. Pajtim Mustafa**, ka dokumentuar shprehimisht mendimin e tij të ndarë se ky konsorcium **është i papërgjegjshëm** sepse:

- **Nuk ka dëshmuar realizimin e punëve të ngjashme në fushën e osmozës** (ashtu siç është kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit);

- **Nuk ka paraqitur dëshmi për pajisjen e nevojshme për sistemin e gazrave medicinale sipas standardit DIN EN ISO 7396-1.**

Në Vendimin e datës 19.11.2026, AK nuk ka dhënë asnjë sqarim të vetëm se si u tejkaluan vërejtjet e anëtarit të Komisionit z. Pajtim Mustafa dhe mbi cilat prova konkretisht u rekomandua për kontratë një operator që nuk ka dëshmi për sistemin e osmozës dhe pajisjet e gazrave medicinale.

PRETENDIMI 2

Vlerësimi i pasaktë i dokumentacionit për pozitën e Masterit të Emergjencave – Suad Bushi

Në arsyetimin e vendimit për eliminim, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se për pozitën përkatëse të stafit profesional, të cilën e mbulon z. Suad Bushi, nuk janë dorëzuar certifikatat e kërkuara në fushën e HSE-së dhe të sigurisë dhe shëndetit në punë nga MPMS.

Ky konstatim nuk qëndron, pasi dokumentacioni përkatës është dorëzuar në kuadër të ofertës së Grupit të Operatorëve Ekonomikë.

Në mbështetje të përmbushjes së kërkesave për këtë pozitë, në ofertë janë dorëzuar këto dokumente:

> Diploma e nivelit Master në Menaxhim të Emergjencave, nr. 126/16, e datës 22.11.2016;
> Certifikata e MPMS-së për Ekspert të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, nr. 0318280323, me vlefshmëri deri më 31.03.2028;
> Certifikata NEBOSH International General Certificate, nr. 00254610/1285582, e datës 06.05.2022;
> CV-ja e kandidatit;
> Marrëveshja e angazhimit e datës 26.08.2026;
> Lista e stafit

Nga dokumentacioni i lartcekur rezulton se kandidati posedon diplomën përkatëse të nivelit Master, certifikimin profesional në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë nga MPMS, si dhe certifikimin ndërkombëtar NEBOSH.

Në veçanti, certifikata e MPMS-së me numër 0318280323 është e vlefshme deri më 31.03.2028.

Për këtë arsye, konstatimi i Autoritetit Kontraktues se dokumentacioni përkatës mungon është në kundërshtim me dokumentet e dorëzuara në ofertë.

Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar që të shqyrtojë tërësinë e dokumentacionit të paraqitur dhe të vlerësojë përmbushjen e kriterit mbi bazën e provave konkrete, e jo të konstatojë mungesën e dokumenteve që gjenden në ofertën e operatorit ekonomik.

Në rast se gjatë vlerësimit ka ekzistuar ndonjë paqartësi lidhur me dokumentet e dorëzuara, Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësi të kërkojë sqarime në përputhje me nenin 59 dhe nenin 72 të LPP-së, duke respektuar kufizimet ligjore dhe pa lejuar ndryshimin thelbësor të ofertës.

Kërkesa lidhur me këtë pretendim:

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) që, gjatë shqyrtimit të këtij pretendimi, të vlerësojë dokumentacionin e paraqitur për z. Suad Bushi, veçanërisht certifikatën e MPMS-së nr. 0318280323 dhe certifikatën NEBOSH nr. 00254610/1285582, dhe të konstatojë se kërkesa përkatëse e Dosjes së Tenderit është përmbushur. Rrjedhimisht, kërkojmë që eliminimi i ofertës mbi këtë bazë të vlerësohet si i pabazuar.

PRETENDIMI 3

Kërkimi i një certifikate shtesë për pozitën e Masterit të Shkencave Teknike – Avni Beqiri, ndonëse një kërkesë e tillë nuk është përcaktuar në Dosjen e Tenderit

Në arsyetimin e paraqitur në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (Formulari B42), si arsye për eliminimin e Grupit të Operatorëve Ekonomikë është evidentuar mungesa e certifikatës për pozitën e Masterit të Shkencave Teknike, të cilën e mbulon z. Avni Beqiri.

Një konstatim i tillë konsiderojmë se është i pabazuar në kërkesat konkrete të Dosjes së Tenderit, pasi Autoriteti Kontraktues ka kërkuar një kualifikim akademik të nivelit Master në Shkencat Teknike dhe përvojë profesionale prej së paku pesë (5) vitesh, por nuk ka përcaktuar në mënyrë të shprehur ndonjë certifikatë shtesë profesionale si kusht për përmbushjen e kësaj pozite.

Konkretisht, në Dosjen e Tenderit, te kërkesat për mundësitë teknike dhe/ose profesionale, është përcaktuar:

Kërkesa në Dosjen e Tenderit:

"j) Një Master i Shkencave Teknike, min. 5 vite përvojë pune."

Ndërsa, te dëshmitë e kërkuara është përcaktuar:

"Diplomat kopje, certifikatat kopje (për inxhinierët që është kërkuar të kenë certifikata)."

Nga formulimi i mësipërm rezulton qartë se Dosja e Tenderit nuk kërkon certifikatë profesionale për secilën pozitë të stafit pa dallim, por vetëm për inxhinierët dhe pozitat për të cilat një certifikatë e tillë është kërkuar shprehimisht. Rrjedhimisht, kërkesa për certifikatë nuk mund të interpretohet në mënyrë të zgjeruar dhe të zbatohet edhe për pozitën e Masterit të Shkencave Teknike, kur një kusht i tillë nuk është përcaktuar në kërkesën konkrete për këtë pozitë.

Në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, në ofertën e dorëzuar nga Grupi ynë janë përfshirë dokumentet në vijim:

Diploma Master i Shkencave Teknike, nr. 282, e datës 15.03.2017, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, përkatësisht Fakulteti i Gjeoshkencave dhe Teknologjisë;
Dokumentacioni përkatës që dëshmon përvojën profesionale të kandidatit;
CV-ja e kandidatit;
Dokumentet e tjera mbështetëse të dorëzuara në ofertë.

Pra, diploma e dorëzuar dëshmon përmbushjen e kërkesës për kualifikimin akademik, ndërsa dokumentacioni mbështetës dëshmon përvojën profesionale të kandidatit, e cila

përmbush dhe tejkalon kërkesën minimale prej pesë (5) vitesh të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Paqartësia dhe kundërthënia në arsyetimin e Autoritetit Kontraktues

Për më tepër, në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, mungesa e certifikatës është arsyetuar me pretendimin se një dokument i tillë kërkohet sipas njoftimit për kontratë dhe Dosjes së Tenderit. Megjithatë, në rastin konkret, një kërkesë e tillë nuk figuron në përshkrimin e pozitës së Masterit të Shkencave Teknike.

Kjo paraqet një mospërputhje ndërmjet kërkesës reale të përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe mënyrës se si Autoriteti Kontraktues e ka interpretuar dhe zbatuar atë gjatë vlerësimit të ofertës sonë.

Duhet theksuar se Grupi ynë i Operatorëve Ekonomikë i ka përmbushur kërkesat për certifikata në të gjitha pozitat ku Dosja e Tenderit i ka kërkuar ato shprehimisht. Për rrjedhojë, nuk mund të kërkohet një dokument shtesë për një pozitë për të cilën Autoriteti Kontraktues nuk e ka përcaktuar një kusht të tillë paraprakisht.

Baza ligjore e pretendimit

Sipas nenit 27 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, Dosja e Tenderit përcakton kërkesat dhe kushtet që duhet të përmbushen nga operatorët ekonomikë. Autoriteti Kontraktues është i obliguar që gjatë vlerësimit të ofertave të veprojë në përputhje me kërkesat e publikuara dhe nuk mund të vendosë kushte shtesë që nuk janë paraparë paraprakisht.

Po ashtu, neni 40, paragrafët 1 dhe 2, të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik përcakton detyrimin për zbatimin e kritereve të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në Dosjen e Tenderit gjatë procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Ndërkaq, neni 7 i Ligjit për Prokurimin Publik garanton trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, duke kërkuar që të gjithë ofertuesit të vlerësohen sipas të njëjtave kritere dhe standardeve të përcaktuara paraprakisht.

Në këtë drejtim, kërkimi i një certifikate që nuk është përcaktuar si kusht për pozitën konkrete përbën interpretim të zgjeruar dhe zbatim të gabuar të kërkesave të Dosjes së Tenderit, duke cenuar parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Kërkesa lidhur me këtë pretendim

Duke u bazuar në faktet dhe argumentet e paraqitura më lart, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) që:

1. Të shqyrtojë dhe vlerësojë konstatimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me pretendimin për mungesën e certifikatës për pozitën e Masterit të Shkencave Teknike – Avni Beqiri;
2. Të konstatojë se, për këtë pozitë, Dosja e Tenderit ka kërkuar diplomën përkatëse të nivelit Master dhe përvojë profesionale prej së paku pesë (5) vitesh, pa përcaktuar ndonjë certifikatë shtesë profesionale;

3. Të marrë në konsideratë diplomën, CV-në dhe dokumentacionin e përvojës profesionale të paraqitur në ofertë, si dëshmi për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit;
4. Të konstatojë se eliminimi i ofertës mbi këtë bazë është i pabazuar dhe, rrjedhimisht, të obligojë Autoritetin Kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertës të marrë parasysh dokumentacionin e dorëzuar dhe të zbatojë vetëm kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

PRETENDIMI 4

Mosvlerësimi i drejtë i dokumentacionit për pozitën e Bachelorit të Makinerisë – Egon Hoti

Në kuadër të arsyetimit të eliminimit, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se dokumentacioni për pozitën e Bachelorit të Makinerisë nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Ky vlerësim nuk pasqyron tërësinë e dokumentacionit të dorëzuar në ofertë, pasi për kandidatin z. Egon Hoti janë paraqitur dëshmi konkrete për kualifikimin akademik, certifikimin nga prodhuesi, përvojën profesionale dhe përgatitjen në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Në ofertë janë dorëzuar dokumentet si në vijim:

> Diploma Bachelor në Inxhinieri të Makinerisë, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, nr. 1304, e datës 21.12.2021;
> Certifikata e trajnimit nga prodhuesi Medicop për instalimin, servisimin dhe testimin përfundimtar të sistemeve të gazrave medicinale sipas standardit ISO 7396-1, e datës 16.06.2022, me vlefshmëri deri më 16.06.2027;
> CV-ja e kandidatit;
> Kontrata e punës dhe dokumentacioni tjetër që dëshmon përvojën profesionale;
> Referenca e datës 13.06.2025, e cila dëshmon përfshirjen e kandidatit në më shumë se 25 kontrata të realizuara në fushën e gazrave medicinale në QKUK/SHSKUK;
> Certifikata e trajnimit përgatitor 150-orësh për Ekspert të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, nr. SSHP1004-02/25, e datës 05.06.2025, e lëshuar nga European College of Kosovo;
> Licenca e ofruesit të trajnimit, nr. 05/2018, e datës 18.07.2018.

Nga këto dokumente rezulton se kandidati posedon diplomën përkatëse universitare, certifikimin e prodhuesit për instalimin dhe testimin e sistemeve të gazrave medicinale sipas ISO 7396-1, si dhe përvojën profesionale të dokumentuar në këtë fushë.

Në veçanti, referenca e datës 13.06.2025 dëshmon angazhimin e kandidatit në më shumë se 25 kontrata që lidhen me gazrat medicinale në institucionet shëndetësore përkatëse. Kjo dëshmi duhet të vlerësohet së bashku me kontratën e punës, CV-në dhe dokumentacionin tjetër të paraqitur.

Gjithashtu, certifikata e trajnimit përgatitor 150-orësh për Ekspert të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, së bashku me licencën e ofruesit të trajnimit, është pjesë e dokumentacionit të dorëzuar dhe duhet të shqyrtohet në raport me kërkesën përkatëse të Dosjes së Tenderit.

Nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur ndonjë paqartësi lidhur me natyrën e certifikatës së prodhuesit, përvojën e kandidatit apo dokumentacionin e trajnimit në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, ka qenë e mundur të kërkohen sqarime në përputhje me nenet 59 dhe 72 të LPP-së, pa ndryshuar përmbajtjen thelbësore të ofertës.

Nuk është e drejtë që dokumentet e dorëzuara të mos vlerësohen në tërësi ose të konsiderohen të pamjaftueshme pa u dhënë arsyetim konkret se cilën kërkesë të përcaktuar në Dosjen e Tenderit nuk e përmbush secila dëshmi.

Kërkesa lidhur me këtë pretendim:

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) që të vlerësojë dokumentacionin e z. Egon Hoti në tërësi, duke marrë parasysh diplomën, certifikatën e prodhuesit Medicop, referencën që dëshmon pjesëmarrjen në më shumë se 25 kontrata, dokumentacionin e përvojës profesionale dhe certifikatën e trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe të konstatojë se kërkesat përkatëse të Dosjes së Tenderit janë përmbushur. Rrjedhimisht, kërkojmë që eliminimi i ofertës mbi këtë bazë të vlerësohet si i pabazuar dhe Autoriteti Kontraktues të obligohet që këtë dokumentacion ta marrë parasysh gjatë rivlerësimit të ofertës.

PRETENDIMI 5

Vlerësimi i pasaktë i datave të kontratave dhe mosmarrja parasysh e dëshmive të marrëdhënies së punës për shtatë (7) pjesëtarët e stafit teknik

Në arsyetimin e eliminimit, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar mospërputhje në datat e kontratave të punës për shtatë (7) pjesëtarë të stafit teknik, duke vënë në dyshim përmbushjen e kërkesave lidhur me angazhimin dhe marrëdhënien e tyre të punës.

Megjithatë, ky konstatim është bërë pa u shqyrtuar në tërësi dokumentacioni i dorëzuar në ofertë dhe pa u marrë parasysh dëshmitë shtesë që pasqyrojnë marrëdhëniet e punës dhe deklarimet përkatëse në Administratën Tatimore të Kosovës.

Punëtorët për të cilët është konstatuar mospërputhje janë:

Fadil Hoti;
Valton Aliu (i evidentuar në Njoftimin mbi vendimin e AK-së si Valon Aliu);
Avni Hoti (i evidentuar në dokumentacionin e ATK-së si Avni Kalina, lidhur me kete ka ndryshim mbiemri per qka ju kemi njoftuar edhe ne dorezimin fillestar te dosjes se tenderit);
Fledi Hoti;
Egon Hoti;
Besian Murati;
Ferid Shabani.

Për këta punëtorë janë dorëzuar dëshmi të ndryshme që duhet të vlerësohen së bashku me kontratat e punës dhe dokumentacionin tjetër të stafit.

Në veçanti, në dokumentacionin e dorëzuar janë përfshirë dëshmitë e ATK-së si në vijim:

Për Fadil Hotin – dëshmia e ATK-së, nr. 11;
Për Valton Aliun – dëshmia e ATK-së, nr. 26;

Për Avni Hotin/Avni Kalinën – dëshmia e ATK-së, nr. 3;
Për Fledi Hotin – dëshmia e ATK-së, nr. 14;
Për Egon Hotin – dëshmia e ATK-së, nr. 9;
Për Besian Muratin – dëshmia e ATK-së, nr. 8;
Për Ferid Shabanin – dëshmia e ATK-së, nr. 13.

Provë: Lista e ATK-së

Këto dëshmi duhet të analizohen në raport me kontratat e punës, listat e stafit dhe dokumentet e tjera të dorëzuara, me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike për secilin punëtor veç e veç.

Sa i përket Valton Aliut, ne vendimin e AK emri figuron si Valon Aliu mendoj se ju keni referuar gabim emrit.

Po ashtu, lidhur me Avni Hotin, i cili në dokumentacionin e ATK-së figuron me mbiemrin Kalina, kërkohet që të merret parasysh dokumentacioni që dëshmon se bëhet fjalë për të njëjtin person dhe se dallimi në mbiemër lidhet me ndryshimin e mbiemrit.

Vlerësimi i Autoritetit Kontraktues nuk duhet të kufizohet vetëm në krahasimin formal të datave të paraqitura në dokumente të veçanta, por duhet të marrë parasysh të gjitha dëshmitë relevante që mundësojnë verifikimin e gjendjes faktike.

Gjithashtu, duhet të bëhet dallimi ndërmjet datës së lidhjes së një kontrate të caktuar dhe ekzistimit të marrëdhënies së punës, pasi këto nuk janë domosdoshmërisht e njëjta gjë. Dokumentet e ATK-së dhe provat e tjera mund të ndihmojnë në verifikimin e vazhdimësisë së angazhimit, por duhet të shqyrtohen në raport me kontratat dhe dokumentet përkatëse.

Në këtë kuptim, kërkohet që Autoriteti Kontraktues të bëjë vlerësim individual për secilin nga shtatë punëtorët dhe të identifikojë saktësisht se cila kërkesë nuk është përmbushur dhe mbi cilën provë është mbështetur ky konstatim.

Nëse ka pasur paqartësi lidhur me dokumentacionin, Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësi të kërkojë sqarime në përputhje me nenin 59 dhe nenin 72 të LPP-së, brenda kufijve të lejuar ligjorë.

Kërkesa lidhur me këtë pretendim:

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) që, gjatë shqyrtimit të këtij pretendimi, të vlerësojë dokumentacionin e paraqitur për shtatë punëtorët e lartcekur, përfshirë, dëshminë e ATK-së (te bashkangjitur si prove ne kete ankesë) dhe listën e punëtorëve të kompanisë. Kërkojmë që këto dëshmi të shqyrtohen në tërësi dhe individualisht për secilin punëtor, duke mos u mbështetur vetëm në mospërputhjet formale të datave, pa i vlerësuar të gjitha provat mbështetëse.

PRETENDIMI 6

Mosofrimi i qasjes së plotë dhe efektive në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë – ekzistenca e mospajtimit brenda Komisionit të Vlerësimit lidhur me përmbushjen e kritereve të kapacitetit teknik dhe profesional,

cenimi i transparencës dhe pamundësimi i verifikimit të ligjshmërisë së rekomandimit për kontratë

Pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Grupi i Operatorëve Ekonomikë ka kërkuar qasje në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, me qëllim të verifikimit të përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe të ligjshmërisë së procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave.

Më datë **16.11.2026**, Grupi ynë ka paraqitur kërkesë për qasje në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit. Me këtë rast, nga ana e Menaxherit të Prokurimit është bërë e ditur se dokumentacioni është voluminoz dhe se nevojitet kohë për përgatitjen e tij në USB, për çka qasja është shtyrë për datën **17.11.2026**.

Megjithatë, edhe më datë 17.11.2026, dokumentacioni i vënë në dispozicion ka qenë i kufizuar dhe nuk ka përfshirë dokumentet thelbësore mbi të cilat është bazuar vlerësimi i ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Dokumentacioni i ofruar ka përfshirë kryesisht:

1. Profilin e kompanisë;
2. Aneksin 1 – Specifikimet teknike;
3. Përshkrimin e çmimeve;
4. Paramasën;
5. Formularin e tenderit;
6. Raportin e vlerësimit.

Ndërsa nuk është mundësuar qasja në dokumentacionin thelbësor që dëshmon përmbushjen e kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional, konkretisht:

- Dokumentacionin e stafit profesional dhe teknik, përfshirë diplomat, licencat, certifikatat, CV-të dhe dëshmitë e përvojës profesionale;
- Kontratat, referencat dhe dëshmitë për realizimin e punëve të ngjashme;
- Dokumentet që dëshmojnë posedimin, disponueshmërinë ose sigurimin e pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për realizimin dhe testimin e instalimeve;
- Dëshmitë teknike dhe profesionale lidhur me përmbushjen e kërkesave për instalimin dhe testimin e sistemeve të gazrave medicinale;
- Dokumentet e tjera mbështetëse që janë përdorur për të konstatuar përmbushjen e kritereve të Dosjes së Tenderit.

RËNDËSIA E DOKUMENTACIONIT TË MUNGUAR DHE EKZISTENCA E DYSHIMEVE KONKRETE LIDHUR ME PËRMBUSHJEN E KRITEREVE

Mungesa e qasjes në këto dokumente është veçanërisht problematike duke marrë parasysh natyrën dhe kompleksitetin e aktivitetit të prokurimit, i cili përfshin punë në fushën e HVAC-së, ventilimit, osmozës dhe instalimeve të gazrave medicinale, për të cilat Dosja e Tenderit përcakton kërkesa specifike teknike dhe profesionale.

Në këtë drejtim, nuk mjafton vetëm të konstatohet se operatori ekonomik i rekomanduar ka dorëzuar ofertën dhe dokumentet e përgjithshme të tenderit. Është e domosdoshme të verifikohet nëse ai i ka përmbushur realisht të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e

Tenderit, përmes dokumenteve dhe dëshmive konkrete që duhet të jenë pjesë e ofertës së tij.

Në veçanti, duhet të mundësohet verifikimi i dokumentacionit që dëshmon përmbushjen e kërkesave për instalimin dhe testimin e sistemeve të gazrave medicinale sipas standardit **DIN EN ISO 7396-1**, përfshirë dëshmitë për disponueshmërinë, përshtatshmërinë dhe aftësinë e pajisjeve dhe instrumenteve të kërkuara për testimin dhe verifikimin e këtyre instalimeve.

Një element veçanërisht i rëndësishëm, i cili e fuqizon këtë pretendim, rezulton drejtpërdrejt nga vetë Raporti i Vlerësimit të Tenderit, në faqen 10 të tij, ku është evidentuar mendimi i ndarë i anëtarit të Komisionit të Vlerësimit, z. Pajtim Mustafa.

Në këtë faqe, z. Pajtim Mustafa, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të ofertave, ka shprehur mospajtimin e tij me rekomandimin për shpërblimin me kontratë të Grupit të Operatorëve Ekonomikë të përbërë nga HARS Group SH.P.K. dhe HEXAGON CONSTRUCTION SH.P.K., duke konstatuar se, sipas vlerësimit të tij, ky grup nuk i plotëson kriteret për t'u shpallur fitues.

Në arsyetimin e tij, ndër të tjera, ai ka theksuar dy çështje thelbësore:

1. **Mungesën e dëshmive për realizimin e punëve të ngjashme në fushën e osmozës**, duke vënë në pah se nuk është dëshmuar përmes kontratave apo referencave se operatori ekonomik ka realizuar punë të ngjashme për sistemin e osmozës, ashtu siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.
2. **Mungesën e dëshmisë për pajisjen e nevojshme për sistemin e gazrave medicinale**, duke theksuar se nuk është paraqitur dëshmi për pajisjen për sistemin e gazrave medicinalë sipas standardit DIN EN ISO 7396-1.

Në përfundim të arsyetimit të tij, anëtari i Komisionit ka shprehur qëndrimin se operatori ekonomik në fjalë është i papërgjegjshëm.

Ky konstatim ka rëndësi të veçantë juridike dhe faktike, pasi nuk bëhet fjalë për një dyshim të ngritur vetëm nga Grupi ynë i Operatorëve Ekonomikë, por për vërejtje konkrete të evidentuara nga vetë njëri prej anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit, i cili ka pasur qasje në dokumentacionin e ofertës dhe ka marrë pjesë në procesin e ekzaminimit dhe vlerësimit të saj.

Për rrjedhojë, ekziston një mospajtim i dokumentuar brenda vetë Komisionit të Vlerësimit lidhur me një çështje thelbësore të këtij aktiviteti të prokurimit: nëse operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka përmbushur apo jo kërkesat e Dosjes së Tenderit për kapacitetin teknik dhe profesional.

Në këtë kontekst, vërejtjet e anëtarit të Komisionit nuk mund të trajtohen si çështje dytësore apo thjesht formale, pasi ato lidhen drejtpërdrejt me dy kërkesa të rëndësishme të Dosjes së Tenderit: përvojën në realizimin e punëve të ngjashme për sistemin e osmozës dhe disponueshmërinë e pajisjeve të kërkuara për instalimin dhe testimin e sistemeve të gazrave medicinale sipas standardit DIN EN ISO 7396-1.

Këto janë pikërisht dokumentet dhe dëshmitë në të cilat Grupi ynë nuk ka pasur mundësi të ketë qasje të plotë, ndonëse ato janë vendimtare për të verifikuar nëse rekomandimi për kontratë është bërë në përputhje me kërkesat e publikuara.

Rrjedhimisht, në rrethanat konkrete, ekziston **dyshim i bazuar dhe i mbështetur në një konstatim të dokumentuar brenda vetë Komisionit të Vlerësimit**, se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë mund të mos i ketë përmbushur të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me përvojën në realizimin e punëve të ngjashme për sistemin e osmozës dhe me pajisjet e nevojshme për sistemin e gazrave medicinale sipas standardit DIN EN ISO 7396-1.

Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues ka pasur detyrimin që t'i shqyrtojë dhe t'i trajtojë në mënyrë të arsyetuar këto vërejtje, duke siguruar që rekomandimi për kontratë të mbështetet në dëshmi konkrete dhe në një vlerësim objektiv të të gjitha kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Theksojmë se Grupi ynë nuk po pretendon si fakt përfundimtar se operatori ekonomik i rekomanduar nuk i përmbush kriteret, pasi dokumentacioni përkatës nuk na është vënë në dispozicion për një verifikim të pavarur. Megjithatë, ekzistenca e mendimit të kundërt të një anëtari të Komisionit, së bashku me mungesën e qasjes në dokumentet që lidhen drejtpërdrejt me këto vërejtje, krijon nevojën e domosdoshme për një verifikim të plotë, objektiv dhe transparent.

BAZA LIGJORE E PRETENDIMIT

Në këtë drejtim, neni 10, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik përcaktojnë detyrimin për mbajtjen e dosjes së plotë të aktivitetit të prokurimit, e cila përfshin dokumentet dhe informacionet që lidhen me aktivitetin e prokurimit ose që janë përdorur gjatë zhvillimit të tij.

Neni 10, paragrafi 3, i LPP-së përcakton obligimin e Autoritetit Kontraktues që, pas kërkesës, të sigurojë qasje të menjëhershme dhe të arsyeshme në dosjet e aktivitetit të prokurimit, me përjashtim të dokumenteve që përbëjnë sekret afarist.

Po ashtu, neni 11 i LPP-së përcakton kufijtë e mbrojtjes së informatave sekrete afariste dhe nuk lejon që ky koncept të përdoret në mënyrë të përgjithshme për të penguar transparencën dhe qasjen në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit.

Në të njëjtën linjë, neni 7, paragrafët 4–7, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik rregullon qasjen në dokumentacionin e prokurimit dhe trajtimin e informatave sekrete afariste.

Veçanërisht, paragrafët 7.6.2 dhe 7.6.3 përcaktojnë procedurën konkrete për përgatitjen e versioneve të pastruara të dokumenteve dhe ofrimin e qasjes pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Paragrafi 7.6.3 përcakton se, pas kërkesës për qasje nga operatori ekonomik dhe pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së (B58), Zyrtari i Prokurimit duhet të ofrojë qasje të menjëhershme në versionin e pastruar dhe të mbajë procesverbal, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.

Për më tepër, neni 97, paragrafi 1, nënparagrafi c), i Rregullores Nr. 001/2022 e përcakton si shkelje serioze mohimin dhe/ose neglizhimin e qasjes në dokumentet zyrtare, kur kërkesa për qasje është në përputhje me nenet 10 dhe 11 të LPP-së.

Gjithashtu, zbatimi i këtyre dispozitave duhet të interpretohet në harmoni me Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, i cili garanton të drejtën e qasjes në dokumentet publike dhe përcakton se kufizimet e kësaj të drejte duhet të mbështeten në baza ligjore dhe të arsyetohen në mënyrë konkrete.

KËRKESA LIDHUR ME KËTË PRETENDIM

Duke u bazuar në faktet, argumentet dhe rrethanat e paraqitura, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) që, gjatë shqyrtimit të këtij pretendimi, të vlerësojë ligjshmërinë e kufizimit të qasjes në dokumentacionin e ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë dhe të obligojë Autoritetin Kontraktues që të na mundësojë qasje të plotë dhe efektive në dokumentacionin për kualifikimet, licencat, certifikatat, CV-të dhe përvojën profesionale të stafit teknik dhe profesional, si dhe në kontratat, referencat dhe dëshmitë e punëve të ngjashme të realizuara, me theks të veçantë në fushën e osmozës. Po ashtu, kërkojmë që të sigurohet qasja në dëshmitë për posedimin, disponueshmërinë ose sigurimin e pajisjeve dhe instrumenteve të kërkuara për realizimin, testimin dhe verifikimin e instalimeve të gazrave medicinale, përfshirë dokumentacionin përkatës sipas standardit DIN EN ISO 7396-1, si dhe në çdo dokumentacion tjetër teknik dhe profesional mbi të cilin Autoriteti Kontraktues e ka bazuar konstatimin për përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit. Kërkojmë gjithashtu që OSHP-ja të shqyrtojë dhe të vlerësojë vërejtjet e evidentuara në faqen 10 të Raportit të Vlerësimit nga anëtari i Komisionit, z. Pajtim Mustafa, veçanërisht lidhur me mungesën e dëshmive për punët e ngjashme në fushën e osmozës dhe mungesën e dëshmive për pajisjet e kërkuara sipas standardit DIN EN ISO 7396-1. Në rast se ndonjë pjesë e dokumentacionit konsiderohet sekret afarist, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të obligohet të identifikojë konkretisht dokumentet dhe pjesët që pretendohet se janë të mbrojtura, të arsyetojë bazën ligjore të kufizimit dhe të vërë në dispozicion versionet e pastruara ose përmbledhjet jokonfidenciale të tyre.

PRETENDIMI 7

Mangësitë në raportin e vlerësimit – mungesa e arsyetimit të detajuar dhe pamundësimi i verifikimit të ligjshmërisë së vlerësimit të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktues, Grupi ynë ka pranuar edhe një kopje të raportit të vlerësimit të ofertave.

Megjithatë, nga shqyrtimi i këtij dokumenti janë evidentuar mangësi që kërkojnë sqarim dhe verifikim nga Autoriteti Kontraktues.

Në kopjen e raportit të pranuar nuk figurojnë nënshkrimet e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit, ndërsa përmbajtja e tij nuk paraqet në mënyrë të mjaftueshme dhe të detajuar arsyetimin për secilën kërkesë të përcaktuar në Dosjen e Tenderit, në veçanti mënyrën se si është verifikuar dhe konstatuar përmbushja e kërkesave nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë.

Raporti i vlerësimit është një nga dokumentet kryesore të aktivitetit të prokurimit, pasi përmes tij duhet të pasqyrohet procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave,

dokumentacioni i shqyrtuar, konstatimet e Komisionit të Vlerësimit dhe arsyetimi mbi të cilin është mbështetur rekomandimi për kontratë.

Në këtë kuptim, një raport që nuk paraqet në mënyrë të qartë dhe të verifikueshme arsyetimin për përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit nuk mundëson kontroll efektiv të ligjshmërisë së procesit të vlerësimit.

Në veçanti, duke pasur parasysh natyrën teknike të këtij aktiviteti të prokurimit, raporti duhet të mundësojë identifikimin e dokumenteve dhe dëshmive mbi të cilat është mbështetur vlerësimi për stafin profesional dhe teknik, përvojën e ngjashme, pajisjet dhe instrumentet e kërkuara, si dhe kërkesat specifike për instalimet e gazrave medicinale.

Mungesa e një arsyetimi të tillë krijon paqartësi nëse të gjitha kriteret janë kontrolluar në mënyrë të plotë dhe nëse konstatimi për përgjegjshmërinë e operatorit ekonomik të rekomanduar është mbështetur në dëshmi konkrete.

Për më tepër, mungesa e nënshkrimeve në kopjen e raportit të pranuar nuk na mundëson të verifikojmë nëse dokumenti është versioni përfundimtar i raportit, nëse është miratuar nga anëtarët përkatës të Komisionit të Vlerësimit dhe nëse përmbajtja e tij përfaqëson rezultatet përfundimtare të procesit të vlerësimit.

Për këtë arsye, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të sqarojë statusin e raportit të vlerësimit dhe të na vërë në dispozicion versionin e tij të plotë dhe përfundimtar, së bashku me dokumentacionin përkatës që dëshmon miratimin dhe dokumentimin e procesit të vlerësimit. Gjithashtu, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues ta publikojë dhe ta ngarkojë raportin e vlerësimit në platformën elektronike të prokurimit (E-Prokurimi), në përputhje me obligimet ligjore për transparencë dhe publikim të dokumentacionit të aktivitetit të prokurimit.

Baza ligjore e pretendimit

Neni 10 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik përcakton detyrimin e Autoritetit Kontraktues për mbajtjen e dokumentacionit të plotë të aktivitetit të prokurimit, duke përfshirë dokumentet që janë përdorur dhe prodhuar gjatë zhvillimit të procedurës.

Neni 59 i LPP-së përcakton detyrimin që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të realizohen në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat ligjore. Për rrjedhojë, procesi i vlerësimit duhet të jetë i dokumentuar në mënyrë të tillë që të mund të verifikohen konstatimet dhe arsyetimi mbi të cilin është mbështetur vendimmarrja e Autoritetit Kontraktues.

Po ashtu, neni 40 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik përcakton zbatimin e kritereve të publikuara paraprakisht gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave.

Në këtë drejtim, raporti i vlerësimit duhet të pasqyrojë në mënyrë të qartë dhe të arsyetuar rezultatet e ekzaminimit të ofertave, në mënyrë që të jetë e mundur të verifikohet nëse kriteret janë zbatuar në mënyrë të njëtrajtshme ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

KËRKESA LIDHUR ME KËTË PRETENDIM

Duke u bazuar në sa më sipër, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) që të vlerësojë ligjshmërinë dhe rregullsinë e Raportit të Vlerësimit dhe të obligojë Autoritetin

Kontraktues që të vërë në dispozicion raportin e plotë dhe përfundimtar të vlerësimit të ofertave, të sqarojë arsyet përse kopja e raportit të vënë në dispozicion nuk përmban nënshkrimet e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit, si dhe të mundësojë verifikimin e dokumentimit dhe miratimit të raportit nga anëtarët përkatës të këtij Komisioni. Gjithashtu, kërkojmë që OSHP-ja të vlerësojë nëse raporti përmban arsyetim të detajuar lidhur me mënyrën se si është konstatuar përmbushja e secilës kërkesë të Dosjes së Tenderit nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, duke kërkuar identifikimin e dokumenteve dhe dëshmive konkrete mbi të cilat është mbështetur vlerësimi për stafin profesional dhe teknik, përvojën e ngjashme dhe pajisjet e kërkuara. Po ashtu, kërkojmë që të sigurohet se raporti dhe dokumentacioni mbështetës janë në dispozicion për verifikimin e ligjshmërisë dhe transparencës së procesit të vlerësimit. Në përfundim, kërkojmë që OSHP-ja të konstatojë nëse Autoriteti Kontraktues ka siguruar transparencë të mjaftueshme dhe nëse rekomandimi për kontratë është mbështetur në një vlerësim të dokumentuar, objektiv dhe në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

IV. PËRFUNDIM

Nga të gjitha faktet, provat dhe argumentet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim dhe në këtë ankesë, konsiderojmë se është dëshmuar në mënyrë të qartë se Grupi i Operatorëve Ekonomikë EGO ELSA SH.P.K. dhe Horn & Co. Kosova SH.P.K. i ka përmbushur kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, ndërsa eliminimi i ofertës sonë është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe aktet nënligjore përkatëse. Dokumentacioni i dorëzuar në ofertë, i plotësuar me sqarimet dhe provat e paraqitura përmes kërkesës për rishqyrtim dhe kësaj ankese, dëshmon se pretendimet e Autoritetit Kontraktues lidhur me kualifikimet profesionale, përvojën dhe angazhimin e stafit teknik e profesional nuk qëndrojnë. Përkundrazi, Autoriteti Kontraktues ka bërë një vlerësim të njëanshëm dhe formal të dokumentacionit, duke mos i shqyrtuar provat në tërësi, duke mos i trajtuar argumentet tona në mënyrë individuale dhe duke nxjerrë përfundime që nuk mbështeten në përmbajtjen reale të dokumenteve të dorëzuara. Për më tepër, me vendimin e datës 19.11.2026, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim pa iu përgjigjur në mënyrë konkrete dhe bindëse argumenteve dhe provave thelbësore të paraqitura nga ana jonë.

Në të njëjtën kohë, shprehim shqetesimin serioz dhe të bazuara se edhe Grupi i Operatorëve Ekonomikë i rekomanduar për kontratë, HARST Group SH.P.K. dhe Hexagon Construction SH.P.K., nuk i përmbush të gjitha kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Këto dyshime nuk mbështeten vetëm në pretendimet e ankuesit, por edhe në rrethanat konkrete të procedurës, veçanërisht në mohimin e qasjes në dokumentacionin thelbësor të ofertës së operatorit të rekomanduar, përfshirë dëshmitë për kualifikimet e stafit profesional dhe teknik, përvojën në punët e ngjashme dhe posedimin apo disponueshmërinë e pajisjeve të kërkuara. Përpjekja për ta mbuluar pothuajse të gjithë dokumentacionin e tenderit me deklarime të përgjithshme për sekret afarist, pa identifikim dhe arsyetim konkret të pjesëve që pretendohet se janë konfidenciale, ka cenuar të drejtën tonë për qasje dhe ka pamundësuar verifikimin efektiv të ligjshmërisë së vlerësimit.

Një element veçanërisht shqetësues dhe me rëndësi thelbësore për këtë çështje është mendimi i ndarë i anëtarit të Komisionit të Vlerësimit, z. Pajtim Mustafa, i evidentuar në faqen 10 të Raportit të Vlerësimit. Ky anëtar ka shprehur mospajtimin e tij me rekomandimin për dhënie të kontratës, duke ngritur pikërisht çështje që lidhen me mungesën e dëshmive për realizimin e punëve të ngjashme në fushën e osmozës dhe mungesën e dëshmisë për pajisjet e nevojshme për sistemet e gazrave medicinale sipas standardit DIN EN ISO 7396-1. Pra, kemi të bëjmë me vërejtje konkrete të evidentuara nga

një anëtar i vetë Komisionit të Vlerësimit, i cili ka pasur qasje në dokumentacionin e ofertës dhe ka marrë pjesë në procesin e vlerësimit. Ky fakt e bën të domosdoshëm verifikimin e plotë dhe të paanshëm të ofertës së rekomanduar dhe nuk lejon që çështjet e ngritura të anashkalohen apo të konsiderohen të parëndësishme.

Në këto rrethana, krijohet një situatë e papranueshme nga pikëpamja e ligjshmërisë së prokurimit publik: oferta jonë është eliminuar, ndonëse përmes dokumentacionit dhe argumenteve të paraqitura kemi dëshmuar përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit, ndërsa oferta e operatorit të rekomanduar është shpallur e suksesshme pavarësisht vërejtjeve konkrete të evidentuara nga një anëtar i Komisionit të Vlerësimit dhe pamundësisë sonë për të verifikuar dokumentacionin mbi të cilin është mbështetur ky rekomandim. Një standard i tillë i ndryshëm i vlerësimit, ku dokumentacioni i ankuesit interpretohet në mënyrë kufizuese, ndërsa përmbushja e kritereve nga operatori i rekomanduar nuk mund të verifikohet për shkak të mohimit të qasjes, cenon parimet e transparencës, trajtimit të barabartë, objektivitetit dhe konkurrencës së ndershme.

Përfundimisht, qëndrimi ynë është se eliminimi i Grupit të Operatorëve Ekonomikë EGO ELSA SH.P.K. dhe Horn & Co. Kosova SH.P.K. është i pabazuar dhe në kundërshtim me LPP-në dhe aktet nënligjore përkatëse, ndërsa vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk i ka korrigjuar këto shkelje, por i ka lënë ato në fuqi. Nuk mund të lejohet që një operator ekonomik, i cili ka paraqitur dokumentacionin dhe dëshmitë për përmbushjen e kërkesave të tenderit, të eliminohet përmes interpretimeve formale dhe vlerësimeve të pambështetura, ndërkohë që ligjshmëria e rekomandimit për kontratë mbetet e kontestuar edhe nga vetë një anëtar i Komisionit të Vlerësimit.

Për të gjitha këto arsye, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të mos e trajtojë këtë çështje vetëm si mospajtim të zakonshëm me rezultatin e vlerësimit, por si kontestim të ligjshmërisë së vetë procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave. Kërkojmë që OSHP-ja të shqyrtojë në mënyrë të plotë dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit, të verifikojë përmbushjen e kritereve nga të dy grupet e operatorëve ekonomikë, të vlerësojë ligjshmërinë e kufizimit të qasjes në dokumentacion dhe të marrë parasysh mendimin e ndarë të anëtarit të Komisionit të Vlerësimit. Si rrjedhojë, kërkojmë aprovimin e ankesës si të bazuar, anulimin e vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dhe të vendimit për eliminimin e ofertës sonë, si dhe kthimin e aktivitetit të prokurimit në rivlerësim, me obligimin që të gjitha ofertat të shqyrtohen sipas të njëjtave standarde, në mënyrë të plotë, objektive, transparente dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

V. KËRKESË PËR VENDIM

Në bazë të fakteve dhe argumenteve të paraqitura në këtë ankesë, dokumentacionit të bashkëngjitur dhe dispozitave ligjore në fuqi, Grupi i Operatorëve Ekonomikë **EGO ELSA SH.P.K. dhe Horn & Co. Kosova SH.P.K.**, me lider të grupit EGO ELSA SH.P.K., i propozon Organit Shqyrtues të Prokurimit që të nxjerrë këtë:

VENDIM

1. Të aprovojë si të bazuar ankesën e Grupit të Operatorëve Ekonomikë **EGO ELSA SH.P.K. dhe Horn & Co. Kosova SH.P.K.**;
2. Të anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues – SHSKUK, të datës 19.11.2026, për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, si dhe vendimin për eliminimin e ofertës së ankuesit;

3. Ta kthejë lëndën në rivlerësim pranë Autoritetit Kontraktues, me obligim që rivlerësimi të bëhet në mënyrë të plotë, objektive, individuale dhe proporcionale, duke marrë parasysh të gjithë dokumentacionin dhe dëshmitë e paraqitura nga ankuesi dhe duke zbatuar kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik;
4. Të konstatojë shkeljet materiale dhe procedurale të evidentuara në këtë ankesë, përfshirë ato që kanë të bëjnë me vlerësimin e ofertës, qasjen në dokumentacion dhe transparencën e procedurës së prokurimit;
5. Të urdhërojë ndërmarrjen e çdo mase tjetër ligjore që OSHP-ja e vlerëson të drejtë dhe të nevojshme për eliminimin e shkeljeve të konstatuara dhe sigurimin e zhvillimit të ligjshëm të procedurës së prokurimit.

Si Operator Ekonomik, jemi të gatshëm të ofrojmë çdo informacion dhe provë shtesë që mund të kërkoni për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përveç shkeljeve të konstatuara më parë, ne gjithashtu jemi të dëmtuar nga shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës, përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim. si dhe ankese. Këto shpenzime përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- **Shpenzimet për përgatitjen e ofertës**: Këto përfshijnë kostot për hartimin e dokumenteve, analiza të nevojshme për përgatitjen e ofertës, konsulta ligjore dhe shpenzimet administrative që kanë ndodhur gjatë periudhës përgatitore.
- **Shpenzimet për përgatitjen e Kërkesës për Rishqyrtim dhe ankeses**: Këto përfshijnë kostot për hartimin e kërkesës, mbështetjen ligjore dhe administratën e nevojshme për paraqitjen e ankesës, si dhe përgatitjen e dokumentacionit dhe provave përkatëse.
- **Fitimet e pritura**: Në përputhje me ofertën e bërë, ne kishim parashikuar fitime të caktuara nëse do të shpallej fituesi i procedurës së prokurimit. Eliminimi i papranueshëm nga procedura ka rezultuar në humbjen e mundësisë për të realizuar këto fitime.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*
h) *Kerkesa per rishqyrtim,*
i) *Lista e ATK – së (dëshmi qe puntoret e kontestuar jan pjes e kompanisë)*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – SHSKUK

Për Aktivitetin e Prokurimit: 220-26-7028-5-1-1dhe numër te brendshëm: 220-26-072-511

Sa i përket tenderit për: "Renovimi i Objektit të Hemodializës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës"

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Grupi i Operatorëve Ekonomikë EGO ELSA SH.P.K. dhe Horn & Co. Kosova SH.P.K.

Rr. E Pejës, p.nr. Llapllasele,
(Adresa)

Prishtinë 10500

+383(0) 49/230-122 N/A

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

z. Egon Hoti - Drejtor

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

egoelsa.shpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

18/11/2026

Në emër të Grupit të OE, nga Lideri i Grupit: EGO ELSA SH.P.K.

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontratë – 20.08.2026
- Hapja e tenderit – 02.10.2026
- Njoftimi mbi vendimin e AK – 13.11.2026
- Kërkesa për Rishqyrtim – 18.11.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet* -

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

Jemi njoftuar përmes platformës elektronike

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

I. BAZA LIGJORE E SHKELUR

Statusi i operatorit ekonomik si palë me interes

Grupi i Operatorëve Ekonomikë EGO ELSA SH.P.K. dhe Horn & Co. Kosova SH.P.K., në cilësinë e ofertuesit në aktivitetin përkatës të prokurimit, konsiderohet palë me interes juridik dhe ekonomik për të kërkuar rishqyrtimin e vendimit të Autoritetit Kontraktues.

Ky interes buron nga fakti se grupi i operatorëve ekonomikë ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit, ka përgatitur dhe dorëzuar ofertën e tij në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ndërsa më pas është eliminuar nga procedura dhe Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për kontratë një operator tjetër ekonomik.

Rrjedhimisht, vendimi i kontestuar ndikon drejtpërdrejt në të drejtat dhe interesat legjitime të grupit të operatorëve ekonomikë, pasi eliminimi i tij e ka privuar nga mundësia për vazhdimin e pjesëmarrjes në procedurë, vlerësimin e ofertës dhe mundësinë reale për t'u shpërblyer me kontratë.

Për më tepër, grupi ka interes të drejtpërdrejtë në verifikimin e ligjshmërisë, objektivitetit dhe transparencës së procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, përfshirë mënyrën se si janë trajtuar dokumentet dhe dëshmitë e operatorëve të tjerë ekonomikë.

Prandaj, në bazë të pozitës së tij si pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit dhe pasojave të drejtpërdrejta juridike dhe ekonomike të vendimit të kontestuar, grupi i operatorëve ekonomikë ka legjitimitet të plotë për të paraqitur këtë kërkesë për rishqyrtim dhe për të kërkuar rivlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të Autoritetit Kontraktues.

BAZA LIGJORE E SHKELUR

Në mbështetje të fakteve, dokumentacionit të ofertës dhe veprimeve të ndërmarra nga Autoriteti Kontraktues gjatë procedurës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, grupi i operatorëve ekonomikë pretendon se vendimi për eliminimin e ofertës sonë dhe rekomandimin e një operatori tjetër ekonomik për kontratë cenon dispozitat e mëposhtme ligjore si ne vijim:

A. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik

Neni 1 – Qëllimi

Përcakton qëllimin e LPP-së për të siguruar përdorimin efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike, duke garantuar integritetin dhe përgjegjshmërinë në procesin e prokurimit publik.

Neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti

Obligon autoritetet kontraktuese që fondet publike t'i përdorin në mënyrë sa më ekonomike dhe efikase, duke siguruar vlerën më të mirë për paranë publike dhe duke mos lejuar veprime që cenojnë konkurrencën dhe rezultatet e procedurës.

Neni 7 – Barazia në trajtimin e operatorëve ekonomikë

Kërkon që të gjithë operatorët ekonomikë të trajtohen në mënyrë të barabartë, të drejtë dhe jodiskriminuese. Autoriteti Kontraktues duhet të zbatojë të njëjtat standarde dhe kritere për të gjithë ofertuesit, pa favorizuar apo diskriminuar asnjërin prej tyre.

Neni 10 – Mjetet për promovimin e transparencës

Përcakton detyrimin për transparencë në procesin e prokurimit publik, përfshirë publikimin dhe ofrimin e informatave përkatëse, në mënyrë që procesi të jetë i hapur, i kontrollueshëm dhe i verifikueshëm.

Neni 11 – Informatat sekrete afariste

Rregullon mbrojtjen e informatave që përbëjnë sekrete afariste, duke përcaktuar kufijtë e ruajtjes së konfidencialitetit. Kjo dispozitë nuk duhet të përdoret si arsyetim i përgjithshëm për të mohuar qasjen në dokumentacionin që nuk i plotëson kushtet ligjore për t'u konsideruar sekret afarist.

Neni 27 – Dosja e tenderit

Përcakton rëndësinë dhe përmbajtjen e dosjes së tenderit, e cila duhet t'i përmbajë kërkesat, kriteret, kushtet dhe specifikimet përkatëse të aktivitetit të prokurimit. Autoriteti Kontraktues është i detyruar të veprojë në përputhje me kërkesat që vetë i ka përcaktuar në dosjen e tenderit.

Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Përcakton detyrimin e Autoritetit Kontraktues që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat ligjore. Vlerësimi duhet të jetë objektiv, profesional dhe i mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë.

Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Rregullon mundësinë e kërkimit të dokumentacionit ose informacionit shtesë nga operatorët ekonomikë, kur kjo është e nevojshme për sqarimin dhe verifikimin e ofertave, në përputhje me kufizimet ligjore. Kjo dispozitë nuk lejon ndryshimin e ofertës apo plotësimin e mangësive thelbësore në kundërshtim me ligjin.

B. Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 7 – Informatat sekrete afariste dhe qasja në dokumentacion

Përcakton se pas publikimit të njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, palët e interesuara kanë të drejtë të kenë qasje në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit. Vetëm informatat që janë klasifikuar dhe pranuar ligjërisht si sekrete afariste mund të mbeten konfidenciale. Autoriteti Kontraktues duhet të mundësojë qasje të shpejtë dhe të arsyeshme në dokumentacionin tjetër të procedurës.

Neni 40 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Përcakton se vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve duhet të bëhet në përputhje me parimet themelore të LPP-së dhe kriteret e përcaktuara paraprakisht në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk mund të ndryshojë, modifikojë, heqë apo shtojë kritere dhe kërkesa gjatë procesit të vlerësimit. Të gjithë operatorët ekonomikë duhet të vlerësohen sipas standardeve të njëjta.

Neni 97, paragrafi 1, nënparagrafi c) – Shkeljet e rënda

E klasifikon si shkelje të rëndë moslejimin ose neglizhimin e qasjes në dokumentet zyrtare, sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesuar, kur kërkesa për qasje është në përputhje me nenet 10 dhe 11 të LPP-së. Kjo dispozitë është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur Autoriteti Kontraktues refuzon ose kufizon pa bazë ligjore qasjen në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit.

C. Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike

Përveç dispozitave të LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022, për qasjen në dokumentacion zbatohen edhe dispozitat përkatëse të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Bazuar në nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP)

Lënda: Kërkesë për rishqyrtim ndaj Njoftimit mbi vendimin e AK-së të publikuar me datë 13.11.2026.

II. HYRJE DHE PËRMBLEDHJE E FAKTEVE DHE ARGUMENTEVE

Grupi i Operatorëve Ekonomikë **EGO ELSA SH.P.K. dhe Horn & Co. Kosova SH.P.K.**, në cilësinë e pjesëmarrësit në aktivitetin e prokurimit me titull **"Renovimi i Objektit të Hemodializës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës"**, me numër të prokurimit **220-26-7028-5-1-1**, paraqet këtë kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, përmes të cilit oferta e këtij grupi të operatorëve ekonomikë është eliminuar si e papërgjegjshme, ndërsa për kontratë është rekomanduar një operator tjetër ekonomik.

Pas shqyrtimit të arsyetimit të paraqitur nga Autoriteti Kontraktues në Formularin B42, si dhe pas analizimit të dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë, konsiderojmë se vendimi për eliminimin e ofertës sonë është marrë mbi një vlerësim jo të plotë, jo objektiv dhe jo të drejtë të dokumentacionit të dorëzuar, si dhe mbi një interpretim të kërkesave që nuk përputhet me përmbajtjen dhe qëllimin e Dosjes së Tenderit.

Konsiderojmë se gjatë procesit të ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertës sonë, Autoriteti Kontraktues nuk i ka trajtuar në mënyrë të gjithanshme dëshmitë dhe dokumentet e paraqitura, duke mos i vlerësuar ato në ndërlidhje me njëra-tjetrën dhe me kërkesat konkrete të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Një qasje e tillë ka rezultuar në konstatime të cilat, sipas vlerësimit tonë, nuk mbështeten në gjendjen reale të dokumentacionit të ofertës.

Në mënyrë të veçantë, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar mungesë të certifikatave për disa pozita të stafit profesional, ndonëse dokumentet përkatëse janë dorëzuar në ofertë. Gjithashtu, nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dëshmitë e paraqitura për një pjesëtar të stafit teknik, ndërsa janë konstatuar mospërputhje në datat e kontratave të punës

së disa punëtorëve, pa u marrë parasysh tërësia e dokumentacionit mbështetës dhe provat e tjera të paraqitura për të dëshmuar përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Sipas vlerësimit tonë, këto konstatime kërkojnë një shqyrtim të ri dhe të individualizuar për secilën pozitë dhe secilin pjesëtar të stafit, duke marrë parasysh dokumentet konkrete të dorëzuara, përmbajtjen e tyre, vlefshmërinë dhe lidhjen e tyre me kërkesat e Autoritetit Kontraktues. Eliminimi i një oferte duhet të mbështetet në fakte të verifikuara dhe në zbatim të drejtë të kritereve të përcaktuara paraprakisht, e jo në vlerësime të pjesshme ose interpretime që nuk reflektojnë përmbajtjen e plotë të ofertës.

Për më tepër, gjatë përpjekjeve për të siguruar qasje në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, Grupit tonë nuk i është mundësuar qasje e plotë dhe efektive në dokumentet dhe dëshmitë mbi të cilat është bazuar ekzaminimi dhe vlerësimi i ofertës së tij. Kjo e ka vështirësuar mundësinë tonë për të verifikuar nëse operatori i rekomanduar i përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe nëse kriteret janë zbatuar në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Theksojmë se kërkesa jonë për qasje në dokumentacion nuk synon cenimin e informatave që përbëjnë sekrete afariste dhe që mbrohen shprehimisht me ligj, por sigurimin e transparencës së nevojshme për të verifikuar ligjshmërinë e procedurës dhe trajtimin e barabartë të ofertuesve. Çdo kufizim i qasjes duhet të jetë i bazuar në dispozita ligjore, i arsyetuar dhe i kufizuar vetëm në informacionet që realisht gëzojnë mbrojtje ligjore.

Në këtë kontekst, konsiderojmë se çështja duhet të shqyrtohet jo vetëm nga këndvështrimi i arsyeve të eliminimit të ofertës sonë, por edhe nga këndvështrimi i zbatimit të njëtrajtshëm të kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë. Respektimi i parimit të barazisë në trajtim nënkupton që të njëjtat kërkesa dhe standarde të aplikohen në mënyrë të njëjtë, pa krijuar dallime të pajustifikuara ndërmjet ofertuesve.

Për këto arsye, përmes kësaj kërkese paraqesim pretendimet tona lidhur me mënyrën e ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertës, duke i mbështetur ato në dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik, Rregullores për Prokurimin Publik, kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe provat materiale të dorëzuara si pjesë e ofertës.

Me këtë kërkesë kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të rishqyrtojë në mënyrë të plotë dhe objektive konstatimet e paraqitura në Formularin B42, të rivlerësojë dokumentacionin e ofertës sonë, të shqyrtojë ligjshmërinë e vlerësimit të operatorit të rekomanduar për kontratë dhe të sigurojë qasje në dokumentacionin përkatës, në përputhje me dispozitat ligjore. Si rezultat i këtij rishqyrtimi, kërkojmë anulimin e vendimit të kontestuar dhe kthimin e procedurës në fazën përkatëse të rivlerësimit, me zbatimin e drejtë dhe të barabartë të kritereve për të gjithë operatorët ekonomikë.

III. PRETENDIMET ANKIMORE

Duke u bazuar në faktet dhe argumentet e paraqitura ne kete kerkesë, konsiderojmë se vendimi i dhëna nga Autoriteti Kontraktues cenonë rendë parimet dhe dispozitat e LPP-së dhe të akteve nënligjore përkatëse, për këto arsye:

PRETENDIMI 1

Vlerësimi i pasaktë i dokumentacionit për pozitën e Masterit të Emergjencave – Suad Bushi

Në arsyetimin e vendimit për eliminim, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se për pozitën përkatëse të stafit profesional, të cilën e mbulon z. Suad Bushi, nuk janë dorëzuar certifikatat e kërkuara në fushën e HSE-së dhe të sigurisë dhe shëndetit në punë nga MPMS.

Ky konstatim nuk qëndron, pasi dokumentacioni përkatës është dorëzuar në kuadër të ofertës së Grupit të Operatorëve Ekonomikë.

Në mbështetje të përmbushjes së kërkesave për këtë pozitë, në ofertë janë dorëzuar këto dokumente:

Diploma e nivelit Master në Menaxhim të Emergjencave, nr. 126/16, e datës 22.11.2016;
Certifikata e MPMS-së për Ekspert të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, nr. 0318280323, me vlefshmëri deri më 31.03.2028;
Certifikata NEBOSH International General Certificate, nr. 00254610/1285582, e datës 06.05.2022;
CV-ja e kandidatit;
Marrëveshja e angazhimit e datës 26.08.2026;
Lista e stafit

Nga dokumentacioni i lartcekur rezulton se kandidati posedon diplomën përkatëse të nivelit Master, certifikimin profesional në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë nga MPMS, si dhe certifikimin ndërkombëtar NEBOSH.

Në veçanti, certifikata e MPMS-së me numër 0318280323 është e vlefshme deri më 31.03.2028.

Për këtë arsye, konstatimi i Autoritetit Kontraktues se dokumentacioni përkatës mungon është në kundërshtim me dokumentet e dorëzuara në ofertë.

Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar që të shqyrtojë tërësinë e dokumentacionit të paraqitur dhe të vlerësojë përmbushjen e kriterit mbi bazën e provave konkrete, e jo të konstatojë mungesën e dokumenteve që gjenden në ofertën e operatorit ekonomik.

Në rast se gjatë vlerësimit ka ekzistuar ndonjë paqartësi lidhur me dokumentet e dorëzuara, Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësi të kërkojë sqarime në përputhje me nenin 59 dhe nenin 72 të LPP-së, duke respektuar kufizimet ligjore dhe pa lejuar ndryshimin thelbësor të ofertës.

Kërkesa lidhur me këtë pretendim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të rishqyrtojë dokumentacionin e z. Suad Bushi, veçanërisht certifikatën e MPMS-së nr. 0318280323 dhe certifikatën NEBOSH nr. 00254610/1285582, dhe të konstatojë se kërkesa përkatëse është përmbushur.

PRETENDIMI 2

Kërkimi i një certifikate shtesë për pozitën e Masterit të Shkencave Teknike – Avni Beqiri, ndonëse një kërkesë e tillë nuk është përcaktuar në Dosjen e Tenderit

Në arsyetimin e paraqitur në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (Formulari B42), si arsye për eliminimin e Grupit të Operatorëve Ekonomikë është evidentuar mungesa e certifikatës për pozitën e Masterit të Shkencave Teknike, të cilën e mbulon z. Avni Beqiri.

Një konstatim i tillë konsiderojmë se është i pabazuar në kërkesat konkrete të Dosjes së Tenderit, pasi Autoriteti Kontraktues ka kërkuar një kualifikim akademik të nivelit Master në Shkencat Teknike dhe përvojë profesionale prej së paku pesë (5) vitesh, por nuk ka përcaktuar në mënyrë të shprehur ndonjë certifikatë shtesë profesionale si kusht për përmbushjen e kësaj pozite.

Konkretisht, në Dosjen e Tenderit, te kërkesat për mundësitë teknike dhe/ose profesionale, është përcaktuar:

Kërkesa në Dosjen e Tenderit:

"j) Një Master i Shkencave Teknike, min. 5 vite përvojë pune."

Ndërsa, te dëshmitë e kërkuara është përcaktuar:

"Diplomat kopje, certifikatat kopje (për inxhinierët që është kërkuar të kenë certifikata)."

Nga formulimi i mësipërm rezulton qartë se Dosja e Tenderit nuk kërkon certifikatë profesionale për secilën pozitë të stafit pa dallim, por vetëm për inxhinierët dhe pozitat për të cilat një certifikatë e tillë është kërkuar shprehimisht. Rrjedhimisht, kërkesa për certifikatë nuk mund të interpretohet në mënyrë të zgjeruar dhe të zbatohet edhe për pozitën e Masterit të Shkencave Teknike, kur një kusht i tillë nuk është përcaktuar në kërkesën konkrete për këtë pozitë.

Në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, në ofertën e dorëzuar nga Grupi ynë janë përfshirë dokumentet në vijim:

Diploma Master i Shkencave Teknike, nr. 282, e datës 15.03.2017, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, përkatësisht Fakulteti i Gjeoshkencave dhe Teknologjisë;
Dokumentacioni përkatës që dëshmon përvojën profesionale të kandidatit;
CV-ja e kandidatit;
Dokumentet e tjera mbështetëse të dorëzuara në ofertë.

Pra, diploma e dorëzuar dëshmon përmbushjen e kërkesës për kualifikimin akademik, ndërsa dokumentacioni mbështetës dëshmon përvojën profesionale të kandidatit, e cila përmbush dhe tejkalon kërkesën minimale prej pesë (5) vitesh të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Paqartësia dhe kundërthënia në arsyetimin e Autoritetit Kontraktues

Për më tepër, në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, mungesa e certifikatës është arsyetuar me pretendimin se një dokument i tillë kërkohet sipas njoftimit për kontratë dhe Dosjes së Tenderit. Megjithatë, në rastin konkret, një kërkesë e tillë nuk figuron në përshkrimin e pozitës së Masterit të Shkencave Teknike.

Kjo paraqet një mospërputhje ndërmjet kërkesës reale të përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe mënyrës se si Autoriteti Kontraktues e ka interpretuar dhe zbatuar atë gjatë vlerësimit të ofertës sonë.

Duhet theksuar se Grupi ynë i Operatorëve Ekonomikë i ka përmbushur kërkesat për certifikata në të gjitha pozitat ku Dosja e Tenderit i ka kërkuar ato shprehimisht. Për rrjedhojë, nuk mund të kërkohet një dokument shtesë për një pozitë për të cilën Autoriteti Kontraktues nuk e ka përcaktuar një kusht të tillë paraprakisht.

Baza ligjore e pretendimit

Sipas nenit 27 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, Dosja e Tenderit përcakton kërkesat dhe kushtet që duhet të përmbushen nga operatorët ekonomikë. Autoriteti Kontraktues është i obliguar që gjatë vlerësimit të ofertave të veprojë në përputhje me kërkesat e publikuara dhe nuk mund të vendosë kushte shtesë që nuk janë paraparë paraprakisht.

Po ashtu, neni 40, paragrafët 1 dhe 2, të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik përcakton detyrimin për zbatimin e kritereve të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në Dosjen e Tenderit gjatë procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Ndërkaq, neni 7 i Ligjit për Prokurimin Publik garanton trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, duke kërkuar që të gjithë ofertuesit të vlerësohen sipas të njëjtave kritere dhe standardeve të përcaktuara paraprakisht.

Në këtë drejtim, kërkimi i një certifikate që nuk është përcaktuar si kusht për pozitën konkrete përbën interpretim të zgjeruar dhe zbatim të gabuar të kërkesave të Dosjes së Tenderit, duke cenuar parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Kërkesa lidhur me këtë pretendim

Duke u bazuar në faktet dhe argumentet e paraqitura më lart, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që:

Të rishqyrtojë konstatimin për mungesën e certifikatës në pozitën e Masterit të Shkencave Teknike – Avni Beqiri;
Të konstatojë se për këtë pozitë Dosja e Tenderit ka kërkuar diplomën përkatëse të nivelit Master dhe përvojën profesionale prej së paku pesë (5) vitesh, pa përcaktuar ndonjë certifikatë shtesë profesionale;
Të marrë në konsideratë diplomën, CV-në dhe dokumentacionin e përvojës profesionale të dorëzuar në ofertë, si dëshmi të përmbushjes së kërkesave të përcaktuara;
Të tërheqë këtë konstatim si arsye për eliminimin e ofertës sonë dhe të vazhdojë me rivlerësimin e drejtë dhe të plotë të dokumentacionit të dorëzuar.

PRETENDIMI 3

Mosvlerësimi i drejtë i dokumentacionit për pozitën e Bachelorit të Makinerisë – Egon Hoti

Në kuadër të arsyetimit të eliminimit, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se dokumentacioni për pozitën e Bachelorit të Makinerisë nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Ky vlerësim nuk pasqyron tërësinë e dokumentacionit të dorëzuar në ofertë, pasi për kandidatin z. Egon Hoti janë paraqitur dëshmi konkrete për kualifikimin akademik, certifikimin nga prodhuesi, përvojën profesionale dhe përgatitjen në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Në ofertë janë dorëzuar dokumentet si në vijim:

Diploma Bachelor në Inxhinieri të Makinerisë, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, nr. 1304, e datës 21.12.2021;
Certifikata e trajnimit nga prodhuesi Medicop për instalimin, servisimin dhe testimin përfundimtar të sistemeve të gazrave medicinale sipas standardit ISO 7396-1, e datës 16.06.2022, me vlefshmëri deri më 16.06.2027;
CV-ja e kandidatit;
Kontrata e punës dhe dokumentacioni tjetër që dëshmon përvojën profesionale;
Referenca e datës 13.06.2025, e cila dëshmon përfshirjen e kandidatit në më shumë se 25 kontrata të realizuara në fushën e gazrave medicinale në QKUK/SHSKUK;
Certifikata e trajnimit përgatitor 150-orësh për Ekspert të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, nr. SSHP1004-02/25, e datës 05.06.2025, e lëshuar nga European College of Kosovo;
Licenca e ofruesit të trajnimit, nr. 05/2018, e datës 18.07.2018.

Nga këto dokumente rezulton se kandidati posedon diplomën përkatëse universitare, certifikimin e prodhuesit për instalimin dhe testimin e sistemeve të gazrave medicinale sipas ISO 7396-1, si dhe përvojën profesionale të dokumentuar në këtë fushë.

Në veçanti, referenca e datës 13.06.2025 dëshmon angazhimin e kandidatit në më shumë se 25 kontrata që lidhen me gazrat medicinale në institucionet shëndetësore përkatëse. Kjo dëshmi duhet të vlerësohet së bashku me kontratën e punës, CV-në dhe dokumentacionin tjetër të paraqitur.

Gjithashtu, certifikata e trajnimit përgatitor 150-orësh për Ekspert të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, së bashku me licencën e ofruesit të trajnimit, është pjesë e dokumentacionit të dorëzuar dhe duhet të shqyrtohet në raport me kërkesën përkatëse të Dosjes së Tenderit.

Nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur ndonjë paqartësi lidhur me natyrën e certifikatës së prodhuesit, përvojën e kandidatit apo dokumentacionin e trajnimit në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, ka qenë e mundur të kërkohen sqarime në përputhje me nenet 59 dhe 72 të LPP-së, pa ndryshuar përmbajtjen thelbësore të ofertës.

Nuk është e drejtë që dokumentet e dorëzuara të mos vlerësohen në tërësi ose të konsiderohen të pamjaftueshme pa u dhënë arsyetim konkret se cilën kërkesë të përcaktuar në Dosjen e Tenderit nuk e përmbush secila dëshmi.

Kërkesa lidhur me këtë pretendim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të rivlerësojë në mënyrë të plotë dokumentacionin e z. Egon Hoti, duke marrë parasysh diplomën, certifikatën e prodhuesit Medicop, referencën për më shumë se 25 kontrata, dokumentacionin e përvojës profesionale dhe certifikatën e

trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe të konstatojë përmbushjen e kritereve përkatëse të Dosjes së Tenderit.

PRETENDIMI 4

Vlerësimi i pasaktë i datave të kontratave dhe mosmarrja parasysh e dëshmive të marrëdhënies së punës për shtatë (7) pjesëtarët e stafit teknik

Në arsyetimin e eliminimit, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar mospërputhje në datat e kontratave të punës për shtatë (7) pjesëtarë të stafit teknik, duke vënë në dyshim përmbushjen e kërkesave lidhur me angazhimin dhe marrëdhënien e tyre të punës.

Megjithatë, ky konstatim është bërë pa u shqyrtuar në tërësi dokumentacioni i dorëzuar në ofertë dhe pa u marrë parasysh dëshmitë shtesë që pasqyrojnë marrëdhëniet e punës dhe deklarimet përkatëse në Administratën Tatimore të Kosovës.

Punëtorët për të cilët është konstatuar mospërputhje janë:

Fadil Hoti;
Valton Aliu (i evidentuar në Njoftimin mbi vendimin e AK-së si Valon Aliu);
Avni Hoti (i evidentuar në dokumentacionin e ATK-së si Avni Kalina, lidhur me kete ka ndryshim mbiemri per qka ju kemi njoftuar edhe ne dorezimin fillestar te dosjes se tenderit);
Fledi Hoti;
Egon Hoti;
Besian Murati;
Ferid Shabani.

Për këta punëtorë janë dorëzuar dëshmi të ndryshme që duhet të vlerësohen së bashku me kontratat e punës dhe dokumentacionin tjetër të stafit.

Në veçanti, në dokumentacionin e dorëzuar janë përfshirë dëshmitë e ATK-së si në vijim:

Për Fadil Hotin – dëshmia e ATK-së, nr. 11;
Për Valton Aliun – dëshmia e ATK-së, nr. 26;
Për Avni Hotin/Avni Kalinën – dëshmia e ATK-së, nr. 3;
Për Fledi Hotin – dëshmia e ATK-së, nr. 14;
Për Egon Hotin – dëshmia e ATK-së, nr. 9;
Për Besian Muratin – dëshmia e ATK-së, nr. 8;
Për Ferid Shabanin – dëshmia e ATK-së, nr. 13.

Provë: Lista e ATK-së

Këto dëshmi duhet të analizohen në raport me kontratat e punës, listat e stafit dhe dokumentet e tjera të dorëzuara, me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike për secilin punëtor veç e veç.

Sa i përket Valton Aliut, ne vendimin e AK emri figuron si Valon Aliu mendoj se ju keni referuar gabim emrit.

Po ashtu, lidhur me Avni Hotin, i cili në dokumentacionin e ATK-së figuron me mbiemrin Kalina, kërkohet që të merret parasysh dokumentacioni që dëshmon se bëhet fjalë për të njëjtin person dhe se dallimi në mbiemër lidhet me ndryshimin e mbiemrit.

Vlerësimi i Autoritetit Kontraktues nuk duhet të kufizohet vetëm në krahasimin formal të datave të paraqitura në dokumente të veçanta, por duhet të marrë parasysh të gjitha dëshmitë relevante që mundësojnë verifikimin e gjendjes faktike.

Gjithashtu, duhet të bëhet dallimi ndërmjet datës së lidhjes së një kontrate të caktuar dhe ekzistimit të marrëdhënies së punës, pasi këto nuk janë domosdoshmërisht e njëjta gjë. Dokumentet e ATK-së dhe provat e tjera mund të ndihmojnë në verifikimin e vazhdimësisë së angazhimit, por duhet të shqyrtohen në raport me kontratat dhe dokumentet përkatëse.

Në këtë kuptim, kërkohet që Autoriteti Kontraktues të bëjë vlerësim individual për secilin nga shtatë punëtorët dhe të identifikojë saktësisht se cila kërkesë nuk është përmbushur dhe mbi cilën provë është mbështetur ky konstatim.

Nëse ka pasur paqartësi lidhur me dokumentacionin, Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësi të kërkojë sqarime në përputhje me nenin 59 dhe nenin 72 të LPP-së, brenda kufijve të lejuar ligjorë.

Kërkesa lidhur me këtë pretendim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të rishqyrtojë të gjithë dokumentacionin e shtatë punëtorëve të lartcekur, përfshirë kontratat e punës, dëshmitë e ATK-së dhe dokumentet e tjera mbështetëse, dhe të bëjë vlerësim individual të secilit rast, duke mos u mbështetur vetëm në mospërputhje formale të datave pa shqyrtuar tërësinë e provave.

PRETENDIMI 5

Mosofrimi i qasjes së plotë dhe efektive në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë – ekzistenca e mospajtimit brenda Komisionit të Vlerësimit lidhur me përmbushjen e kritereve të kapacitetit teknik dhe profesional, cenimi i transparencës dhe pamundësimi i verifikimit të ligjshmërisë së rekomandimit për kontratë

Pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Grupi i Operatorëve Ekonomikë ka kërkuar qasje në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, me qëllim të verifikimit të përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe të ligjshmërisë së procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave.

Më datë **16.11.2026**, Grupi ynë ka paraqitur kërkesë për qasje në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit. Me këtë rast, nga ana e Menaxherit të Prokurimit është bërë e ditur se dokumentacioni është voluminoz dhe se nevojitet kohë për përgatitjen e tij në USB, për çka qasja është shtyrë për datën **17.11.2026**.

Megjithatë, edhe më datë 17.11.2026, dokumentacioni i vënë në dispozicion ka qenë i kufizuar dhe nuk ka përfshirë dokumentet thelbësore mbi të cilat është bazuar vlerësimi i ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Dokumentacioni i ofruar ka përfshirë kryesisht:

1. Profilin e kompanisë;
2. Aneksin 1 – Specifikimet teknike;
3. Përshkrimin e çmimeve;
4. Paramasën;
5. Formularin e tenderit;
6. Raportin e vlerësimit.

Ndërsa nuk është mundësuar qasja në dokumentacionin thelbësor që dëshmon përmbushjen e kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional, konkretisht:

- Dokumentacionin e stafit profesional dhe teknik, përfshirë diplomat, licencat, certifikatat, CV-të dhe dëshmitë e përvojës profesionale;
- Kontratat, referencat dhe dëshmitë për realizimin e punëve të ngjashme;
- Dokumentet që dëshmojnë posedimin, disponueshmërinë ose sigurimin e pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për realizimin dhe testimin e instalimeve;
- Dëshmitë teknike dhe profesionale lidhur me përmbushjen e kërkesave për instalimin dhe testimin e sistemeve të gazrave medicinale;
- Dokumentet e tjera mbështetëse që janë përdorur për të konstatuar përmbushjen e kritereve të Dosjes së Tenderit.

RËNDËSIA E DOKUMENTACIONIT TË MUNGUAR DHE EKZISTENCA E DYSHIMEVE KONKRETE LIDHUR ME PËRMBUSHJEN E KRITEREVE

Mungesa e qasjes në këto dokumente është veçanërisht problematike duke marrë parasysh natyrën dhe kompleksitetin e aktivitetit të prokurimit, i cili përfshin punë në fushën e HVAC-së, ventilimit, osmozës dhe instalimeve të gazrave medicinale, për të cilat Dosja e Tenderit përcakton kërkesa specifike teknike dhe profesionale.

Në këtë drejtim, nuk mjafton vetëm të konstatohet se operatori ekonomik i rekomanduar ka dorëzuar ofertën dhe dokumentet e përgjithshme të tenderit. Është e domosdoshme të verifikohet nëse ai i ka përmbushur realisht të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, përmes dokumenteve dhe dëshmive konkrete që duhet të jenë pjesë e ofertës së tij.

Në veçanti, duhet të mundësohet verifikimi i dokumentacionit që dëshmon përmbushjen e kërkesave për instalimin dhe testimin e sistemeve të gazrave medicinale sipas standardit **DIN EN ISO 7396-1**, përfshirë dëshmitë për disponueshmërinë, përshtatshmërinë dhe aftësinë e pajisjeve dhe instrumenteve të kërkuara për testimin dhe verifikimin e këtyre instalimeve.

Një element veçanërisht i rëndësishëm, i cili e fuqizon këtë pretendim, rezulton drejtpërdrejt nga vetë Raporti i Vlerësimit të Tenderit, në faqen 10 të tij, ku është evidentuar mendimi i ndarë i anëtarit të Komisionit të Vlerësimit, z. Pajtim Mustafa.

Në këtë faqe, z. Pajtim Mustafa, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të ofertave, ka shprehur mospajtimin e tij me rekomandimin për shpërblimin me kontratë të Grupit të Operatorëve Ekonomikë të përbërë nga HARS Group SH.P.K. dhe HEXAGON CONSTRUCTION SH.P.K., duke konstatuar se, sipas vlerësimit të tij, ky grup nuk i plotëson kriteret për t'u shpallur fitues.

Në arsyetimin e tij, ndër të tjera, ai ka theksuar dy çështje thelbësore:

1. **Mungesën e dëshmive për realizimin e punëve të ngjashme në fushën e osmozës**, duke vënë në pah se nuk është dëshmuar përmes kontratave apo referencave se operatori ekonomik ka realizuar punë të ngjashme për sistemin e osmozës, ashtu siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.
2. **Mungesën e dëshmisë për pajisjen e nevojshme për sistemin e gazrave medicinale**, duke theksuar se nuk është paraqitur dëshmi për pajisjen për sistemin e gazrave medicinalë sipas standardit DIN EN ISO 7396-1.

Në përfundim të arsyetimit të tij, anëtari i Komisionit ka shprehur qëndrimin se operatori ekonomik në fjalë është i papërgjegjshëm.

Ky konstatim ka rëndësi të veçantë juridike dhe faktike, pasi nuk bëhet fjalë për një dyshim të ngritur vetëm nga Grupi ynë i Operatorëve Ekonomikë, por për vërejtje konkrete të evidentuara nga vetë njëri prej anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit, i cili ka pasur qasje në dokumentacionin e ofertës dhe ka marrë pjesë në procesin e ekzaminimit dhe vlerësimit të saj.

Për rrjedhojë, ekziston një mospajtim i dokumentuar brenda vetë Komisionit të Vlerësimit lidhur me një çështje thelbësore të këtij aktiviteti të prokurimit: nëse operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka përmbushur apo jo kërkesat e Dosjes së Tenderit për kapacitetin teknik dhe profesional.

Në këtë kontekst, vërejtjet e anëtarit të Komisionit nuk mund të trajtohen si çështje dytësore apo thjesht formale, pasi ato lidhen drejtpërdrejt me dy kërkesa të rëndësishme të Dosjes së Tenderit: përvojën në realizimin e punëve të ngjashme për sistemin e osmozës dhe disponueshmërinë e pajisjeve të kërkuara për instalimin dhe testimin e sistemeve të gazrave medicinale sipas standardit DIN EN ISO 7396-1.

Këto janë pikërisht dokumentet dhe dëshmitë në të cilat Grupi ynë nuk ka pasur mundësi të ketë qasje të plotë, ndonëse ato janë vendimtare për të verifikuar nëse rekomandimi për kontratë është bërë në përputhje me kërkesat e publikuara.

Rrjedhimisht, në rrethanat konkrete, ekziston **dyshim i bazuar dhe i mbështetur në një konstatim të dokumentuar brenda vetë Komisionit të Vlerësimit**, se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë mund të mos i ketë përmbushur të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me përvojën në realizimin e punëve të ngjashme për sistemin e osmozës dhe me pajisjet e nevojshme për sistemin e gazrave medicinale sipas standardit DIN EN ISO 7396-1.

Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues ka pasur detyrimin që t'i shqyrtojë dhe t'i trajtojë në mënyrë të arsyetuar këto vërejtje, duke siguruar që rekomandimi për kontratë të mbështetet në dëshmi konkrete dhe në një vlerësim objektiv të të gjitha kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Theksojmë se Grupi ynë nuk po pretendon si fakt përfundimtar se operatori ekonomik i rekomanduar nuk i përmbush kriteret, pasi dokumentacioni përkatës nuk na është vënë në dispozicion për një verifikim të pavarur. Megjithatë, ekzistenca e mendimit të kundërt të një anëtari të Komisionit, së bashku me mungesën e qasjes në dokumentet që lidhen

drejtpërdrejt me këto vërejtje, krijon nevojën e domosdoshme për një verifikim të plotë, objektiv dhe transparent.

BAZA LIGJORE E PRETENDIMIT

Në këtë drejtim, neni 10, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik përcaktojnë detyrimin për mbajtjen e dosjes së plotë të aktivitetit të prokurimit, e cila përfshin dokumentet dhe informacionet që lidhen me aktivitetin e prokurimit ose që janë përdorur gjatë zhvillimit të tij.

Neni 10, paragrafi 3, i LPP-së përcakton obligimin e Autoritetit Kontraktues që, pas kërkesës, të sigurojë qasje të menjëhershme dhe të arsyeshme në dosjet e aktivitetit të prokurimit, me përjashtim të dokumenteve që përbëjnë sekret afarist.

Po ashtu, neni 11 i LPP-së përcakton kufijtë e mbrojtjes së informatave sekrete afariste dhe nuk lejon që ky koncept të përdoret në mënyrë të përgjithshme për të penguar transparencën dhe qasjen në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit.

Në të njëjtën linjë, neni 7, paragrafët 4–7, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik rregullon qasjen në dokumentacionin e prokurimit dhe trajtimin e informatave sekrete afariste.

Veçanërisht, paragrafët 7.6.2 dhe 7.6.3 përcaktojnë procedurën konkrete për përgatitjen e versioneve të pastruara të dokumenteve dhe ofrimin e qasjes pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Paragrafi 7.6.3 përcakton se, pas kërkesës për qasje nga operatori ekonomik dhe pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së (B58), Zyrtari i Prokurimit duhet të ofrojë qasje të menjëhershme në versionin e pastruar dhe të mbajë procesverbal, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.

Për më tepër, neni 97, paragrafi 1, nënparagrafi c), i Rregullores Nr. 001/2022 e përcakton si shkelje serioze mohimin dhe/ose neglizhimin e qasjes në dokumentet zyrtare, kur kërkesa për qasje është në përputhje me nenet 10 dhe 11 të LPP-së.

Gjithashtu, zbatimi i këtyre dispozitave duhet të interpretohet në harmoni me Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, i cili garanton të drejtën e qasjes në dokumentet publike dhe përcakton se kufizimet e kësaj të drejte duhet të mbështeten në baza ligjore dhe të arsyetohen në mënyrë konkrete.

KËRKESA LIDHUR ME KËTË PRETENDIM

Duke u bazuar në faktet, argumentet dhe rrethanat e paraqitura, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues:

1. Të na mundësojë qasje të plotë dhe efektive në dokumentacionin e ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.
2. Të na vërë në dispozicion dokumentacionin për kualifikimet, licencat, certifikatat, CV-të dhe përvojën profesionale të stafit teknik dhe profesional.
3. Të na mundësojë qasje në kontratat, referencat dhe dëshmitë e punëve të ngjashme të realizuara, me theks të veçantë në dëshmitë që provojnë realizimin e punëve të ngjashme në fushën e osmozës.

4. Të na vërë në dispozicion dëshmitë për posedimin, disponueshmërinë ose sigurimin e pajisjeve dhe instrumenteve të kërkuara për realizimin, testimin dhe verifikimin e instalimeve të gazrave medicinale, përfshirë dokumentacionin përkatës sipas standardit DIN EN ISO 7396-1.
5. Të na mundësojë qasje në dokumentacionin tjetër teknik dhe profesional mbi të cilin është bazuar konstatimi i Autoritetit Kontraktues për përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit.
6. Të trajtojë dhe të japë arsyetim konkret lidhur me vërejtjet e evidentuara në faqen 10 të Raportit të Vlerësimit nga anëtari i Komisionit, z. Pajtim Mustafa, veçanërisht lidhur me mungesën e dëshmive për punët e ngjashme në fushën e osmozës dhe mungesën e dëshmisë për pajisjet e kërkuara sipas standardit DIN EN ISO 7396-1.
7. Në rast se ndonjë pjesë e dokumentacionit konsiderohet sekret afarist, të identifikojë konkretisht dokumentin dhe pjesët e mbrojtura, bazën ligjore të kufizimit dhe të na vërë në dispozicion versionin e pastruar ose përmbledhjen jo-konfidenciale.
8. Të mbajë procesverbal për qasjen në dokumentacion, në përputhje me procedurën e përcaktuar në Rregulloren Nr. 001/2022.

Grupi ynë rezervon të drejtën që, pas sigurimit të qasjes në dokumentacionin e plotë, të analizojë dhe të paraqesë pretendime shtesë dhe prova konkrete pranë organeve kompetente të shqyrtimit, nëse nga dokumentacioni rezultojnë mospërmbushje të kritereve të Dosjes së Tenderit ose shkelje të dispozitave ligjore nga Autoriteti Kontraktues.

PRETENDIMI 6

Mangësitë në raportin e vlerësimit – mungesa e arsyetimit të detajuar dhe pamundësimi i verifikimit të ligjshmërisë së vlerësimit të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktues, Grupi ynë ka pranuar edhe një kopje të raportit të vlerësimit të ofertave.

Megjithatë, nga shqyrtimi i këtij dokumenti janë evidentuar mangësi që kërkojnë sqarim dhe verifikim nga Autoriteti Kontraktues.

Në kopjen e raportit të pranuar nuk figurojnë nënshkrimet e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit, ndërsa përmbajtja e tij nuk paraqet në mënyrë të mjaftueshme dhe të detajuar arsyetimin për secilën kërkesë të përcaktuar në Dosjen e Tenderit, në veçanti mënyrën se si është verifikuar dhe konstatuar përmbushja e kërkesave nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë.

Raporti i vlerësimit është një nga dokumentet kryesore të aktivitetit të prokurimit, pasi përmes tij duhet të pasqyrohet procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, dokumentacioni i shqyrtuar, konstatimet e Komisionit të Vlerësimit dhe arsyetimi mbi të cilin është mbështetur rekomandimi për kontratë.

Në këtë kuptim, një raport që nuk paraqet në mënyrë të qartë dhe të verifikueshme arsyetimin për përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit nuk mundëson kontroll efektiv të ligjshmërisë së procesit të vlerësimit.

Në veçanti, duke pasur parasysh natyrën teknike të këtij aktiviteti të prokurimit, raporti duhet të mundësojë identifikimin e dokumenteve dhe dëshmive mbi të cilat është

mbështetur vlerësimi për stafin profesional dhe teknik, përvojën e ngjashme, pajisjet dhe instrumentet e kërkuara, si dhe kërkesat specifike për instalimet e gazrave medicinale.

Mungesa e një arsyetimi të tillë krijon paqartësi nëse të gjitha kriteret janë kontrolluar në mënyrë të plotë dhe nëse konstatimi për përgjegjshmërinë e operatorit ekonomik të rekomanduar është mbështetur në dëshmi konkrete.

Për më tepër, mungesa e nënshkrimeve në kopjen e raportit të pranuar nuk na mundëson të verifikojmë nëse dokumenti është versioni përfundimtar i raportit, nëse është miratuar nga anëtarët përkatës të Komisionit të Vlerësimit dhe nëse përmbajtja e tij përfaqëson rezultatet përfundimtare të procesit të vlerësimit.

Për këtë arsye, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të sqarojë statusin e raportit të vlerësimit dhe të na vërë në dispozicion versionin e tij të plotë dhe përfundimtar, së bashku me dokumentacionin përkatës që dëshmon miratimin dhe dokumentimin e procesit të vlerësimit. Gjithashtu, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues ta publikojë dhe ta ngarkojë raportin e vlerësimit në platformën elektronike të prokurimit (E-Prokurimi), në përputhje me obligimet ligjore për transparencë dhe publikim të dokumentacionit të aktivitetit të prokurimit. Theksojmë se, deri në momentin e paraqitjes së kësaj kërkese për rishqyrtim, raporti i vlerësimit nuk rezulton të jetë i ngarkuar dhe i publikuar në platformën E-Prokurimi.

Baza ligjore e pretendimit

Neni 10 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik përcakton detyrimin e Autoritetit Kontraktues për mbajtjen e dokumentacionit të plotë të aktivitetit të prokurimit, duke përfshirë dokumentet që janë përdorur dhe prodhuar gjatë zhvillimit të procedurës.

Neni 59 i LPP-së përcakton detyrimin që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të realizohen në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat ligjore. Për rrjedhojë, procesi i vlerësimit duhet të jetë i dokumentuar në mënyrë të tillë që të mund të verifikohen konstatimet dhe arsyetimi mbi të cilin është mbështetur vendimmarrja e Autoritetit Kontraktues.

Po ashtu, neni 40 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik përcakton zbatimin e kritereve të publikuara paraprakisht gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave.

Në këtë drejtim, raporti i vlerësimit duhet të pasqyrojë në mënyrë të qartë dhe të arsyetuar rezultatet e ekzaminimit të ofertave, në mënyrë që të jetë e mundur të verifikohet nëse kriteret janë zbatuar në mënyrë të njëtrajtshme ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Kërkesa lidhur me këtë pretendim

Duke u bazuar në sa më sipër, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues:

1. Të na vërë në dispozicion raportin e plotë dhe përfundimtar të vlerësimit të ofertave.
2. Të sqarojë pse kopja e raportit të vënë në dispozicion nuk përmban nënshkrimet e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit.
3. Të na mundësojë verifikimin e dokumentimit dhe miratimit të raportit nga anëtarët përkatës të Komisionit të Vlerësimit.

4. Të ofrojë arsyetimin e detajuar për mënyrën se si është konstatuar përmbushja e secilës kërkesë të Dosjes së Tenderit nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë.
5. Të identifikojë dokumentet dhe dëshmitë konkrete mbi të cilat është mbështetur vlerësimi për stafin profesional dhe teknik, përvojën e ngjashme dhe pajisjet e kërkuara.
6. Të sigurojë që raporti dhe dokumentacioni mbështetës të jenë në dispozicion për verifikimin e ligjshmërisë dhe transparencës së procesit të vlerësimit.

Në përfundim, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të sigurojë transparencë të plotë lidhur me procesin e vlerësimit dhe të dëshmojë se rekomandimi për kontratë është mbështetur në një vlerësim të dokumentuar, objektiv dhe në përputhje me të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit.

IV. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

Që në fillim, theksojmë se **mosofrimi i qasjes së plotë në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë ngre dyshime serioze lidhur me transparencën e procesit të vlerësimit dhe me faktin nëse ky operator i përmbush realisht të gjitha kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit**. Pamundësia për të shqyrtuar dokumentacionin e stafit profesional dhe teknik, përvojën e dëshmuar, pajisjet dhe dëshmitë e tjera mbështetëse e bën të pamundur verifikimin e pavarur të bazës mbi të cilën është marrë vendimi për rekomandimin e tij për kontratë. Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues duhet të japë sqarime të plota dhe të sigurojë qasje efektive në dokumentacionin përkatës, në mënyrë që të eliminohen çdo dyshim dhe paqartësi lidhur me rregullsinë e këtij procesi.

Nga faktet, dokumentet dhe argumentet e paraqitura në këtë kërkesë për rishqyrtim rezulton gjithashtu se vendimi i Autoritetit Kontraktues për eliminimin e Grupit të Operatorëve Ekonomikë kërkon një rishqyrtim të plotë dhe objektiv, pasi gjatë procesit të vlerësimit janë evidentuar çështje që tregojnë se dokumentacioni i dorëzuar në ofertë nuk është shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të plotë, të drejtë dhe në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Në mënyrë të përmbledhur, kundërshtimet tona mbështeten në këto çështje kryesore:

Së pari, lidhur me dokumentacionin e z. Suad Bushi, përfshirë certifikatën e MPMS-së dhe certifikatën NEBOSH, dëshmitë përkatëse janë dorëzuar në kuadër të ofertës, por, megjithatë, janë konsideruar gabimisht si dokumentacion i munguar. Për rrjedhojë, kërkohet që këto dokumente të shqyrtohen dhe vlerësohen në përputhje me përmbajtjen e tyre dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Së dyti, lidhur me z. Avni Beqiri, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar një certifikatë shtesë për pozitën përkatëse, ndonëse një kërkesë e tillë nuk rezulton të jetë përcaktuar në Dosjen e Tenderit. Vlerësimi i ofertës duhet të bëhet mbi bazën e kritereve të publikuara paraprakisht dhe jo përmes vendosjes së kërkesave shtesë gjatë procesit të vlerësimit.

Së treti, lidhur me dokumentacionin e z. Egon Hoti, diploma, certifikata e prodhuesit Medicop, referenca për punët e realizuara dhe dëshmitë e trajnimit profesional janë dokumente që duhej të shqyrtoheshin në tërësi dhe të vlerësoheshin në raport me kërkesat konkrete të Dosjes së Tenderit. Konstatimi për mospërmbushje, pa një analizë të plotë dhe

të arsyetuar të këtyre dëshmive, nuk mund të konsiderohet vlerësim i mjaftueshëm i dokumentacionit të paraqitur.

Së katërti, lidhur me shtatë punëtorët teknikë, Autoriteti Kontraktues ka evidentuar mospërputhje në datat e kontratave të punës, pa i analizuar në tërësi dëshmitë e ATK-së dhe dokumentacionin tjetër mbështetës. Vlerësimi i këtij dokumentacioni duhet të bëhet në mënyrë të ndërlidhur, duke marrë parasysh të gjitha provat e dorëzuara dhe jo duke u mbështetur vetëm në një element të veçuar të dokumentacionit.

Së pesti, lidhur me qasjen në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, dokumentacioni i vënë në dispozicion ka qenë i kufizuar dhe nuk ka përfshirë dëshmitë kryesore për verifikimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale, përvojës, stafit dhe pajisjeve të kërkuara. Kjo ka pamundësuar verifikimin e plotë të përmbushjes së kritereve të Dosjes së Tenderit dhe ngre dyshime serioze nëse rekomandimi për kontratë është bërë mbi bazën e një dokumentacioni të plotë dhe të verifikuar.

Së gjashti, lidhur me raportin e vlerësimit, kopja e vënë në dispozicion nuk përmban nënshkrimet e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit dhe nuk ofron arsyetim të mjaftueshëm për mënyrën se si është verifikuar përmbushja e kritereve nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë. Për më tepër, deri në momentin e paraqitjes së kësaj kërkese, raporti nuk rezulton të jetë i publikuar në platformën E-Prokurimi. Këto rrethana kërkojnë sqarimin e statusit të raportit, vënien në dispozicion të versionit të plotë dhe përfundimtar, si dhe publikimin e tij në platformën përkatëse, në përputhje me obligimet ligjore.

Të gjitha këto çështje, të shqyrtuara së bashku, tregojnë nevojën për një rivlerësim të kujdesshëm të procesit të prokurimit, në mënyrë që të sigurohet se vendimi për eliminimin e Grupit tonë dhe rekomandimi për kontratë janë marrë mbi bazën e një vlerësimi të plotë, objektiv, transparent dhe të dokumentuar.

Prandaj, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

- Të shqyrtojë dhe rivlerësojë të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga Grupi ynë, duke marrë parasysh dëshmitë konkrete për secilin prej pretendimeve të paraqitura;
- Të zbatojë vetëm kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, pa vendosur kërkesa shtesë gjatë procesit të vlerësimit;
- Të sigurojë qasje të plotë dhe efektive në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, duke respektuar vetëm kufizimet e lejuara me ligj;
- Të sqarojë dhe dokumentojë plotësisht procesin e vlerësimit, përfshirë statusin dhe publikimin e raportit të vlerësimit;
- Të rishqyrtojë vendimin e kontestuar dhe, nëse konstaton se eliminimi i Grupit tonë nuk ka qenë i bazuar në vlerësim të drejtë dhe në kërkesat e Dosjes së Tenderit, të anulojë vendimin përkatës dhe ta kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim.

Grupi i Operatorëve Ekonomikë thekson se qëllimi i kësaj kërkese nuk është favorizimi i ofertës sonë, por sigurimi i një procesi të ligjshëm dhe të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, ku çdo ofertë vlerësohet vetëm mbi bazën e kritereve të publikuara dhe të dokumentacionit të dorëzuar.

VV. KËRKESA PËRFUNDIMTARE

Duke u bazuar në faktet, provat materiale dhe argumentet juridike të paraqitura në këtë kërkesë për rishqyrtim, si dhe në kundërshtimet e arsyetuara ndaj vlerësimit të Autoritetit Kontraktues, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues – SHSKUK që:

1. Të aprovojë si të bazuar këtë kërkesë për rishqyrtim.

2. Të anulojë vendimin për eliminimin e Grupit të Operatorëve Ekonomikë EGO ELSA SH.P.K. dhe Horn & Co. Kosova SH.P.K., si vendim i kontestuar për shkak të vlerësimit jo të plotë dhe jo të drejtë të dokumentacionit të ofertës sonë.

3. Të bëjë rishqyrtimin dhe rivlerësimin e ofertës sonë në mënyrë të plotë, objektive dhe të paanshme, duke u bazuar në kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

4. Të rivlerësojë dokumentacionin e dorëzuar për z. Suad Bushi dhe të marrë parasysh certifikatën e MPMS-së, certifikatën NEBOSH dhe dëshmitë e tjera përkatëse, të cilat janë pjesë përbërëse e ofertës së dorëzuar.

5. Të konstatojë se për pozitën e z. Avni Beqiri nuk mund të kërkohet certifikatë shtesë profesionale, nëse një kërkesë e tillë nuk është përcaktuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit, dhe të vlerësojë dokumentacionin e tij në përputhje me kriteret e publikuara.

6. Të rivlerësojë në tërësi dokumentacionin e z. Egon Hoti, duke përfshirë diplomën, certifikatën e prodhuesit Medicop, referencën për punët e realizuara, dëshmitë e përvojës profesionale dhe dokumentacionin e trajnimeve, në raport me kërkesat konkrete të Dosjes së Tenderit.

7. Të rishqyrtojë dokumentacionin e shtatë (7) punëtorëve teknikë, duke analizuar individualisht kontratat e punës, dëshmitë e ATK-së dhe dokumentacionin tjetër mbështetës, në mënyrë që përmbushja e kërkesave të vlerësohet mbi bazën e të gjitha provave të dorëzuara.

8. Të mundësojë qasje të plotë dhe efektive në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, përfshirë dokumentacionin e stafit profesional dhe teknik, dëshmitë e përvojës, pajisjet dhe dokumentet e tjera mbi të cilat është bazuar vlerësimi dhe rekomandimi për kontratë, duke respektuar vetëm kufizimet e lejuara me ligj për informacionin që mund të përbëjë sekret afarist.

9. Të vërë në dispozicion versionin e plotë dhe përfundimtar të raportit të vlerësimit, të sqarojë statusin dhe dokumentimin e miratimit të tij, si dhe ta publikojë dhe ngarkojë atë në platformën elektronike E-Prokurimi, në përputhje me obligimet ligjore për transparencë dhe publikim të dokumentacionit të aktivitetit të prokurimit.

10. Në rast të ekzistimit të paqartësive lidhur me dokumentacionin e dorëzuar nga Grupi ynë, të shqyrtojë mundësinë e zbatimit të dispozitave përkatëse të neneve 59 dhe 72 të LPP-së, brenda kufijve të lejuar ligjorë dhe pa lejuar ndryshimin thelbësor të ofertës.

11. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk e aprovon këtë kërkesë për rishqyrtim, të nxjerrë vendim të plotë dhe të arsyetuar, duke dhënë përgjigje konkrete dhe individuale për secilin pretendim, argument juridik dhe provë materiale të paraqitur në këtë kërkesë.

12. Si rezultat i shqyrtimit të këtyre pretendimeve dhe nëse konstatohen parregullsitë e evidentuara, të anulojë vendimin e kontestuar dhe ta kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Në rast të refuzimit të kësaj kërkese, Grupi i Operatorëve Ekonomikë rezervon të drejtën e ushtrimit të mjeteve të mëtejshme juridike pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Grupi i Operatorëve Ekonomikë mbetet i gatshëm të ofrojë çdo sqarim apo dokumentacion shtesë që mund të kërkohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të shqyrtimit të drejtë dhe të plotë të kësaj çështjeje.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përveç shkeljeve të konstatuara më parë, ne gjithashtu jemi të dëmtuar nga shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim ku përfshihen kostot për hartimin e kërkesës për rishqyrtim, mbështetjen ligjore dhe administratën e nevojshme për paraqitjen e kërkesës, si dhe përgatitjen e dokumentacionit dhe provave përkatëse.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*
e) *Kopja e listës se ATK – së (ku dëshmon se puntret e kontestuar janë pjesë e kompanisë)*

SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS

NJOFTIM PËR KONTRATË

☒ ***PUNË*** ☐ ***FURNIZIM*** ☐ ***SHËRBIME***

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 20.08.2026

Nr i Prokurimit	**220-26-7028-5-1-1**
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:
Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☒

NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: **SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**		
Adresa Postare: **Lagja e spitalit**		
Qyteti: **Prishtinë**	Kodi postar: **10 000**	Vendi: **Kosovë**
Personi kontaktues: **Ekrem Fetahu&Muhamet Behra**		Telefoni: **+038 512686**
Email: **Ekrem.fetahu@rks-gov.net&muhamet.behra@rks-gov.net**		Faksi:
Adresa e Internetit (*nëse aplikohet)*:		

Po ☐ Jo ☒
Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒
Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
Renovimi i Objektit të Hemodializës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës

II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit
(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

☒ **Punë**	☐ **Furnizime**	☐ **Shërbime**
☒ Ekzekutim ☐ Plani dhe ekzekutimi ☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	☐ Blerja ☐ Qira financiare (lizing) ☐ Qira ☐ Blerje me këste ☐ Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
Spitali e Përgjithshëm Isa Grezda Gjakovë

II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë
☐

II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë *(nëse aplikohet):*

Kontrate publike kornizë me një operator
☐

Kontrate publike kornizë me disa operator
☐

Ekzekutimi i kontratës:

Thirrje/Porosi
☐

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë
☐

Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës
Renovimi i Objektit të Hemodializës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):

45000000-7

II.1.7) Variantet pranohen

Po ☐ **Jo** ☒

II.1.8) Ndarja në Pjesë

Po ☐ **Jo** ☒

Nëse po, tenderët mund të dorëzohen për *(shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët

II.1.9) Informacione lidhur me pjesët (*nëse aplikohen)*

Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër

Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:

II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 893,939.62

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm *(përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)*
Referoju Aneks 1 ne Dosjen e Tenderit

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj **12** apo ditë (nga dhënia e kontratës)
apo
Fillimi
Përfundimi

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose **10 % e vlerës se kontratës për periudhen 13 muaj** % e vlerës së kontratës

III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata *(nëse aplikohet)*:

III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës

Po ☐ **Jo** ☒

Nëse po, përshkrimi i kushteve të veçanta

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).	**Evidenca 1. Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit SHSKUK ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të SHSKUK-së, për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet, do ti konfiskohet garancioni i sigurimit te ofertës dhe SHSKUK do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në rang-listë. Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet ;administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. (origjinali ose kopja e noterizuar) Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]. (kopje)**
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrine ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;	**Evidenca 1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);**
Kërkesa 2. Certifikata e TVSH-se	**Evidenca 2. Certifikata e TVSH-se – kopje**
Kërkesa 3. OE duhet të jetë i çertifikuar me ISO 9001 2015 OE duhet të jetë i çertifikuar me ISO 14001 2015 OE duhet të jetë i çertifikuar me ISO 45001 2018 OE duhet të jetë i çertifikuar me ISO 31000 2018 OE duhet të jetë i çertifikuar me ISO 50001 2018 OE duhet të jetë i çertifikuar me PAS 99 2012	**Evidenca 3. OE duhet të dëshmoj se është i çertifikuar me ISO 9001 2015 - valide OE duhet te jetë i çertifikuar me ISO 14001 2015 – valide OE duhet te jetë i çertifikuar me ISO 45001 2018 – valide OE duhet te jetë i çertifikuar me ISO 31000 2018 – valide OE duhet te jetë i çertifikuar me ISO 50001 2018 – valide OE duhet te jetë i çertifikuar me PAS**

	99 2012 – valide
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: **Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i OE, gjatë tre viteve të fundit (2023-2024-2025) ka qenë në vlerë se bashku në të tri vitet jo me pak se 1,350,000.00 Euro, Lideri te kete 51% te qarkullimit.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Evidenca 1. OE duhet të dëshmoj me Deklarata Tatimore vjetore te dorëzuara ne ATK per qarkullimin vjetor gjate tre viteve te fundit (2023-2024-2025) ne vleren se bashku jo me pak se 1,350,000.00 Euro.**
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: **Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte në fushën ndërtim ose renovim te objekteve spitalore (shëndetesore) min. 1,200,000.00 Euro gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare nga Njoftimi për Kontratë. Lideri te kete 51% te puneve te kryera.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Evidenca 1. OE duhet të dëshmojë listen e kontratave – original e nenshkruar dhe vulosur, të natyres se njejte ne 3 vitet e shkuara nga data e Njoftimi për kontratë te bashkangjiura me referenca , apo raporte të pranimeve , ku identifikohet qartë, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj). Të dëshmohet me kontrate dhe referencë se ka realizuar pune te ngjajshme si instalim te sistemit te klimatizimit, ventilimit, sistemit te osmozes dhe sistemit te gazrave medicinale**
Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka kapital financiar për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare- qasje e pakushtezuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 250 mijë Euro, (Ne rast te grupit te OE, min. 51% te plotësohet nga lideri I grupit).	**Evidenca 2. OE duhet të oferojë Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në llogari të destinuara për këtë projekt ose qasje te pakushtezuar në kredi për realizimin e kontratës –në vlerë prej së paku 250 mijë Euro (min. 51% te plotësohet nga lideri ne rast te grupit). Dokumenti të jetë original i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar, në emër të projektit.**
Kërkesa 3. Lista e stafit profesional të kompanisë tuaj me të dhënat në vijim Emri , mbiemri , profesioni, eksperienca (vite). a) Menaxheri i projektit Një Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë -Drejtimi Konstruktiv - minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Të jetë i certifikuar për menaxhim projekti. Te kete menaxhuar se paku dy projekte spitalore gjate 3 viteve te fundit. Te kete licensen A. b)Udhëheqës i punishtës Një Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë -Drejtimi Konstruktiv - minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Te jete i certifikuar si specialist per organizimin dhe menaxhimin e punishtes se ndertimit. Te kete licensen A. c)Një inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë – drejtimi Hidroteknikë - minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Te jete i certifikuar për mbrojtje nga zjarri nga AME. Te jete i certifikuar per menaxhim te projekteve. d)Një inxhinier i Elektroteknikes , min 5 vite pervoje pune pas diplomimit. Te jete I certifikuar si ekspert per siguri dhe shendet ne pune nga MPMS dhe per mbrojtje nga zjarri nga AME. e)Një inxh i diplomuar i Makinerisë - master, drejtimi termoenergjetike,. Te jete i	**Evidenca 3 Dëshmitë për stafin profesional. Një listë të stafit dhe personelit të kërkuar Emrin, mbiemrin, profesioni i kërkuar si dhe eksperienca duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik. Për stafin profesional të kërkuar duhet të dorëzohen këto dokumente e dëshmi Kontratat valide kopje ose Parakontrate ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt, Vendimi me shkrim për caktimin e menaxherit të projektit, Vendimi me shkrim për caktimin e udhëheqësit të punishtes, Diplomat kopje, certifikatat kopje (për inxhinierët qe është kërkuar të kenë çertifikata), CV me informatat e nevojshme sa i përket eksperiencës dhe referenca për ata persona qe janë kërkuar referencat. Sqarim Aty ku thuhet përvoja e punës, gjithmonë përvoja llogaritet për vitet pas diplomimit. Sqarim Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës (bachelor apo master) duhet diploma të jetë e nostrifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës.**

certifikuar nga ndonje prodhues per termo pompa dhe chiller, me min 2 vite pervoje pune pas certifikimit. f) Nje master i shkencave teknike , drejtimi arkitekture, min 5 vite pervoje pune pas diplomimit. g) Nje kimist industrial , min 5 vite pervoje pune. I certifikuar si ekspert per hartimin e raporteve VNM. I njejti te jete I certifikuar si ekspert per siguri dhe shendet ne punë nga MPMS. h)Nje master i hidroteknikes, i certifikuar për trajtimin e mbetjeve te rrezikshme inerte, min 2 vite përvoje pune pas certifikimit. i) Nje master i emergjencave min 5 vite pervoje pune, i certifikuar me NEBOSH Certifikata – për njohurite dhe aftesite për shendet, siguri dhe mjedis ne punë (Health, Safety and Environment – HSE) dhe si ekspert për shendet dhe siguri ne punë nga MPMS. j)Nje master i shkencave teknike min 5 vite pervoje pune i certifikuar per testim radiografik RT F niveli 2 dhe testim ultrasonik UT niveli 2 sipas standardit EN ISO 9712 2022, nga nje institucion I akredituar sipas EN ISO IEC 17024 2012. k) Një bachelor i makinerisë –Të jetë i certifikuar nga prodhuesi per instalim dhe testim te sistemit te gazrave medicinale sipas standardit ISO 7396-1, minimum 3 vite përvojë pune pas certifikimit. Te jete i certifikuar si ekspert per shendet dhe siguri ne pune nga nje kompani e licensuar nga MPMS.	
Kërkesa 4. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë Stafin Teknik (mbështetës, Ku min 15 punëtorë duhet të jenë të trajnuar për shëndet dhe siguri në punë sipas Ligjit Nr. 04 L-161. 3.1 Minimum nje (1) teknik të elektros. 3.2 Minimum nje (1) murator. 3.4 Minimum dy (2) punëtor të certifikuar për ujësjellës. 3.5 Minimum dy (2) punëtor të certifikuar për montimin e konstruksioneve të thata. 3.6 Minimum një (1) Teknik të ndërtimtarisë. 3.8 Minimum dy (2) punëtorë të certifikuar për shtrim dhe veshje pllakave. 3.7 Minimum dy (2) saldues të certifikuar me TIG sipas standardit ISO 9606-1 2017-12 me 2 vite pervoje pune pas certifikimit nga një institucion I akredituar sipas EN ISO IEC 17024 2012. 3.8 Minimum dy (2) punëtor të certifikuar nga prodhuesi per instalim dhe testim te sistemit te gazrave medicinale sipas standardit ISO 7396-1 me 3 vite pervoje pune pas certifikimit. 3.9 Minimum një (1) punëtor të certifikuar nga prodhuesi për hidroizolime. 3.10 Minimum nje (1) teknik për instalim të ngrohjes dhe klimatizimit 3.11 Minimum nje (1) punetor I certifikuar nga prodhuesi per inventar te specializuar laboratorik	**Evidenca 4 - Një listë tabelare të punëtorëve dhe personelit të kërkuar Emrin, mbiemrin, kualifikimi i kërkuar të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik. Për stafin teknik të kërkuar duhet të dorëzohen këto dokumente e dëshmi Kontratat valide kopje ose Parakontrate ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt kopje, Kopje e çertifikatave te trajnimit për siguri në punë Kopja e çertifikatave, diplomave për stafin Teknik. Sqarim 1 - Për pikën 3.8 të dorëzohet dëshmia e akreditimit sipas EN ISO IEC 17024 2012 të institucionit që ka lëshuar certifikatat.**
Kërkesa 5. Operatori ekonomik duhet te kete pajisjet dhe makinerite si ne vijim - Kamion vetshkarkues min 10 m3 – 3 cope --Eskavator	**Evidenca 5. Lista e mjeteve origjinale, e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik; - Dëshmi mbi pronësinë (apo të**

min 12 ton – 2 cope -Luge ngarkuese – 1 cope - Ngjeshese e dheut – 1 cope -Eskavator max 10t – 1 cope -Eskavator max 6t – 1 cope -Eskavator max 2t – 1 cope -Kamion me kran I certifikuar me Atest – 1 cope - Pajisjen për testim te gazit medicinal sipas standardit DIN EN ISO 7396-1 2. - Tuba per largim te mbeturinave min. 20 copë -Vinc me korpe – 1 cope -Furgon – 2 cope	**marrjes me qira) të mjeteve librezat e qarkullimit me regjistrim, ndërsa për mjetet tjera qe nuk regjistrohen të ofroj si dëshmi dudin doganorë ose faturën me transaksion bankarë mbi shitblerjen.**
Kërkesa 6. Plani dinamik për ekzekutimin e puneve 180 dite kalendarike.	**Evidenca 6 OE duhet të dorëzojë planin dinamik për ekzekutimin e punëve, me afat prej 180 ditësh kalendarike, të nënshkruar dhe të vulosur.**

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

Po ☐ **Jo** ☐

III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar

Nëse po, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse

III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve

Po ☐ **Jo** ☐

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës

☒ **E hapur**

☐ **E kufizuar**

☐ **Konkurruese me negociata**

☐ **Kuotim i Çmimit**

IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim *(procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)*

Në bazë të aplikacioneve të pranuara, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për proceduren e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave *(procedurë konkurruese me negociata)*

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme

Po ☐ **Jo** ☐

në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar

Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë
kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

Po ☐ **Jo** ☐

IV.1.4 Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë Tenderët fillestar është:

IV.1.5. Informata ne lidhje me ankandin elektronik

Do te përdoret ankandi elektronik: Po ☐ Jo ☒

Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik:

IV.2) KRITERET E DHËNIES

☒ **Çmimi më i ulët**

ose

☐ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të**

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë

Po ☐ **Jo** ☒

Nëse po,

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (*nëse aplikohen):*

i

i

Po ☐ **Jo** ☒

Dokumentet me pages

Nëse po, çmimi EUR

Kushtet dhe metoda e pagesës:

IV.3.2) Afati i fundit për pranim të *tenderëve / aplikacioneve:*

***data* 02.10.2026 *koha* 13:00:00 *vendi* Dorëzimi ofetës bëhët përmes PLATFORMA E-PROKURIMI**

IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e *tenderëve / aplikacioneve* është shkurtuar:

☐ **Po** ☒ **Jo**

Nëse po, jep arsyetim

IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit **10000 euro**

Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë **120** *apo* muaj

IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:

Deri më: data: ditët **90** apo muajt

IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:

data 02.10.2026 koha 13:00:00 vendi Zyret e prokurimit SHSKUK

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHTESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.
Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita ne punishte etj)

PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	**220-26-7028-5-1-1**	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru	**Renovimi i Objektit të Hemodializës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës**
Numri i brendshëm Internal No Interni broj	**220-26-072-5-1-1**		

Data e lëshimit Date of issue Datum izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Primljenih Tendera
02.10.2026	**02.10.2026, 13:00:00**	**02.10.2026, 13:00:00**	**Zyret e prokurimit SHSKUK**	**2**

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plotësimi Suplement/Amendment Dpuna/Izmjena
1.	**Grup i Operatorëve Ekonomik HARST Group SH.P.K.; HEXAGON CONSTRUCTION SH.P.K., Harstgroup, 23000, Suharekë**	**SHSKUK10022026**	**Renovimi i Objektit të Hemodializës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës**	**PO**	**700700.42**	**826826.50**	**JO**
2.	**Grup i Operatorëve Ekonomik EGO ELSA SH.P.K.; Horn & Co. Kosova SH.P.K., Rruga e Pejes, pn , Llapllaselle, 10000, Kosove**	**02/10/2026**	**Renovimi i Objektit të Hemodializës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës**	**PO**	**717519.28**	**846672.75**	**JO**

Komente nga përfaqësuesit e pranishem
Comments from the present authorized representatives of the CA and the EO at the opening of tenders:
Komentari prisutnih ovlaštenih predstavnika UA i EO na postupak otvaranja ponuda

Nuk ka

Përfaqësuesi i OE / EO Representative / Zastupnik EO

Nr. Br	Tenderuesi, Emri / Mbiemri Tenderer, Name / Surname Tenderer, Ime / Prezime	Nënshkrimi Signature Potpis
/	**Nuk ka**	/

Komisioni i hapjes / Opening commission / Komisija otvaranja

Emri Mbiemri **Name Surname** **Ime Prezime**	**Nënshkrimi/ Signature/ Potpis**	**Datë/ Date/ Datum**
Shkumbin Rrecaj		02.10.2026
Selami Krasniqi		02.10.2026

Nënshkrimi i Zyrtarit të Prokurimit/ Procurement Officer Signature/ Potpis službenika za javne nabavke:

Per: **Ekrem Fetahu**

* Procurement officer shall appoint a tender opening commission.

SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës : Renovimi i Objektit të Hemodializës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës

Nr i prokurimit	**220-26-7028-5-1-1**
Numri i brendshëm	**220-26-072-5-1-1**

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave[1]
1.	**Grup i Operatorëve Ekonomik HARST Group SH.P.K.; HEXAGON CONSTRUCTION SH.P.K., Harstgroup, 23000, Suharekë**	**826,826.50 €**
2.	**Grup i Operatorëve Ekonomik EGO ELSA SH.P.K.; Horn & Co. Kosova SH.P.K., Rruga e Pejes, pn , Llapllaselle, 10000, Kosove**	**846,672.75 €**

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
SHSKUK – Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës *shpërblen me kontratë:*

Grup i Operatorëve Ekonomik HARST Group SH.P.K.; HEXAGON CONSTRUCTION SH.P.K., Harstgroup, 23000, Suharekë nga në vlerë totale të ofertës – 826,826.50 €

Data: 13.11.2026

Emri dhe mbiemri i ZPP Ekrem Fetahu :

B45 – Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm

Prishtinë, 13.11.2025

SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS

Grup i Operatorëve Ekonomik HARST Group SH.P.K.; HEXAGON CONSTRUCTION SH.P.K., Harstgroup, 23000, Suharekë

Nr i prokurimit	**220-26-7028-5-1-1**
Numri i brendshëm	**220-26-072-5-1-1**

Titulli: Renovimi i Objektit të Hemodializës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës

I/e nderuar.

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lart shënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092,siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar tenderin me çmimin më të ulët si përgjigje ndaj njoftimit të kontratës për aktivitetin e prokurimit te lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimine saktësuar në tenderin dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit te intervalit, gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.
Me respekt,

_____, _____

Emri dhe mbiemri i ZPP: Ekrem Fetahu ***Nënshkrimi***

B42 - Letër standarde për *tenderuesin* e eliminuar

Prishtinë, 13.11.2026
SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS

Grup i Operatorëve Ekonomik EGO ELSA SH.P.K.; Horn & Co. Kosova SH.P.K., Rruga e Pejes, pn , Llapllaselle, 10000, Kosove

Nr i prokurimit	**220-26-7028-5-1-1**
Numri i brendshëm	**220-26-072-5-1-1**

Titulli: Renovimi i Objektit të Hemodializës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës

I/e nderuar,
Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP"
Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit .Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

ARSYETIM
Ju jeni eliminuar për këto arsye :
Në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar:
Kërkesa 3. Lista e stafit profesional të kompanisë tuaj me të dhënat në vijim Emri , mbiemri , profesioni, eksperienca (vite). a) Menaxheri i projektit Një Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë -Drejtimi Konstruktiv - minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Të jetë i certifikuar për menaxhim projekti. Te kete menaxhuar se paku dy projekte spitalore gjate 3 viteve te fundit. Te kete licensen A. b)Udhëheqës i punishtës Një Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë -Drejtimi Konstruktiv - minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Te jete i certifikuar si specialist per organizimin dhe menaxhimin e punishtes se ndertimit. Te kete licensen A. c)Një inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë – drejtimi Hidroteknikë - minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Te jete i certifikuar për mbrojtje nga zjarri nga AME. Te jete i certifikuar per menaxhim te projekteve. d)Një inxhinier i Elektroteknikes , min 5 vite pervoje pune pas diplomimit. Te jete I certifikuar si ekspert per siguri dhe shendet ne pune nga MPMS dhe per mbrojtje nga zjarri nga AME. e)Një inxh i diplomuar i Makinerisë - master, drejtimi termoenergjetike,. Te jete i certifikuar nga ndonje prodhues per termo pompa dhe chiller, me min 2 vite pervoje pune pas certifikimit. f) Nje master i shkencave teknike , drejtimi arkitekture, min 5 vite pervoje pune pas diplomimit. h) Nje master i hidroteknikes, i certifikuar për trajtimin e mbetjeve te rrezikshme inerte, min 2 vite përvoje pune pas certifikimit. i) Nje master i emergjencave min 5 vite pervoje pune,Certifikatë – për njohurite dhe aftesite për shendet, siguri dhe mjedis ne punë (Health, Safety and Environment – HSE) dhe si ekspert për shendet dhe siguri ne punë nga MPMS.j) Nje master i shkencave teknike min 5 vite pervoje pune, k) Një bachelor i makinerisë –Të jetë i certifikuar nga prodhuesi per instalim dhe testim te sistemit te gazrave medicinale sipas standardit ISO 7396-1, minimum 3 vite përvojë pune pas certifikimit. Te jete i certifikuar si ekspert per shendet dhe siguri ne pune nga nje kompani e licensuar nga MPMS.

Ndërsa ju nuk e keni ofruar Certifikatën sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes se tenderit:
i) Nje master i emergjencave min 5 vite pervoje pune,Certifikatë – për njohurite dhe aftesite për shendet, siguri dhe mjedis ne punë (Health, Safety and Environment – HSE) dhe si ekspert për shendet dhe siguri ne punë nga MPMS.j) Nje master i shkencave teknike min 5 vite pervoje pune, k) Një bachelor i makinerisë –Të jetë i certifikuar nga prodhuesi per instalim dhe testim te sistemit te gazrave medicinale sipas standardit ISO 7396-1, minimum 3 vite përvojë pune pas certifikimit. Te jete i certifikuar si ekspert per shendet dhe siguri ne pune nga nje kompani e licensuar nga MPMS.

Në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar:
Kërkesa 4. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë Stafin Teknik (mbështetës, Ku min 15 punëtorë duhet të jenë të trajnuar për shëndet dhe siguri në punë sipas Ligjit Nr. 04 L-161. 3.1 Minimum nje (1) teknik të elektros. 3.2 Minimum nje (1) murator. 3.4 Minimum dy (2) punëtor të certifikuar për ujësjellës. 3.5 Minimum dy (2) punëtor të certifikuar për montimin e konstruksioneve të thata. 3.6 Minimum një (1) Teknik të ndërtimtarisë.

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

3.8 Minimum dy (2) punëtorë të certifikuar për shtrim dhe veshje pllakave. 3.7 Minimum dy (2) saldues të certifikuar me TIG sipas standardit ISO 9606-1 2017-12 me 2 vite pervoje pune pas certifikimit nga një institucion I akredituar sipas EN ISO IEC 17024 2012. 3.8 Minimum dy (2) punëtor të certifikuar nga prodhuesi per instalim dhe testim te sistemit te gazrave medicinale sipas standardit ISO 7396-1 me 3 vite pervoje pune pas certifikimit. 3.9 Minimum një (1) punëtor të certifikuar nga prodhuesi për hidroizolime. 3.10 Minimum nje (1) teknik për instalim të ngrohjes dhe klimatizimit 3.11 Minimum nje (1) punetor I certifikuar nga prodhuesi per inventar te specializuar laboratorik

Nuk kemi ofruar kontratat sipas kërkesës së njoftimit për kontratë dhe dosës se tenderit:
Kontratat e ofruara në ofertë për punëtorët si në vijim:

Për punëtorin, Fadil Hoti në kontratën e ofruar të pika: Data e fillimit të punëve është: 12.01.2021 ndërsa e nënshkruar me date 20.02.2026 andaj kemi një mos përputhje ne mes te fillimit te punëve dhe nënshkrimit te kontratës një diferencë 5 vjeçare.

Për punëtorin, Valon Aliu në kontratën e ofruar të pika: Data e fillimit të punëve është: 01.10.2024 ndërsa e nënshkruar me date 20.02.2026 andaj kemi një mos përputhje ne mes te fillimit te punëve dhe nënshkrimit te kontratës një diferencë afër 2 vjeçare.

Për punëtorin, Avni Hoti në kontratën e ofruar të pika: Data e fillimit të punëve është: 01.01.2024 ndërsa e nënshkruar me date 20.02.2026 andaj kemi një mos përputhje ne mes te fillimit te punëve dhe nënshkrimit te kontratës një diferencë 2 vjeçare.

Për punëtorin, Fledi Hoti në kontratën e ofruar të pika: Data e fillimit të punëve është: 18.06.2022 ndërsa e nënshkruar me date 20.02.2026 andaj kemi një mos përputhje ne mes te fillimit te punëve dhe nënshkrimit te kontratës një diferencë prej afër 4 vjeçare.

Për punëtorin, Egon Hoti në kontratën e ofruar të pika: Data e fillimit të punëve është: 22.10.2020 ndërsa e nënshkruar me date 20.02.2026 andaj kemi një mos përputhje ne mes te fillimit te punëve dhe nënshkrimit te kontratës një diferencë prej afër 5 vjeçare.

Për punëtorin, Besian Murati në kontratën e ofruar të pika: Data e fillimit të punëve është: 01.01.2024 ndërsa e nënshkruar me date 01.08.2024 andaj kemi një mos përputhje ne mes te fillimit te punëve dhe nënshkrimit te kontratës një diferencë prej 7 muaj.

Për punëtorin, Ferid Shabani në kontratën e ofruar të pika: Data e fillimit të punëve është: 01.10.2024 ndërsa e nënshkruar me date 01.01.2024 andaj kemi një mos përputhje ne mes te fillimit te punëve dhe nënshkrimit te kontratës.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.
Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.
Me respekt,

_____, _____

Emri dhe mbiemri i ZPP: Ekrem Fetahu ***Nënshkrimi***

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

LISTA E PAGAVE PËR KOMPANINË

ATK-KS\drgashi

10/8/2026 12:59:09 PM

NR FISKAL	811469833
EMRI I KOMPANISË	EGO ELSA
ADRESA	Rruga e Pejes, p.n
LLOJI I BIZNESIT	SH.P.K.
QENDRA TATIMORE	PRISHTINË 3
VITI	2025

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije
Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit ATK
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 1846/2026
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: 2
Data / Datum / Date: 08.10.2026
Dërguese O.SH.T PRISHTINË

					MUAJT											
NR	EMRI	MBIEMRI	NR PERSONAL	PRIM	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	ANJEZA	BRUÇI	1172864585	PO	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2	ARTON	SEJDIU	2173908477	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
3	AULONË	HASANI	1232640258	PO	-	-	-	-	-	-	-	+	+	+	+	+
4	AVNI	KALINA	1014174806	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
5	AVNI	BEQIRI	1001772704	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
6	AVNI	SHABANI	1012468853	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
7	AZA	HOTI	1004080943	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
8	BARDHOK	JETISHI	1013250592	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
9	BESIAN	MURATI	1249900563	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
10	EGON	HOTI	1248101357	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
11	ENDRIT .	MURATI	1247539855	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
12	FADIL	HOTI	1004080897	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
13	FATON	NISHEVCI	1004304116	JO	-	-	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-
14	FERID	SHABANI	1173908527	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
15	FLEDI	HOTI	1248953639	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
16	GAZMEND	NISHEVCI	1003887916	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
17	HEKURAN	ADEMI	1242157199	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
18	ILIR	HASANI	1001437387	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
19	ILIRJANA	GASHI	1030859363	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
20	JAHIR	MORINA	1173767265	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
21	KUSHTRIM	SHABANI	1235217682	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
22	LEUTRIM	ZEQIRI	1172285283	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
23	MIMOZA	DUGOLLI	1001079553	JO	-	-	-	-	-	-	+	+	+	+	+	+
24	NDERIM	BAJRAMI	1231538166	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+

					MUAJT											
NR	EMRI	MBIEMRI	NR PERSONAL	PRIM	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
25	NEHAT	HAVOLLI	1004240312	PO	-	-	-	-	-	-	-	+	+	+	+	+
26	RREZART	POTERA	1250438849	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
27	VALDRIN	POTERA	1248080244	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
28	VALTON	ALIU	1243484819	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E FINANCAVE • MINISTARSTVO ZA FINANSIJE • MINISTRY OF FINANCE
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVES • PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA • TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
OSHT PRISHTINE

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

LISTA E PAGAVE PËR KOMPANINË

ATK-KS\drgashi

10/8/2026 12:59:31 PM

NR FISKAL	811469833
EMRI I KOMPANISË	EGO ELSA
ADRESA	Rruga e Pejes, p.n
LLOJI I BIZNESIT	SH.P.K.
QENDRA TATIMORE	PRISHTINË 3
VITI	2026

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije
Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosova
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE
Njësia Organ. / Org. jedin. / Org. Unit: ATK
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 1846/2026
Nr. Faqeve / Broj stranica / No. pages: 2
Data / Datum / Date: 08.10.2026
Dërguese: Q.SH.T. PRISHTINË

					MUAJT											
NR	EMRI	MBIEMRI	NR PERSONAL	PRIM	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	ARTON	SEJDIU	2173908477	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
2	AULONË	HASANI	1232640258	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
3	AVNI	KALINA	1014174806	PO	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-	-	-
4	AVNI	BEQIRI	1001772704	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
5	AVNI	SHABANI	1012468853	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
6	AZA	HOTI	1004080943	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
7	BARDHOK	JETISHI	1013250592	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
8	BESIAN	MURATI	1249900563	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
9	EGON	HOTI	1248101357	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
10	ENDRIT	MURATI	1247539855	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
11	FADIL	HOTI	1004080897	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
12	FATON	NISHEVCI	1004304116	JO	-	-	+	+	+	+	-	-	-	-	-	-
13	FERID	SHABANI	1173908527	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
14	FLEDI	HOTI	1248953639	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
15	GAZMEND	NISHEVCI	1003887916	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
16	HEKURAN	ADEMI	1242157199	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
17	ILIR	HASANI	1001437387	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
18	ILIRJANA	GASHI	1030859363	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
19	JAHIR	MORINA	1173767265	JO	-	-	-	-	-	-	+	+	-	-	-	-
20	JAHIR	MORINA	1173767265	PO	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-	-	-
21	KUSHTRIM	SHABANI	1235217682	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
22	LEUTRIM	ZEQIRI	1172285283	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
23	NEHAT	HAVOLLI	1004240312	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
24	RREZART	POTERA	1250438849	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-

					MUAJT											
NR	EMRI	MBIEMRI	NR PERSONAL	PRIM	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
25	VALDRIN	POTERA	1248080244	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
26	VALTON	ALIU	1243484819	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-

Republika e Kosovës

RepublikaKosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës-(SHSKUK)
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-(UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo-(HUCSK)

NGA/OD/FROM:		Ekrem Fetahu -Shefi i Prokurimit të SHSKUK-së			
TEMA/ SUBJEKAT /SUBJECT:		Vendim për Refuzimin e kërkesës për Rishqyrtim			
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	28	Lokacioni: Kucni: Extension:	Prokurimi	Data: Datum: Date:	**19.11.2026**

Bazuar ne Nenin 108A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe te kërkesë për Rishqyrtim nga një OE, Autoritetit Kontraktues-SHSKUK, e mori ketë:

VENDIM

Refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar

Arsyetim

Lidhur me tenderin: **Renovimi i Objektit të Hemodializës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës nr.i prokurimit: 220-26-7028-5-1-1 nr. i brendshëm: 220-26-072-5-1-1** me datë: **18.11.2026** në AK-SHSKUK, është pranuar një kërkesë për rishqyrtim, me arsyetimin se:

Pretendimet e OE ankues

Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

- Njoftimi për kontratë – 20.08.2026
- Hapja e tenderit – 02.10.2026
- Njoftimi mbi vendimin e AK – 13.11.2026
- Kërkesa për Rishqyrtim – 18.11.2026

BAZA LIGJORE E SHKELUR

Në mbështetje të fakteve, dokumentacionit të ofertës dhe veprimeve të ndërmarra nga Autoriteti Kontraktues gjatë procedurës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, grupi i operatorëve ekonomikë pretendon se vendimi për eliminimin e ofertës sonë dhe rekomandimin e një operatori tjetër ekonomik për kontratë cenon dispozitat e mëposhtme ligjore si ne vijim:

A. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik

Neni 1 – Qëllimi

Përcakton qëllimin e LPP-së për të siguruar përdorimin efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike, duke garantuar integritetin dhe përgjegjshmërinë në procesin eprokurimit publik.

Neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti

Obligon autoritetet kontraktuese që fondet publike t'i përdorin në mënyrë sa më ekonomike dhe efikase, duke siguruar vlerën më të mirë për paranë publike dhe duke mos lejuar veprime që cenojnë konkurrencën dhe rezultatet e procedurës.

Neni 7 – Barazia në trajtimin e operatorëve ekonomikë

Kërkon që të gjithë operatorët ekonomikë të trajtohen në mënyrë të barabartë, të drejtë dhe jodiskriminuese. Autoriteti Kontraktues duhet të zbatojë të njëjtat standarde dhe kritere për të gjithë ofertuesit, pa favorizuar apo diskriminuar asnjërin prej tyre.

Neni 10 – Mjetet për promovimin e transparencës

Përcakton detyrimin për transparencë në procesin e prokurimit publik, përfshirë publikimin dhe ofrimin e informatave përkatëse, në mënyrë që procesi të jetë i hapur, i kontrollueshëm dhe i verifikueshëm.

Neni 11 – Informatat sekrete afariste

Rregullon mbrojtjen e informatave që përbëjnë sekrete afariste, duke përcaktuar kufijtë e ruajtjes së konfidencialitetit. Kjo dispozitë nuk duhet të përdoret si arsyetim i përgjithshëm për të mohuar qasjen në dokumentacionin që nuk i plotëson kushtet ligjore

për t'u konsideruar sekret afarist.

Neni 27 – Dosja e tenderit

Përcakton rëndësinë dhe përmbajtjen e dosjes së tenderit, e cila duhet t'i përmbajë kërkesat, kriteret, kushtet dhe specifikimet përkatëse të aktivitetit të prokurimit. Autoriteti Kontraktues është i detyruar të veprojë në përputhje me kërkesat që vetë i ka përcaktuar në dosjen e tenderit.

Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Përcakton detyrimin e Autoritetit Kontraktues që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat ligjore. Vlerësimi duhet të jetë objektiv, profesional dhe i mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë.

Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Rregullon mundësinë e kërkimit të dokumentacionit ose informacionit shtesë nga operatorët ekonomikë, kur kjo është e nevojshme për sqarimin dhe verifikimin e ofertave, në përputhje me kufizimet ligjore. Kjo dispozitë nuk lejon ndryshimin e ofertës apo plotësimin e mangësive thelbësore në kundërshtim me ligjin.

B. Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 7 – Informatat sekrete afariste dhe qasja në dokumentacion

Përcakton se pas publikimit të njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, palët e interesuara kanë të drejtë të kenë qasje në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit.

Vetëm informatat që janë klasifikuar dhe pranuar ligjërisht si sekrete afariste mund të mbeten konfidenciale. Autoriteti Kontraktues duhet të mundësojë qasje të shpejtë dhe të

arsyeshme në dokumentacionin tjetër të procedurës.

Neni 40 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Përcakton se vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve duhet të bëhet në përputhje me parimet themelore të LPP-së dhe kriteret e përcaktuara paraprakisht në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk mund të ndryshojë, modifikojë, heqë apo shtojë kritere dhe kërkesa gjatë procesit të vlerësimit. Të gjithë operatorët ekonomikë duhet të vlerësohen sipas standardeve të njëjta.

Neni 97, paragrafi 1, nënparagrafi c) – Shkeljet e rënda

E klasifikon si shkelje të rëndë moslejimin ose neglizhimin e qasjes në dokumentet zyrtare, sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesuar, kur kërkesa për qasje është në përputhje me nenet 10 dhe 11 të LPP-së. Kjo dispozitë është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur Autoriteti Kontraktues refuzon ose kufizon pa bazë ligjore qasjen në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit.

C. Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike

Përveç dispozitave të LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022, për qasjen në dokumentacion zbatohen edhe dispozitat përkatëse të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Bazuar në nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP)

Lënda: Kërkesë për rishqyrtim ndaj Njoftimit mbi vendimin e AK-së të publikuar me datë 13.11.2026.

II. HYRJE DHE PËRMBLEDHJE E FAKTEVE DHE ARGUMENTEVE

Grupi i Operatorëve Ekonomikë EGO ELSA SH.P.K. dhe Horn & Co. Kosova SH.P.K., në cilësinë e pjesëmarrësit në aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi i Objektit të Hemodializës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës", me numër të prokurimit 220-26-7028-5-1-1, paraqet këtë kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, përmes të cilit oferta e këtij grupi të operatorëve ekonomikë është eliminuar si e papërgjegjshme, ndërsa për kontratë është rekomanduar një operator tjetër ekonomik.

Pas shqyrtimit të arsyetimit të paraqitur nga Autoriteti Kontraktues në Formularin B42, si dhe pas analizimit të dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë, konsiderojmë se vendimi për eliminimin e ofertës sonë është marrë mbi një vlerësim jo të plotë, jo objektiv dhe jo të drejtë të dokumentacionit të dorëzuar, si dhe mbi një interpretim të kërkesave që nuk përputhet me përmbajtjen dhe qëllimin e Dosjes së Tenderit.

Konsiderojmë se gjatë procesit të ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertës sonë, Autoriteti Kontraktues nuk i ka trajtuar në mënyrë të gjithanshme dëshmitë dhe dokumentet e paraqitura, duke mos i vlerësuar ato në ndërlidhje me njëra-tjetrën dhe me kërkesat konkrete të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Një qasje e tillë ka rezultuar në konstatime të cilat, sipas vlerësimit tonë, nuk mbështeten në gjendjen reale të dokumentacionit të ofertës.

Në mënyrë të veçantë, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar mungesë të certifikatave për disa pozita të stafit profesional, ndonëse dokumentet përkatëse janë dorëzuar në ofertë. Gjithashtu, nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dëshmitë e paraqitura për një pjesëtar të stafit teknik, ndërsa janë konstatuar mospërputhje në datat e kontratave të punës së disa punëtorëve, pa u marrë parasysh tërësia e dokumentacionit mbështetës dhe provat e tjera të paraqitura për të dëshmuar përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Sipas vlerësimit tonë, këto konstatime kërkojnë një shqyrtim të ri dhe të individualizuar për secilën pozitë dhe secilin pjesëtar të stafit, duke marrë parasysh dokumentet konkrete të dorëzuara, përmbajtjen e tyre, vlefshmërinë dhe lidhjen e tyre me kërkesat e Autoritetit Kontraktues. Eliminimi i një oferte duhet të mbështetet

në fakte të verifikuara dhe në zbatim të drejtë të kritereve të përcaktuara paraprakisht, e jo në vlerësime të pjesshme ose interpretime që nuk reflektojnë përmbajtjen e plotë të ofertës.

Për më tepër, gjatë përpjekjeve për të siguruar qasje në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, Grupit tonë nuk i është mundësuar qasje e plotë dhe efektive në dokumentet dhe dëshmitë mbi të cilat është bazuar ekzaminimi dhe vlerësimi i ofertës së tij. Kjo e ka vështirësuar mundësinë tonë për të verifikuar nëse operatori i rekomanduar i përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe nëse kriteret janë zbatuar në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Theksojmë se kërkesa jonë për qasje në dokumentacion nuk synon cenimin e informatave që përbëjnë sekrete afariste dhe që mbrohen shprehimisht me ligj, por sigurimin e transparencës së nevojshme për të verifikuar ligjshmërinë e procedurës dhe trajtimin e barabartë të ofertuesve. Çdo kufizim i qasjes duhet të jetë i bazuar në dispozita ligjore, i arsyetuar dhe i kufizuar vetëm në informacionet që realisht gëzojnë mbrojtje ligjore.

Në këtë kontekst, konsiderojmë se çështja duhet të shqyrtohet jo vetëm nga këndvështrimi i arsyeve të eliminimit të ofertës sonë, por edhe nga këndvështrimi i zbatimit të njëtrajtshëm të kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë. Respektimi i parimit të barazisë në trajtim nënkupton që të njëjtat kërkesa dhe standarde të aplikohen në mënyrë të njëjtë, pa krijuar dallime të pajustifikuara ndërmjet ofertuesve.

Për këto arsye, përmes kësaj kërkese paraqesim pretendimet tona lidhur me mënyrën e ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertës, duke i mbështetur ato në dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik, Rregullores për Prokurimin Publik, kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe provat materiale të dorëzuara si pjesë e ofertës.

Me këtë kërkesë kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të rishqyrtojë në mënyrë të plotë dhe objektive konstatimet e paraqitura në Formularin B42, të rivlerësojë dokumentacionin e ofertës sonë, të shqyrtojë ligjshmërinë e vlerësimit të operatorit të rekomanduar për kontratë dhe të sigurojë qasje në dokumentacionin përkatës, në përputhje me dispozitat ligjore. Si rezultat i këtij rishqyrtimi, kërkojmë anulimin e vendimit të kontestuar dhe kthimin e procedurës në fazën përkatëse të rivlerësimit, me zbatimin e drejtë dhe të barabartë të kritereve për të gjithë operatorët ekonomikë.

III. PRETENDIMET ANKIMORE

Duke u bazuar në faktet dhe argumentet e paraqitura ne kete kerkesë, konsiderojmë se vendimi i dhëna nga Autoriteti Kontraktues cenonë rendë parimet dhe dispozitat e LPP-së dhe të akteve nënligjore përkatëse, për këto arsye:

PRETENDIMI 1

Vlerësimi i pasaktë i dokumentacionit për pozitën e Masterit të Emergjencave – Suad Bushi

Në arsyetimin e vendimit për eliminim, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se për pozitën përkatëse të stafit profesional, të cilën e mbulon z. Suad Bushi, nuk janë dorëzuar certifikatat e kërkuara në fushën e HSE-së dhe të sigurisë dhe shëndetit në punë nga MPMS.

Ky konstatim nuk qëndron, pasi dokumentacioni përkatës është dorëzuar në kuadër të ofertës së Grupit të Operatorëve Ekonomikë.

Në mbështetje të përmbushjes së kërkesave për këtë pozitë, në ofertë janë dorëzuar këto dokumente:

Diploma e nivelit Master në Menaxhim të Emergjencave, nr. 126/16, e datës 22.11.2016;

Certifikata e MPMS-së për Ekspert të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, nr. 0318280323, me vlefshmëri deri më 31.03.2028;

Certifikata NEBOSH International General Certificate, nr. 00254610/1285582, e datës 06.05.2022;

CV-ja e kandidatit;

Marrëveshja e angazhimit e datës 26.08.2026;

Lista e stafit

Nga dokumentacioni i lartcekur rezulton se kandidati posedon diplomën përkatëse të nivelit Master, certifikimin profesional në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë nga MPMS, si dhe certifikimin ndërkombëtar NEBOSH.

Në veçanti, certifikata e MPMS-së me numër 0318280323 është e vlefshme deri më 31.03.2028.

Për këtë arsye, konstatimi i Autoritetit Kontraktues se dokumentacioni përkatës mungon është në kundërshtim me dokumentet e dorëzuara në ofertë.

Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar që të shqyrtojë tërësinë e dokumentacionit të paraqitur dhe të vlerësojë përmbushjen e kriterit mbi bazën e provave konkrete, e jo të konstatojë mungesën e dokumenteve që gjenden në ofertën e operatorit ekonomik.

Në rast se gjatë vlerësimit ka ekzistuar ndonjë paqartësi lidhur me dokumentet e dorëzuara, Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësi të kërkojë sqarime në përputhje me nenin 59 dhe nenin 72 të LPP-së, duke respektuar kufizimet ligjore dhe pa lejuar ndryshimin thelbësor të ofertës.

Kërkesa lidhur me këtë pretendim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të rishqyrtojë dokumentacionin e z. Suad Bushi, veçanërisht certifikatën e MPMS-së nr. 0318280323 dhe certifikatën NEBOSH nr. 00254610/1285582, dhe të konstatojë se kërkesa përkatëse është përmbushur.

PRETENDIMI 2

Kërkimi i një certifikate shtesë për pozitën e Masterit të Shkencave Teknike – Avni Beqiri, ndonëse një kërkesë e tillë nuk është përcaktuar në Dosjen e Tenderit

Në arsyetimin e paraqitur në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (Formulari B42), si arsye për eliminimin e Grupit të Operatorëve Ekonomikë është evidentuar mungesa e certifikatës për pozitën e Masterit të Shkencave Teknike, të cilën e mbulon z. Avni Beqiri.

Një konstatim i tillë konsiderojmë se është i pabazuar në kërkesat konkrete të Dosjes së Tenderit, pasi Autoriteti Kontraktues ka kërkuar një kualifikim akademik të nivelit Master në Shkencat Teknike dhe përvojë profesionale prej së paku pesë (5) vitesh, por nuk ka përcaktuar në mënyrë të shprehur ndonjë certifikatë shtesë profesionale si kusht për përmbushjen e kësaj pozite.

Konkretisht, në Dosjen e Tenderit, te kërkesat për mundësitë teknike dhe/ose profesionale, është përcaktuar:

Kërkesa në Dosjen e Tenderit:

"j) Një Master i Shkencave Teknike, min. 5 vite përvojë pune."

Ndërsa, te dëshmitë e kërkuara është përcaktuar:

"Diplomat kopje, certifikatat kopje (për inxhinierët që është kërkuar të kenë certifikata)."

Nga formulimi i mësipërm rezulton qartë se Dosja e Tenderit nuk kërkon certifikatë profesionale për secilën pozitë të stafit pa dallim, por vetëm për inxhinierët dhe pozitat për të cilat një certifikatë e tillë është kërkuar shprehimisht. Rrjedhimisht, kërkesa për certifikatë nuk mund të interpretohet në mënyrë të zgjeruar dhe të zbatohet edhe për pozitën e Masterit të Shkencave Teknike, kur një kusht i tillë nuk është përcaktuar në kërkesën konkrete për këtë pozitë.

Në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, në ofertën e dorëzuar nga Grupi ynë janë përfshirë dokumentet në vijim:

Diploma Master i Shkencave Teknike, nr. 282, e datës 15.03.2017, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, përkatësisht Fakulteti i Gjeoshkencave dhe Teknologjisë;

Dokumentacioni përkatës që dëshmon përvojën profesionale të kandidatit;

CV-ja e kandidatit;

Dokumentet e tjera mbështetëse të dorëzuara në ofertë.

Pra, diploma e dorëzuar dëshmon përmbushjen e kërkesës për kualifikimin akademik, ndërsa dokumentacioni mbështetës dëshmon përvojën profesionale të kandidatit, e cila përmbush dhe tejkalon kërkesën minimale prej pesë (5) vitesh të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Paqartësia dhe kundërthënia në arsyetimin e Autoritetit Kontraktues

Për më tepër, në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, mungesa e certifikatës është arsyetuar me pretendimin se një dokument i tillë kërkohet sipas njoftimit për kontratë dhe Dosjes së Tenderit. Megjithatë, në rastin konkret, një kërkesë e tillë nuk figuron në përshkrimin e pozitës së Masterit të Shkencave Teknike.

Kjo paraqet një mospërputhje ndërmjet kërkesës reale të përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe mënyrës se si Autoriteti Kontraktues e ka interpretuar dhe zbatuar atë gjatë vlerësimit të ofertës sonë.

Duhet theksuar se Grupi ynë i Operatorëve Ekonomikë i ka përmbushur kërkesat për certifikata në të gjitha pozitat ku Dosja e Tenderit i ka kërkuar ato shprehimisht. Për rrjedhojë, nuk mund të kërkohet një dokument shtesë për një pozitë për të cilën Autoriteti Kontraktues nuk e ka përcaktuar një kusht të tillë paraprakisht.

Baza ligjore e pretendimit

Sipas nenit 27 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, Dosja e Tenderit përcakton kërkesat dhe kushtet që duhet të përmbushen nga operatorët ekonomikë. Autoriteti Kontraktues është i obliguar që gjatë vlerësimit të ofertave të veprojë në përputhje me kërkesat e publikuara dhe nuk mund të vendosë kushte shtesë që nuk janë paraparë paraprakisht.

Po ashtu, neni 40, paragrafët 1 dhe 2, të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik përcakton detyrimin për zbatimin e kritereve të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në Dosjen e Tenderit gjatë procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Ndërkaq, neni 7 i Ligjit për Prokurimin Publik garanton trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, duke kërkuar që të gjithë ofertuesit të vlerësohen sipas të njëjtave kritere dhe standardeve të përcaktuara paraprakisht.

Në këtë drejtim, kërkimi i një certifikate që nuk është përcaktuar si kusht për pozitën konkrete përbën interpretim të zgjeruar dhe zbatim të gabuar të kërkesave të Dosjes së Tenderit, duke cenuar parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Kërkesa lidhur me këtë pretendim

Duke u bazuar në faktet dhe argumentet e paraqitura më lart, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që:

Të rishqyrtojë konstatimin për mungesën e certifikatës në pozitën e Masterit të Shkencave Teknike – Avni Beqiri;

Të konstatojë se për këtë pozitë Dosja e Tenderit ka kërkuar diplomën përkatëse të nivelit Master dhe përvojën profesionale prej së paku pesë (5) vitesh, pa përcaktuar ndonjë certifikatë shtesë profesionale;

Të marrë në konsideratë diplomën, CV-në dhe dokumentacionin e përvojës profesionale të dorëzuar në ofertë, si dëshmi të përmbushjes së kërkesave të përcaktuara;

Të tërheqë këtë konstatim si arsye për eliminimin e ofertës sonë dhe të vazhdojë me rivlerësimin e drejtë dhe të plotë të dokumentacionit të dorëzuar.

PRETENDIMI 3

Mosvlerësimi i drejtë i dokumentacionit për pozitën e Bachelorit të Makinerisë – Egon Hoti

Në kuadër të arsyetimit të eliminimit, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se dokumentacioni për pozitën e Bachelorit të Makinerisë nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Ky vlerësim nuk pasqyron tërësinë e dokumentacionit të dorëzuar në ofertë, pasi për kandidatin z. Egon Hoti janë paraqitur dëshmi konkrete për kualifikimin akademik, certifikimin nga prodhuesi, përvojën profesionale dhe përgatitjen në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Në ofertë janë dorëzuar dokumentet si në vijim:

Diploma Bachelor në Inxhinieri të Makinerisë, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, nr. 1304, e datës 21.12.2021;

Certifikata e trajnimit nga prodhuesi Medicop për instalimin, servisimin dhe testimin përfundimtar të sistemeve të gazrave medicinale sipas standardit ISO 7396-1, e datës 16.06.2022, me vlefshmëri deri më 16.06.2027;

CV-ja e kandidatit;

Kontrata e punës dhe dokumentacioni tjetër që dëshmon përvojën profesionale;

Referenca e datës 13.06.2025, e cila dëshmon përfshirjen e kandidatit në më shumë se 25 kontrata të realizuara në fushën e gazrave medicinale në QKUK/SHSKUK;

Certifikata e trajnimit përgatitor 150-orësh për Ekspert të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, nr. SSHP1004-02/25, e datës 05.06.2025, e lëshuar nga European College of Kosovo;

Licenca e ofruesit të trajnimit, nr. 05/2018, e datës 18.07.2018.

Nga këto dokumente rezulton se kandidati posedon diplomën përkatëse universitare, certifikimin e prodhuesit për instalimin dhe testimin e sistemeve të gazrave medicinale sipas ISO 7396-1, si dhe përvojën profesionale të dokumentuar në këtë fushë.

Në veçanti, referenca e datës 13.06.2025 dëshmon angazhimin e kandidatit në më shumë se 25 kontrata që lidhen me gazrat medicinale në institucionet shëndetësore përkatëse. Kjo dëshmi duhet të vlerësohet së bashku me kontratën e punës, CV-në dhe dokumentacionin tjetër të paraqitur.

Gjithashtu, certifikata e trajnimit përgatitor 150-orësh për Ekspert të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, së bashku me licencën e ofruesit të trajnimit, është pjesë e dokumentacionit të dorëzuar dhe duhet të shqyrtohet në raport me kërkesën përkatëse të Dosjes së Tenderit.

Nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur ndonjë paqartësi lidhur me natyrën e certifikatës së prodhuesit, përvojën e kandidatit apo dokumentacionin e trajnimit në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, ka qenë e mundur të kërkohen sqarime në përputhje me nenet 59 dhe 72 të LPP-së, pa ndryshuar përmbajtjen thelbësore të ofertës.

Nuk është e drejtë që dokumentet e dorëzuara të mos vlerësohen në tërësi ose të konsiderohen të pamjaftueshme pa u dhënë arsyetim konkret se cilën kërkesë të përcaktuar në Dosjen e Tenderit nuk e përmbush secila dëshmi.

Kërkesa lidhur me këtë pretendim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të rivlerësojë në mënyrë të plotë dokumentacionin e z. Egon Hoti, duke marrë parasysh diplomën, certifikatën e prodhuesit Medicop, referencën për më shumë se 25 kontrata, dokumentacionin e përvojës profesionale dhe certifikatën e trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe të konstatojë përmbushjen e kritereve përkatëse të Dosjes së Tenderit.

PRETENDIMI 4

Vlerësimi i pasaktë i datave të kontratave dhe mosmarrja parasysh e dëshmive të marrëdhënies së punës për shtatë (7) pjesëtarët e stafit teknik

Në arsyetimin e eliminimit, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar mospërputhje në datat e kontratave të punës për shtatë (7) pjesëtarë të stafit teknik, duke vënë në dyshim përmbushjen e kërkesave lidhur me angazhimin dhe marrëdhënien e tyre të punës.

Megjithatë, ky konstatim është bërë pa u shqyrtuar në tërësi dokumentacioni i dorëzuar në ofertë dhe pa u marrë parasysh dëshmitë shtesë që pasqyrojnë marrëdhëniet e punës dhe deklarimet përkatëse në Administratën Tatimore të Kosovës.

Punëtorët për të cilët është konstatuar mospërputhje janë:

Fadil Hoti;

Valton Aliu (i evidentuar në Njoftimin mbi vendimin e AK-së si Valon Aliu);

Avni Hoti (i evidentuar në dokumentacionin e ATK-së si Avni Kalina, lidhur me kete ka ndryshim mbiemri per qka ju kemi njoftuar edhe ne dorezimin fillestar te dosjes se tenderit);

Fledi Hoti;

Egon Hoti;

Besian Murati;

Ferid Shabani.

Për këta punëtorë janë dorëzuar dëshmi të ndryshme që duhet të vlerësohen së bashku me kontratat e punës dhe dokumentacionin tjetër të stafit.

Në veçanti, në dokumentacionin e dorëzuar janë përfshirë dëshmitë e ATK-së si në vijim:

Për Fadil Hotin – dëshmia e ATK-së, nr. 11;

Për Valton Aliun – dëshmia e ATK-së, nr. 26;

Për Avni Hotin/Avni Kalinën – dëshmia e ATK-së, nr. 3;

Për Fledi Hotin – dëshmia e ATK-së, nr. 14;

Për Egon Hotin – dëshmia e ATK-së, nr. 9;

Për Besian Muratin – dëshmia e ATK-së, nr. 8;

Për Ferid Shabanin – dëshmia e ATK-së, nr. 13.

Provë: Lista e ATK-së

Këto dëshmi duhet të analizohen në raport me kontratat e punës, listat e stafit dhe dokumentet e tjera të dorëzuara, me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike për secilin punëtor veç e veç.

Sa i përket Valton Aliut, ne vendimin e AK emri figuron si Valon Aliu mendoj se ju keni referuar gabim emrit.

Po ashtu, lidhur me Avni Hotin, i cili në dokumentacionin e ATK-së figuron me mbiemrin Kalina, kërkohet që të merret parasysh dokumentacioni që dëshmon se bëhet fjalë për të njëjtin person dhe se dallimi në mbiemër lidhet me ndryshimin e mbiemrit.

Vlerësimi i Autoritetit Kontraktues nuk duhet të kufizohet vetëm në krahasimin formal të datave të paraqitura në dokumente të veçanta, por duhet të marrë parasysh të gjitha dëshmitë relevante që mundësojnë verifikimin e gjendjes faktike.

Gjithashtu, duhet të bëhet dallimi ndërmjet datës së lidhjes së një kontrate të caktuar dhe ekzistimit të marrëdhënies së punës, pasi këto nuk janë domosdoshmërisht e njëjta gjë. Dokumentet e ATK-së dhe provat e tjera mund të ndihmojnë në verifikimin e vazhdimësisë së angazhimit, por duhet të shqyrtohen në raport me kontratat dhe dokumentet përkatëse.

Në këtë kuptim, kërkohet që Autoriteti Kontraktues të bëjë vlerësim individual për secilin nga shtatë punëtorët dhe të identifikojë saktësisht se cila kërkesë nuk është përmbushur dhe mbi cilën provë është mbështetur ky konstatim.

Nëse ka pasur paqartësi lidhur me dokumentacionin, Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësi të kërkojë sqarime në përputhje me nenin 59 dhe nenin 72 të LPP-së, brenda kufijve të lejuar ligjorë.

Kërkesa lidhur me këtë pretendim:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të rishqyrtojë të gjithë dokumentacionin e shtatë punëtorëve të lartcekur, përfshirë kontratat e punës, dëshmitë e ATK-së dhe dokumentet e tjera mbështetëse, dhe të bëjë vlerësim individual të secilit rast, duke mos u mbështetur vetëm në mospërputhje formale të datave pa shqyrtuar tërësinë e provave.

PRETENDIMI 5

Mosofrimi i qasjes së plotë dhe efektive në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë – ekzistenca e mospajtimit brenda Komisionit të Vlerësimit lidhur me përmbushjen e kritereve të kapacitetit teknik dhe profesional, cenimi i transparencës dhe pamundësimi i verifikimit të ligjshmërisë së rekomandimit për kontratë

Pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Grupi i Operatorëve Ekonomikë ka kërkuar qasje në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, me qëllim të verifikimit të përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe të ligjshmërisë së procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave.

Më datë 16.11.2026, Grupi ynë ka paraqitur kërkesë për qasje në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit. Me këtë rast, nga ana e Menaxherit të Prokurimit është bërë e ditur se dokumentacioni është voluminoz dhe se nevojitet kohë për përgatitjen e tij në USB, për çka qasja është shtyrë për datën 17.11.2026.

Megjithatë, edhe më datë 17.11.2026, dokumentacioni i vënë në dispozicion ka qenë i kufizuar dhe nuk ka përfshirë dokumentet thelbësore mbi të cilat është bazuar vlerësimi i ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Dokumentacioni i ofruar ka përfshirë kryesisht:

1. Profilin e kompanisë;

2. Aneksin 1 – Specifikimet teknike;

3. Përshkrimin e çmimeve;

4. Paramasën;

5. Formularin e tenderit;

6. Raportin e vlerësimit.

Ndërsa nuk është mundësuar qasja në dokumentacionin thelbësor që dëshmon përmbushjen e kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional, konkretisht:

☐ Dokumentacionin e stafit profesional dhe teknik, përfshirë diplomat, licencat, certifikatat, CV-të dhe dëshmitë e përvojës profesionale;

☐ Kontratat, referencat dhe dëshmitë për realizimin e punëve të ngjashme;

☐ Dokumentet që dëshmojnë posedimin, disponueshmërinë ose sigurimin e pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për realizimin dhe testimin e instalimeve;

☐ Dëshmitë teknike dhe profesionale lidhur me përmbushjen e kërkesave për instalimin dhe testimin e sistemeve të gazrave medicinale;

☐ Dokumentet e tjera mbështetëse që janë përdorur për të konstatuar përmbushjen e kritereve të Dosjes së Tenderit.

RËNDËSIA E DOKUMENTACIONIT TË MUNGUAR DHE EKZISTENCA E DYSHIMEVE KONKRETE LIDHUR ME PËRMBUSHJEN E KRITEREVE

Mungesa e qasjes në këto dokumente është veçanërisht problematike duke marrë parasysh natyrën dhe kompleksitetin e aktivitetit të prokurimit, i cili përfshin punë në fushën e HVAC-së, ventilimit, osmozës dhe instalimeve të gazrave medicinale, për të cilat Dosja e Tenderit përcakton kërkesa specifike teknike dhe profesionale.

Në këtë drejtim, nuk mjafton vetëm të konstatohet se operatori ekonomik i rekomanduar ka dorëzuar ofertën dhe dokumentet e përgjithshme të tenderit. Është e domosdoshme të verifikohet nëse ai i ka përmbushur realisht të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, përmes dokumenteve dhe dëshmive konkrete që duhet të jenë pjesë e ofertës së tij.

Në veçanti, duhet të mundësohet verifikimi i dokumentacionit që dëshmon përmbushjen e kërkesave për instalimin dhe testimin e sistemeve të gazrave medicinale sipas standardit DIN EN ISO 7396-1, përfshirë dëshmitë për disponueshmërinë, përshtatshmërinë dhe aftësinë e pajisjeve dhe instrumenteve të kërkuara për testimin dhe verifikimin e këtyre instalimeve.

Një element veçanërisht i rëndësishëm, i cili e fuqizon këtë pretendim, rezulton drejtpërdrejt nga vetë Raporti i Vlerësimit të Tenderit, në faqen 10 të tij, ku është evidentuar mendimi i ndarë i anëtarit të Komisionit të Vlerësimit, z. Pajtim Mustafa.

Në këtë faqe, z. Pajtim Mustafa, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të ofertave, ka shprehur mospajtimin e tij me rekomandimin për shpërblimin me kontratë të Grupit të Operatorëve Ekonomikë të përbërë nga HARS Group SH.P.K. dhe HEXAGON CONSTRUCTION SH.P.K., duke konstatuar se, sipas vlerësimit të tij, ky grup nuk i plotëson kriteret për t'u shpallur fitues.

Në arsyetimin e tij, ndër të tjera, ai ka theksuar dy çështje thelbësore:

1. Mungesën e dëshmive për realizimin e punëve të ngjashme në fushën e osmozës, duke vënë në pah se nuk është dëshmuar përmes kontratave apo referencave se operatori ekonomik ka realizuar punë të ngjashme për sistemin e osmozës, ashtu siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

2. Mungesën e dëshmisë për pajisjen e nevojshme për sistemin e gazrave medicinale, duke theksuar se nuk është paraqitur dëshmi për pajisjen për sistemin e gazrave medicinalë sipas standardit DIN EN ISO 7396-1.

Në përfundim të arsyetimit të tij, anëtari i Komisionit ka shprehur qëndrimin se operatori ekonomik në fjalë është i papërgjegjshëm.

Ky konstatim ka rëndësi të veçantë juridike dhe faktike, pasi nuk bëhet fjalë për një dyshim të ngritur vetëm nga Grupi ynë i Operatorëve Ekonomikë, por për vërejtje konkrete të evidentuara nga vetë njëri prej anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit, i cili ka pasur qasje në dokumentacionin e ofertës dhe ka marrë pjesë në procesin e ekzaminimit dhe vlerësimit të saj.

Për rrjedhojë, ekziston një mospajtim i dokumentuar brenda vetë Komisionit të Vlerësimit lidhur me një çështje thelbësore të këtij aktiviteti të prokurimit: nëse operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka përmbushur apo jo kërkesat e Dosjes së Tenderit për kapacitetin teknik dhe profesional.

Në këtë kontekst, vërejtjet e anëtarit të Komisionit nuk mund të trajtohen si çështje dytësore apo thjesht formale, pasi ato lidhen drejtpërdrejt me dy kërkesa të rëndësishme të Dosjes së Tenderit: përvojën në realizimin e punëve të ngjashme për sistemin e osmozës dhe disponueshmërinë e pajisjeve të kërkuara për instalimin dhe testimin e sistemeve të gazrave medicinale sipas standardit DIN EN ISO 7396-1. Këto janë pikërisht dokumentet dhe dëshmitë në të cilat Grupi ynë nuk ka pasur mundësi të ketë qasje të plotë, ndonëse ato janë vendimtare për të verifikuar nëse rekomandimi për kontratë është bërë në përputhje me kërkesat e publikuara.

Rrjedhimisht, në rrethanat konkrete, ekziston dyshim i bazuar dhe i mbështetur në një konstatim të dokumentuar brenda vetë Komisionit të Vlerësimit, se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë mund të mos i ketë përmbushur të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me përvojën në realizimin e punëve të ngjashme për sistemin e osmozës dhe me pajisjet e nevojshme për sistemin e gazrave medicinale sipas standardit DIN EN ISO 7396-1.

Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues ka pasur detyrimin që t'i shqyrtojë dhe t'i trajtojë në mënyrë të arsyetuar këto vërejtje, duke siguruar që rekomandimi për kontratë të mbështetet në dëshmi konkrete dhe në një vlerësim objektiv të të gjitha kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Theksojmë se Grupi ynë nuk po pretendon si fakt përfundimtar se operatori ekonomik i rekomanduar nuk i përmbush kriteret, pasi dokumentacioni përkatës nuk na është vënë në dispozicion për një verifikim të pavarur. Megjithatë, ekzistenca e mendimit të kundërt të një anëtari të Komisionit, së bashku me mungesën e qasjes në dokumentet që lidhen drejtpërdrejt me këto vërejtje, krijon nevojën e domosdoshme për një verifikim të plotë, objektiv dhe transparent.

BAZA LIGJORE E PRETENDIMIT

Në këtë drejtim, neni 10, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik përcaktojnë detyrimin për mbajtjen e dosjes së plotë të aktivitetit të prokurimit, e cila përfshin dokumentet dhe informacionet që lidhen me aktivitetin e prokurimit ose që janë përdorur gjatë zhvillimit të tij.

Neni 10, paragrafi 3, i LPP-së përcakton obligimin e Autoritetit Kontraktues që, pas kërkesës, të sigurojë qasje të menjëhershme dhe të arsyeshme në dosjet e aktivitetit të prokurimit, me përjashtim të dokumenteve që përbëjnë sekret afarist.

Po ashtu, neni 11 i LPP-së përcakton kufijtë e mbrojtjes së informatave sekrete afariste dhe nuk lejon që ky koncept të përdoret në mënyrë të përgjithshme për të penguar transparencën dhe qasjen në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit.

Në të njëjtën linjë, neni 7, paragrafët 4–7, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik rregullon qasjen në dokumentacionin e prokurimit dhe trajtimin e informatave sekrete afariste.

Veçanërisht, paragrafët 7.6.2 dhe 7.6.3 përcaktojnë procedurën konkrete për përgatitjen e versioneve të pastruara të dokumenteve dhe ofrimin e qasjes pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Paragrafi 7.6.3 përcakton se, pas kërkesës për qasje nga operatori ekonomik dhe pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së (B58), Zyrtari i Prokurimit duhet të ofrojë qasje të menjëhershme në versionin e pastruar dhe të mbajë procesverbal, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.

Për më tepër, neni 97, paragrafi 1, nënparagrafi c), i Rregullores Nr. 001/2022 e përcakton si shkelje serioze mohimin dhe/ose neglizhimin e qasjes në dokumentet zyrtare, kur kërkesa për qasje është në përputhje me nenet 10 dhe 11 të LPP-së.

Gjithashtu, zbatimi i këtyre dispozitave duhet të interpretohet në harmoni me Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, i cili garanton të drejtën e qasjes në dokumentet publike dhe përcakton se kufizimet e kësaj të drejte duhet të mbështeten në baza ligjore dhe të arsyetohen në mënyrë konkrete.

KËRKESA LIDHUR ME KËTË PRETENDIM

Duke u bazuar në faktet, argumentet dhe rrethanat e paraqitura, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues:

1. Të na mundësojë qasje të plotë dhe efektive në dokumentacionin e ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

2. Të na vërë në dispozicion dokumentacionin për kualifikimet, licencat, certifikatat, CV-të dhe përvojën profesionale të stafit teknik dhe profesional.

3. Të na mundësojë qasje në kontratat, referencat dhe dëshmitë e punëve të ngjashme të realizuara, me theks të veçantë në dëshmitë që provojnë realizimin e punëve të ngjashme në fushën e osmozës.

4. Të na vërë në dispozicion dëshmitë për posedimin, disponueshmërinë ose sigurimin e pajisjeve dhe instrumenteve të kërkuara për realizimin, testimin dhe verifikimin e instalimeve të gazrave medicinale, përfshirë dokumentacionin përkatës sipas standardit DIN EN ISO 7396-1.

5. Të na mundësojë qasje në dokumentacionin tjetër teknik dhe profesional mbi të cilin është bazuar konstatimi i Autoritetit Kontraktues për përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit.

6. Të trajtojë dhe të japë arsyetim konkret lidhur me vërejtjet e evidentuara në faqen 10 të Raportit të Vlerësimit nga anëtari i Komisionit, z. Pajtim Mustafa, veçanërisht lidhur me mungesën e dëshmive për punët e ngjashme në fushën e osmozës dhe mungesën e dëshmisë për pajisjet e kërkuara sipas standardit DIN EN ISO 7396-1.

7. Në rast se ndonjë pjesë e dokumentacionit konsiderohet sekret afarist, të identifikojë konkretisht dokumentin dhe pjesët e mbrojtura, bazën ligjore të kufizimit dhe të na vërë në dispozicion versionin e pastruar ose përmbledhjen jo-konfidenciale.

8. Të mbajë procesverbal për qasjen në dokumentacion, në përputhje me procedurën e përcaktuar në Rregulloren Nr. 001/2022. Grupi ynë rezervon të drejtën që, pas sigurimit të qasjes në dokumentacionin e plotë, të analizojë dhe të paraqesë pretendime shtesë dhe prova konkrete pranë organeve kompetente të shqyrtimit, nëse nga dokumentacioni rezultojnë mospërmbushje të kritereve të Dosjes së Tenderit ose shkelje të dispozitave ligjore nga Autoriteti Kontraktues.

PRETENDIMI 6

Mangësitë në raportin e vlerësimit – mungesa e arsyetimit të detajuar dhe pamundësimi i verifikimit të ligjshmërisë së vlerësimit të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktues, Grupi ynë ka pranuar edhe një kopje të raportit të vlerësimit të ofertave.

Megjithatë, nga shqyrtimi i këtij dokumenti janë evidentuar mangësi që kërkojnë sqarim dhe verifikim nga Autoriteti Kontraktues.

Në kopjen e raportit të pranuar nuk figurojnë nënshkrimet e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit, ndërsa përmbajtja e tij nuk paraqet në mënyrë të mjaftueshme dhe të detajuar arsyetimin për secilën kërkesë të përcaktuar në Dosjen e Tenderit, në veçanti mënyrën se si është verifikuar dhe konstatuar përmbushja e kërkesave nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë.

Raporti i vlerësimit është një nga dokumentet kryesore të aktivitetit të prokurimit, pasi përmes tij duhet të pasqyrohet procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, dokumentacioni i shqyrtuar, konstatimet e Komisionit të Vlerësimit dhe arsyetimi mbi të cilin është mbështetur rekomandimi për kontratë.

Në këtë kuptim, një raport që nuk paraqet në mënyrë të qartë dhe të verifikueshme arsyetimin për përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit nuk mundëson kontroll efektiv të ligjshmërisë së procesit të vlerësimit. Në veçanti, duke pasur parasysh natyrën teknike të këtij aktiviteti të prokurimit, raporti duhet të mundësojë identifikimin e dokumenteve dhe dëshmive mbi të cilat është mbështetur vlerësimi për stafin profesional dhe teknik, përvojën e ngjashme, pajisjet dhe instrumentet e kërkuara, si dhe kërkesat specifike për instalimet e gazrave medicinale.

Mungesa e një arsyetimi të tillë krijon paqartësi nëse të gjitha kriteret janë kontrolluar në mënyrë të plotë dhe nëse konstatimi për përgjegjshmërinë e operatorit ekonomik të rekomanduar është mbështetur në dëshmi konkrete.

Për më tepër, mungesa e nënshkrimeve në kopjen e raportit të pranuar nuk na mundëson të verifikojmë nëse dokumenti është versioni përfundimtar i raportit, nëse është miratuar nga anëtarët përkatës të Komisionit të Vlerësimit dhe nëse përmbajtja e tij përfaqëson rezultatet përfundimtare të procesit të vlerësimit.

Për këtë arsye, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të sqarojë statusin e raportit të vlerësimit dhe të na vërë në dispozicion versionin e tij të plotë dhe përfundimtar, së bashku me dokumentacionin përkatës që dëshmon miratimin dhe dokumentimin e procesit të vlerësimit. Gjithashtu, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues ta publikojë dhe ta ngarkojë raportin e vlerësimit në platformën elektronike të prokurimit (E-Prokurimi), në përputhje me obligimet ligjore për transparencë dhe publikim të dokumentacionit të aktivitetit të prokurimit. Theksojmë se, deri në momentin e paraqitjes së kësaj kërkese për rishqyrtim, raporti i vlerësimit nuk rezulton të jetë i ngarkuar dhe i publikuar në platformën E-Prokurimi.

Baza ligjore e pretendimit

Neni 10 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik përcakton detyrimin e Autoritetit Kontraktues për mbajtjen e dokumentacionit të plotë të aktivitetit të prokurimit, duke përfshirë dokumentet që janë përdorur dhe prodhuar gjatë zhvillimit të procedurës.

Neni 59 i LPP-së përcakton detyrimin që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të realizohen në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat ligjore. Për rrjedhojë, procesi i vlerësimit duhet të jetë i dokumentuar në mënyrë të tillë që të mund të verifikohen konstatimet dhe arsyetimi mbi të cilin është mbështetur vendimmarrja e Autoritetit Kontraktues.

Po ashtu, neni 40 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik përcakton zbatimin e kritereve të publikuara paraprakisht gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave.

Në këtë drejtim, raporti i vlerësimit duhet të pasqyrojë në mënyrë të qartë dhe të arsyetuar rezultatet e ekzaminimit të ofertave, në mënyrë që të jetë e mundur të verifikohet nëse kriteret janë zbatuar në mënyrë të njëtrajtshme ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë. Kërkesa lidhur me këtë pretendim

Duke u bazuar në sa më sipër, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues:

1. Të na vërë në dispozicion raportin e plotë dhe përfundimtar të vlerësimit të ofertave.

2. Të sqarojë pse kopja e raportit të vënë në dispozicion nuk përmban nënshkrimet e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit.

3. Të na mundësojë verifikimin e dokumentimit dhe miratimit të raportit nga anëtarët përkatës të Komisionit të Vlerësimit. 4. Të ofrojë arsyetimin e detajuar për mënyrën se si është konstatuar përmbushja e secilës kërkesë të Dosjes së Tenderit nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë.

5. Të identifikojë dokumentet dhe dëshmitë konkrete mbi të cilat është mbështetur vlerësimi për stafin profesional dhe teknik, përvojën e ngjashme dhe pajisjet e kërkuara.

6. Të sigurojë që raporti dhe dokumentacioni mbështetës të jenë në dispozicion për verifikimin e ligjshmërisë dhe transparencës së procesit të vlerësimit.

Në përfundim, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të sigurojë transparencë të plotë lidhur me procesin e vlerësimit dhe të dëshmojë se rekomandimi për kontratë është mbështetur në një vlerësim të dokumentuar, objektiv dhe në përputhje me të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit.

IV. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

Që në fillim, theksojmë se mosofrimi i qasjes së plotë në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë ngre dyshime serioze lidhur me transparencën e procesit të vlerësimit dhe me faktin nëse ky operator i përmbush realisht të gjitha kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Pamundësia për të shqyrtuar dokumentacionin e stafit profesional dhe teknik, përvojën e dëshmuar, pajisjet dhe dëshmitë e tjera mbështetëse e bën të pamundur verifikimin e pavarur të bazës mbi të cilën është marrë vendimi për rekomandimin e tij për kontratë. Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues duhet të japë sqarime të plota dhe të sigurojë qasje efektive në dokumentacionin përkatës, në mënyrë që të eliminohen çdo dyshim dhe paqartësi lidhur me rregullsinë e këtij procesi.

Nga faktet, dokumentet dhe argumentet e paraqitura në këtë kërkesë për rishqyrtim rezulton gjithashtu se vendimi i Autoritetit Kontraktues për eliminimin e Grupit të Operatorëve Ekonomikë kërkon një rishqyrtim të plotë dhe objektiv, pasi gjatë procesit të vlerësimit janë evidentuar çështje që tregojnë se dokumentacioni i dorëzuar në ofertë nuk është shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të plotë, të drejtë dhe në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Në mënyrë të përmbledhur, kundërshtimet tona mbështeten në këto çështje kryesore:

Së pari, lidhur me dokumentacionin e z. Suad Bushi, përfshirë certifikatën e MPMS-së dhe certifikatën NEBOSH, dëshmitë përkatëse janë dorëzuar në kuadër të ofertës, por, megjithatë, janë konsideruar gabimisht si dokumentacion i munguar. Për rrjedhojë, kërkohet që këto dokumente të shqyrtohen dhe vlerësohen në përputhje me përmbajtjen e tyre dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Së dyti, lidhur me z. Avni Beqiri, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar një certifikatë shtesë për pozitën përkatëse, ndonëse një kërkesë e tillë nuk rezulton të jetë përcaktuar në Dosjen e Tenderit. Vlerësimi i ofertës duhet të

bëhet mbi bazën e kritereve të publikuara paraprakisht dhe jo përmes vendosjes së kërkesave shtesë gjatë procesit të vlerësimit.

Së treti, lidhur me dokumentacionin e z. Egon Hoti, diploma, certifikata e prodhuesit Medicop, referenca për punët e realizuara dhe dëshmitë e trajnimit profesional janë dokumente që duhej të shqyrtoheshin në tërësi dhe të vlerësoheshin në raport me kërkesat konkrete të Dosjes së Tenderit. Konstatimi për mospërmbushje, pa një analizë të plotë dhe të arsyetuar të këtyre dëshmive, nuk mund të konsiderohet vlerësim i mjaftueshëm i dokumentacionit të paraqitur.

Së katërti, lidhur me shtatë punëtorët teknikë, Autoriteti Kontraktues ka evidentuar mospërputhje në datat e kontratave të punës, pa i analizuar në tërësi dëshmitë e ATK-së dhe dokumentacionin tjetër mbështetës. Vlerësimi i këtij dokumentacioni duhet të bëhet në mënyrë të ndërlidhur, duke marrë parasysh të gjitha provat e dorëzuara dhe jo duke u mbështetur vetëm në një element të veçuar të dokumentacionit.

Së pesti, lidhur me qasjen në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, dokumentacioni i vënë në dispozicion ka qenë i kufizuar dhe nuk ka përfshirë dëshmitë kryesore për verifikimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale, përvojës, stafit dhe pajisjeve të kërkuara. Kjo ka pamundësuar verifikimin e plotë të përmbushjes së kritereve të Dosjes së Tenderit dhe ngre dyshime serioze nëse rekomandimi për kontratë është bërë mbi bazën e një dokumentacioni të plotë dhe të verifikuar.

Së gjashti, lidhur me raportin e vlerësimit, kopja e vënë në dispozicion nuk përmban nënshkrimet e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit dhe nuk ofron arsyetim të mjaftueshëm për mënyrën se si është verifikuar përmbushja e kritereve nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë. Për më tepër, deri në momentin e paraqitjes së kësaj kërkese, raporti nuk rezulton të jetë i publikuar në platformën E-Prokurimi. Këto rrethana kërkojnë sqarimin e statusit të raportit, vënien në dispozicion të versionit të plotë dhe përfundimtar, si dhe publikimin e tij në platformën përkatëse, në përputhje me obligimet ligjore.

Të gjitha këto çështje, të shqyrtuara së bashku, tregojnë nevojën për një rivlerësim të kujdesshëm të procesit të prokurimit, në mënyrë që të sigurohet se vendimi për eliminimin e Grupit tonë dhe rekomandimi për kontratë janë marrë mbi bazën e një vlerësimi të plotë, objektiv, transparent dhe të dokumentuar.

Prandaj, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

☐ Të shqyrtojë dhe rivlerësojë të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga Grupi ynë, duke marrë parasysh dëshmitë konkrete për secilin prej pretendimeve të paraqitura;

☐ Të zbatojë vetëm kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, pa vendosur kërkesa shtesë gjatë procesit të vlerësimit;

☐ Të sigurojë qasje të plotë dhe efektive në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, duke respektuar vetëm kufizimet e lejuara me ligj;

☐ Të sqarojë dhe dokumentojë plotësisht procesin e vlerësimit, përfshirë statusin dhe publikimin e raportit të vlerësimit;

☐ Të rishqyrtojë vendimin e kontestuar dhe, nëse konstaton se eliminimi i Grupit tonë nuk ka qenë i bazuar në vlerësim të drejtë dhe në kërkesat e Dosjes së Tenderit, të anulojë vendimin përkatës dhe ta kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim.

Grupi i Operatorëve Ekonomikë thekson se qëllimi i kësaj kërkese nuk është favorizimi i ofertës sonë, por sigurimi i një procesi të ligjshëm dhe të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, ku çdo ofertë vlerësohet vetëm mbi bazën e kritereve të publikuara dhe të dokumentacionit të dorëzuar.

VV. KËRKESA PËRFUNDIMTARE

Duke u bazuar në faktet, provat materiale dhe argumentet juridike të paraqitura në këtë kërkesë për rishqyrtim, si dhe në kundërshtimet e arsyetuara ndaj vlerësimit të Autoritetit Kontraktues, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues – SHSKUK që:

1. Të aprovojë si të bazuar këtë kërkesë për rishqyrtim.

2. Të anulojë vendimin për eliminimin e Grupit të Operatorëve Ekonomikë EGO ELSA SH.P.K. dhe Horn & Co. Kosova SH.P.K., si vendim i kontestuar për shkak të vlerësimit jo të plotë dhe jo të drejtë të dokumentacionit të ofertës sonë.

3. Të bëjë rishqyrtimin dhe rivlerësimin e ofertës sonë në mënyrë të plotë, objektive dhe të paanshme, duke u bazuar në kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

4. Të rivlerësojë dokumentacionin e dorëzuar për z. Suad Bushi dhe të marrë parasysh certifikatën e MPMS-së, certifikatën NEBOSH dhe dëshmitë e tjera përkatëse, të cilat janë pjesë përbërëse e ofertës së dorëzuar.

5. Të konstatojë se për pozitën e z. Avni Beqiri nuk mund të kërkohet certifikatë shtesë profesionale, nëse një kërkesë e tillë nuk është përcaktuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit, dhe të vlerësojë dokumentacionin e tij në përputhje me kriteret e publikuara.

6. Të rivlerësojë në tërësi dokumentacionin e z. Egon Hoti, duke përfshirë diplomën, certifikatën e prodhuesit Medicop, referencën për punët e realizuara, dëshmitë e përvojës profesionale dhe dokumentacionin e trajnimeve, në raport me kërkesat konkrete të Dosjes së Tenderit.

7. Të rishqyrtojë dokumentacionin e shtatë (7) punëtorëve teknikë, duke analizuar individualisht kontratat e punës, dëshmitë e ATK-së dhe dokumentacionin tjetër mbështetës, në mënyrë që përmbushja e kërkesave të vlerësohet mbi bazën e të gjitha provave të dorëzuara.

8. Të mundësojë qasje të plotë dhe efektive në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, përfshirë dokumentacionin e stafit profesional dhe teknik, dëshmitë e përvojës, pajisjet dhe dokumentet e tjera mbi të cilat është bazuar vlerësimi dhe rekomandimi për kontratë, duke respektuar vetëm kufizimet e lejuara me ligj për informacionin që mund të përbëjë sekret afarist.

9. Të vërë në dispozicion versionin e plotë dhe përfundimtar të raportit të vlerësimit, të sqarojë statusin dhe dokumentimin e miratimit të tij, si dhe ta publikojë dhe ngarkojë atë në platformën elektronike E-Prokurimi, në përputhje me obligimet ligjore për transparencë dhe publikim të dokumentacionit të aktivitetit të prokurimit.

10. Në rast të ekzistimit të paqartësive lidhur me dokumentacionin e dorëzuar nga Grupi ynë, të shqyrtojë mundësinë e zbatimit të dispozitave përkatëse të neneve 59 dhe 72 të LPP-së, brenda kufijve të lejuar ligjorë dhe pa lejuar ndryshimin thelbësor të ofertës.

11. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk e aprovon këtë kërkesë për rishqyrtim, të nxjerrë vendim të plotë dhe të arsyetuar, duke dhënë përgjigje konkrete dhe individuale për secilin pretendim, argument juridik dhe provë materiale të paraqitur në këtë kërkesë.

12. Si rezultat i shqyrtimit të këtyre pretendimeve dhe nëse konstatohen parregullsitë e evidentuara, të anulojë vendimin e kontestuar dhe ta kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Në rast të refuzimit të kësaj kërkese, Grupi i Operatorëve Ekonomikë rezervon të drejtën e ushtrimit të mjeteve të mëtejshme juridike pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Grupi i Operatorëve Ekonomikë mbetet i gatshëm të ofrojë çdo sqarim apo dokumentacion shtesë që mund të kërkohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të shqyrtimit të drejtë dhe të plotë të kësaj çështjeje.

Përgjigje në pretendimin ankimor

Autoriteti Kontraktues SHSKUK, e ka udhëhequr aktivitetin e prokurimit të lartë cekur sipas LPP-së, në përputhje me dispozitat e ligjit ne fuqi dhe kërkesës nga Njësia Kërkuese, për inicimin e procedurës së prokurimit ashtu siç është e paraparë me dispozitat e LPP-së.

Asnjëra nga dispozitat e LPP-së, të cilave u referoheni në pretendimet tuaja, nuk është shkelur. Përkundrazi, AK-SHSKUK i zbaton këto dispozita në tërësi dhe me përpikëri, me qëllim të garantimit të parimit të barazisë në trajtim dhe mos diskriminimit të të gjithë operatorëve ekonomikë ofertues, duke siguruar që procesi i prokurimit të zhvillohet në mënyrë transparente, objektive dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Nuk keni dëshmuar përmes dokumentacionit të dorëzuar se i përmbushni kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Rrjedhimisht, konsideroheni të papërgjegjshëm pasi nuk i përmbushni kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.

Në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar:

Kërkesa 3. Lista e stafit profesional të kompanisë tuaj me të dhënat në vijim Emri , mbiemri , profesioni, eksperienca (vite). a)Menaxheri i projektit Një Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë -Drejtimi Konstruktiv - minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Të jetë i certifikuar për menaxhim projekti. Te kete menaxhuar se paku dy projekte spitalore gjate 3 viteve te fundit. Te kete licensen A. b)Udhëheqës i punishtës Një Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë -Drejtimi Konstruktiv - minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Te jete i certifikuar si specialist per organizimin dhe menaxhimin e punishtes se ndertimit. Te kete licensen A. c)Një inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë – drejtimi Hidroteknikë - minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Te jete i certifikuar për mbrojtje nga zjarri nga AME. Te jete i certifikuar per menaxhim te projekteve. d)Një inxhinier i Elektroteknikes , min 5 vite pervoje pune pas diplomimit. Te jete I certifikuar si ekspert per siguri dhe shendet ne pune nga MPMS dhe per mbrojtje nga zjarri nga AME. e)Një inxh i diplomuar i Makinerisë - master, drejtimi termoenergjetike,. Te jete i certifikuar nga ndonje prodhues per termo pompa dhe chiller, me min 2 vite pervoje pune pas certifikimit. f) Nje master i shkencave teknike , drejtimi arkitekture, min 5 vite pervoje pune pas diplomimit. h) Nje master i hidroteknikes, i certifikuar për trajtimin e mbetjeve te rrezikshme inerte, min 2 vite përvoje pune pas certifikimit. i) Nje master i emergjencave min 5 vite pervoje pune,Certifikatë – për njohurite dhe aftesite për shendet, siguri dhe mjedis ne punë (Health, Safety and Environment – HSE) dhe si ekspert për shendet dhe siguri ne punë nga MPMS.j) Nje master i shkencave teknike min 5 vite pervoje pune, k) Një bachelor i makinerisë –Të jetë i certifikuar nga prodhuesi per instalim dhe testim te sistemit te gazrave medicinale sipas standardit ISO 7396-1, minimum 3 vite përvojë pune pas certifikimit. Te jete i certifikuar si ekspert per shendet dhe siguri ne pune nga nje kompani e licensuar nga MPMS.

Ndërsa ju nuk e keni ofruar Certifikatën sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes se tenderit:

i.Nje master i emergjencave min 5 vite pervoje pune,Certifikatë – për njohurite dhe aftesite për shendet, siguri dhe mjedis ne punë (Health, Safety and Environment – HSE) dhe si ekspert për shendet dhe siguri ne punë nga MPMS.j) Nje master i shkencave teknike min 5 vite pervoje pune, k) Një bachelor i makinerisë –Të jetë i certifikuar nga prodhuesi per instalim dhe testim te sistemit te gazrave medicinale sipas standardit ISO 7396-1, minimum 3 vite përvojë pune pas certifikimit. Te jete i certifikuar si ekspert per shendet dhe siguri ne pune nga nje kompani e licensuar nga MPMS.

-AK-SHSKUK- nuk e konteston dokumentacionin për pozitën e Masterit të Emergjencave – Suad Bushi, por vlerëson se Suad Bushi nuk e posedon çertifikates HSE (Health, Safety and Environment) siç është kërkuar në

dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Çertifikatën NEBOSH e prezantuar për të lartë përmendurin është larguar nga dosja e tenderit dhe njoftimi për kontratë, pas një kërkese për rishqyrtim të parashtruar nga një operator ekonomik para hapjes se ofertave me pas ka ndodhur ndryshimi sipas hapit B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara i datës 28.08.2026 ku është larguar kjo certifikatë si dëshmi. Dëshmitë tjera nuk i konteston AK-SHSKUK, andaj pretendimi nuk qëndron dhe është i pa bazuar.

Në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar:

Kërkesa 4. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë Stafin Teknik (mbështetës, Ku min 15 punëtorë duhet të jenë të trajnuar për shëndet dhe siguri në punë sipas Ligjit Nr. 04 L-161. 3.1 Minimum nje (1) teknik të elektros. 3.2 Minimum nje (1) murator. 3.4 Minimum dy (2) punëtor të certifikuar për ujësjellës. 3.5 Minimum dy (2) punëtor të certifikuar për montimin e konstruksioneve të thata. 3.6 Minimum një (1) Teknik të ndërtimtarisë.

3.8 Minimum dy (2) punëtorë të certifikuar për shtrim dhe veshje pllakave. 3.7 Minimum dy (2) saldues të certifikuar me TIG sipas standardit ISO 9606-1 2017-12 me 2 vite pervoje pune pas certifikimit nga një institucion I akreditуar sipas EN ISO IEC 17024 2012. 3.8 Minimum dy (2) punëtor të certifikuar nga prodhuesi per instalim dhe testim te sistemit te gazrave medicinale sipas standardit ISO 7396-1 me 3 vite pervoje pune pas certifikimit. 3.9 Minimum një (1) punëtor të certifikuar nga prodhuesi për hidroizolime. 3.10 Minimum nje (1) teknik për instalim të ngrohjes dhe klimatizimit 3.11 Minimum nje (1) punetor I certifikuar nga prodhuesi per inventar te specializuar laboratorik

Nuk kemi ofruar kontratat sipas kërkesës së njoftimit për kontratë dhe dosës se tenderit:

Kontratat e ofruara në ofertë për punëtorët si në vijim:

Për punëtorin, Fadil Hoti në kontratën e ofruar të pika: Data e fillimit të punëve është: 12.01.2021 ndërsa e nënshkruar me date 20.02.2026 andaj kemi një mos përputhje ne mes te fillimit te punëve dhe nënshkrimit te kontratës një diferencë 5 vjeçare.

-AK-SHSKUK konstaton se në kontratën e punës të punëtorit Fadil Hoti, data e fillimit të marrëdhënies së punës nuk është në përputhje me datën e nënshkrimit të kontratës çka paraqet mospërputhje në dokumentacionin e dorëzuar.

Për punëtorin, Valton Aliun në kontratën e ofruar të pika: Data e fillimit të punëve është: 01.10.2024 ndërsa e nënshkruar me date 20.02.2026 andaj kemi një mos përputhje ne mes te fillimit te punëve dhe nënshkrimit te kontratës një diferencë afër 2 vjeçare.

-AK-SHSKUK konstaton se në kontratën e punës të punëtorit Valton Aliun, data e fillimit të marrëdhënies së punës nuk është në përputhje me datën e nënshkrimit të kontratës çka paraqet mospërputhje në dokumentacionin e dorëzuar.

Për punëtorin, Avni Hoti në kontratën e ofruar të pika: Data e fillimit të punëve është: 01.01.2024 ndërsa e nënshkruar me date 20.02.2026 andaj kemi një mos përputhje ne mes te fillimit te punëve dhe nënshkrimit te kontratës një diferencë 2 vjeçare.

-AK-SHSKUK konstaton se në kontratën e punës të punëtorit Avni Hoti, data e fillimit të marrëdhënies së punës nuk është në përputhje me datën e nënshkrimit të kontratës çka paraqet mospërputhje në dokumentacionin e dorëzuar.

Për punëtorin, Fledi Hoti në kontratën e ofruar të pika: Data e fillimit të punëve është: 18.06.2022 ndërsa e nënshkruar me date 20.02.2026 andaj kemi një mos përputhje ne mes te fillimit te punëve dhe nënshkrimit te kontratës një diferencë prej afër 4 vjeçare.

-AK-SHSKUK konstaton se në kontratën e punës të punëtorit Fledi Hoti, data e fillimit të marrëdhënies së punës nuk është në përputhje me datën e nënshkrimit të kontratës çka paraqet mospërputhje në dokumentacionin e dorëzuar.

Për punëtorin, Egon Hoti në kontratën e ofruar të pika: Data e fillimit të punëve është: 22.10.2020 ndërsa e nënshkruar me date 20.02.2026 andaj kemi një mos përputhje ne mes te fillimit te punëve dhe nënshkrimit te kontratës një diferencë prej afër 5 vjeçare.

-AK-SHSKUK konstaton se në kontratën e punës të punëtorit Egon Hoti, data e fillimit të marrëdhënies së punës nuk është në përputhje me datën e nënshkrimit të kontratës çka paraqet mospërputhje në dokumentacionin e dorëzuar.

Për punëtorin, Besian Murati në kontratën e ofruar të pika: Data e fillimit të punëve është: 01.01.2024 ndërsa e nënshkruar me date 01.08.2024 andaj kemi një mos përputhje ne mes te fillimit te punëve dhe nënshkrimit te kontratës një diferencë prej 7 muaj.

-AK-SHSKUK konstaton se në kontratën e punës të punëtorit Besian Murati, data e fillimit të marrëdhënies së punës nuk është në përputhje me datën e nënshkrimit të kontratës çka paraqet mospërputhje në dokumentacionin e dorëzuar.

Për punëtorin, Ferid Shabani në kontratën e ofruar të pika: Data e fillimit të punëve është: 01.10.2024 ndërsa e nënshkruar me date 01.01.2024 andaj kemi një mos përputhje ne mes te fillimit te punëve dhe nënshkrimit te kontratës.

-AK-SHSKUK konstaton se në kontratën e punës të punëtorit Ferid Shabani, data e fillimit të marrëdhënies së punës nuk është në përputhje me datën e nënshkrimit të kontratës çka paraqet mospërputhje në dokumentacionin e dorëzuar.

Dëshmit tjera për stafin e larcekur nuk i konteston AK-SHSKUK, andaj pretendimi nuk qendron dhe është i pa bazuar.

Sa i përket qasjes në dokumentat zyrtare OE ankues me datë 13.11.2026 nëpër mes platëformes e-prokurimi ka kërkuar qasjen ne dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë, AK-SHSKUK ka aprovuar kërkesën për qasje në ofertën e Grup i Operatorëve Ekonomik të rekomanduar në këtë aktivitet të prokurimit, juve si Grup i Operatorëve Ekonomik ofertues ju është lejuar qasje me dt. 17.11.2026, ora 9:00-11:00, po për shkak të vëllimit të ofertës se Grup i Operatorëve Ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit, luteni që të vini fizikisht në zyrat tona të terheqeni oferten e Grup i Operatorëve Ekonomik për këtë aktivitet të prokurimit në form elektronike me USB.

Rrjedhimisht OE ankues, më datë 17.11.2026 ka pranuar dokumentacionin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë pranë AK-SHSKUK-së, me përjashtim të dokumenteve për të cilat OE i rekomanduar përmes kërkesës për trajtim konfidencial ka kërkuar që të ruhen si sekrete afariste me arsyetimin se publikimi i tyre mund t'i shkaktojë dëme në ushtrimin e veprimtarisë së tij ekonomike.

Kjo dëshmohet edhe me procesverbalin e nënshkruar nga pranuesi i dokumentacionit këtë rast nga OE ankues.

PROCESVERBAL

Në bazë të kërkesës për qasje në dokumenta zyrtare per tenderin me titull **Renovimi I Objektit të Hemodializës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës** ref nr :**220-26-7028-5-1-1** dhe nr. I brendshëm: **220-26-072-5-1-1** kërkesa e deponuar me date **13.11.2026** e ngarkuar në platformen E-Prokurimi nga **Operatori Ekonomik Grup i Operatorëve Ekonomik EGO ELSA SH.P.K.; Horn & Co. Kosova SH.P.K., Rruga e Pejes, pn , Llapllaselle, 10000, Kosove**
Zyra e prokurimit e SHSKUK-së neper mjet sisitemit e-prokurimit lejon qasjen në dokumentat e këtij tenderi ne fjal.

Operatori Ekonomik Grup i Operatorëve Ekonomik EGO ELSA SH.P.K.; Horn & Co. Kosova SH.P.K., Rruga e Pejes, pn , Llapllaselle, 10000, Kosove ka shprehur interesim qe shkresat e lëndës për aktivitetin e prokurimit në fjalë ti merr për Gr.OE e rekomanduar për këtë aktivitet të prokurimit ne kopje elektronike USB.
Dokumentet që janë tërhequr në kopje elektronike:
Për OE: Grup i Operatorëve Ekonomik HARST Group SH.P.K.; HEXAGON CONSTRUCTION SH.P.K., Harstgroup, 23000, Suharekë

1.Certifikata e Biznesit & TVSH,
2. Vertetimet Gjykata Komerciale, Denimet Penale, ATK, për Grup i Operatorëve Ekonomik,
3. Certifikata e HARST,
4. Dek. nen Betim, kërkesa për konfidencialitet
5. Marrveshja Konzorciumit,
6. Sigurimi i tenderit,
7. Vertetimi ATK-Harts,
8. Vertetimi i Gjykates-Hartes,
9.Raporti i vlerësimit,
10.Plani Dinamik,
11. Oferta Financiare,
12. Aneksi 1, Specifikat Teknike,
13.FDT,

Grupi i operatorëve ekonomikë (Gr. OE), i rekomanduar për dhënie të kontratës, në ofertën e tij ka kërkuar nga Autoriteti Kontraktues – SHSKUK që dokumentet e dorëzuara në përputhje me nenet 68 dhe 69 të LPP-së të trajtohen si sekret tregtar.

OE: EGO ELSA SH.P.K.; Horn & Co. Kosova SH.P.K., Rruga e Pejes, pn , Llapllaselle, 10000, Kosove

Date: 17.11.2026

Prishtinë

Kërkesa për konfidencialitet e prezantuar në Ofertë nga Gr. i OE se rekomanduar per kontratë:

Numri i Prokurimit: 220-26-7028-5-1-1 - Titulli Renovimi i Objektit të Hemodializës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës

Aneksi 3 KËRKESA PËR SEKRET AFARIST

Për: SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS
(më tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PASUR PARASYSH SE *[HARST Group SH.P.K.]* (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

> *Identifikimi i informacioneve sekrete afariste dhe referimi në pjesët e dokumenteve të dërguara: I GJITHË DOKUMENTACIONI I TENDERIT SIPAS NENIT 68 DHE 69 TË LIGJIT TË PROKURIMIT PUBLIK*

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informatat e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë pronë publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e operatorit ekonomik ;

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik për arsyet vijuese:

> *Deklarate mbi natyrën e dëmit të tillë material dhe arsyet pse do të duhej të shfaqet:*
> *KËRKOJM NGA AK QE I GJITHË DOKUMENTACIONI I TENDERIT SIPAS NENIT 68 DHE 69 TË KLASIFIKOHET SI SEKRET AFARIST DHE MOS TË NDAHET ME ASKJË PALË TJETËR SIÇ PËRCAKTOHET ME LIGJIN E PROKURIMIT PUBLIK NENI 11.*
>
> *SHFAQJA E KETYRE INFORMACIONEVE TE PALET TJERA DO TË NA SHKAKTONTE DËME MATERIALE DHE MORALE NGA MUNDËSIA E KEQPËRDORIMIT TE DOKUMENTACIONIT DHE INFORMACIONIT TË KOMPANISË TONE*

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj shpreh dëshirën që Autoriteti Kontraktues t'i klasifikojë dhe mirëmbajë informacionet e përmendura si informacione sekrete afariste.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i Kompanisë:	HARST Group SH.P.K.
Adresa e plotë:	Rr. 7 Marsi p.n. - Suharekë
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Sadik Ramadani
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	01.10.2026
Vula:	

Numri i Prokurimit: **220-26-7028-5-1-1** - Titulli **Renovimi i Objektit të Hemodializës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës**

Aneksi 3 KËRKESA PËR SEKRET AFARIST

Për: **SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**
(më tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PASUR PARASYSH SE *[Hexagon Construction SH.P.K.]* (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të siper-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

Identifikimi i informacioneve sekrete afariste dhe referimi në pjesët e dokumenteve të dërguara: I GJITHË DOKUMENTACIONI I TENDERIT SIPAS NENIT 68 DHE 69 TE LIGJIT TË PROKURIMIT PUBLIK

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informatat e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë pronë publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e operatorit ekonomik ;

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik për arsyet vijuese:

Deklarate nbi natyrën e dëmit të tillë material dhe arsyet pse do të dukej ie shfaqet: KERKOJM NGA AK QË I GJITHË DOKUMENTACIONI I TENDERIT SIPAS NENIT 68 DHE 69 TË KLASIFIKOHET SI SEKRET AFARIST DHE MOS TË NDAHET ME ASNJË PALË TJETER SIÇ PËRCAKTOHET ME LIGJIN E PROKURIMIT PUBLIK NENI 11.

SHFAQJA E KETYRE INFORMACIONEVE TE PALET TJERA DO TË NA SHKAKTONTE DËME MATERIALE DHE MORALE NGa MUNDËSIA E KEQPËRDORIMIT TE DOKUMENTACIONIT DHE INFORMACIONIT TË KOMPANISË TONË

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj shpreh dëshirën që Autoriteti Kontraktues t'i klasifikojë dhe mirëmbajë informacionet e përmendura si informacione sekrete afariste.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i Kompanisë:	Hexagon Construction SH.P.K.
Adresa e plotë:	Rr. Brigada 123 p.n. - Suharekë
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Zenun Alimusaj
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	01.10.2026
Vula:	

Grupi i Operatorëve Ekonomikë (GOE) i rekomanduar për kontratë ka ofruar ofertën e përgjegjshme me çmimin më të ulët duke dëshmuar njëkohësisht përvojën e suksesshme në realizimin e kontratave për objekte të kategorisë spitalore në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.

Bazuar në arsyet e lartcekura, Autoriteti Kontraktues – SHSKUK e refuzon në tërësi kërkesën për rishqyrtim si të **pabazuar**.

Pala e pakënaqur ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Me respekt

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

LISTA E PAGAVE PËR KOMPANINË

ATK-KS\drgashi

10/8/2026 12:59:09 PM

NR FISKAL	811469833
EMRI I KOMPANISË	EGO ELSA
ADRESA	Rruga e Pejes, p.n
LLOJI I BIZNESIT	SH.P.K.
QENDRA TATIMORE	PRISHTINË 3
VITI	2025

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije
Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit ATK
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 1846/2026
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: 2
Data / Datum / Date: 08.10.2026
Dërguese O.SH.T PRISHTINË

					MUAJT											
NR	EMRI	MBIEMRI	NR PERSONAL	PRIM	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	ANJEZA	BRUÇI	1172864585	PO	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2	ARTON	SEJDIU	2173908477	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
3	AULONË	HASANI	1232640258	PO	-	-	-	-	-	-	-	+	+	+	+	+
4	AVNI	KALINA	1014174806	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
5	AVNI	BEQIRI	1001772704	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
6	AVNI	SHABANI	1012468853	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
7	AZA	HOTI	1004080943	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
8	BARDHOK	JETISHI	1013250592	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
9	BESIAN	MURATI	1249900563	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
10	EGON	HOTI	1248101357	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
11	ENDRIT .	MURATI	1247539855	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
12	FADIL	HOTI	1004080897	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
13	FATON	NISHEVCI	1004304116	JO	-	-	+	-	-	-	-	-	-	-	-	-
14	FERID	SHABANI	1173908527	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
15	FLEDI	HOTI	1248953639	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
16	GAZMEND	NISHEVCI	1003887916	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
17	HEKURAN	ADEMI	1242157199	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
18	ILIR	HASANI	1001437387	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
19	ILIRJANA	GASHI	1030859363	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
20	JAHIR	MORINA	1173767265	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
21	KUSHTRIM	SHABANI	1235217682	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
22	LEUTRIM	ZEQIRI	1172285283	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
23	MIMOZA	DUGOLLI	1001079553	JO	-	-	-	-	-	-	+	+	+	+	+	+
24	NDERIM	BAJRAMI	1231538166	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+

					MUAJT											
NR	EMRI	MBIEMRI	NR PERSONAL	PRIM	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
25	NEHAT	HAVOLLI	1004240312	PO	-	-	-	-	-	-	-	+	+	+	+	+
26	RREZART	POTERA	1250438849	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
27	VALDRIN	POTERA	1248080244	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+
28	VALTON	ALIU	1243484819	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E FINANCAVE • MINISTARSTVO ZA FINANSIJE • MINISTRY OF FINANCE
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVES • PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA • TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
OSHT PRISHTINE

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

LISTA E PAGAVE PËR KOMPANINË

ATK-KS\drgashi

10/8/2026 12:59:31 PM

NR FISKAL	811469833
EMRI I KOMPANISË	EGO ELSA
ADRESA	Rruga e Pejes, p.n
LLOJI I BIZNESIT	SH.P.K.
QENDRA TATIMORE	PRISHTINË 3
VITI	2026

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije
Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosova
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE
Njësia Organ. / Org. jedin. / Org. Unit: ATK
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No: 1846/2026
Nr. Faqeve / Broj stranica / No. pages: 2
Data / Datum / Date: 08.10.2026
Dërguese: Q.SH.T. PRISHTINË

					MUAJT											
NR	EMRI	MBIEMRI	NR PERSONAL	PRIM	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	ARTON	SEJDIU	2173908477	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
2	AULONË	HASANI	1232640258	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
3	AVNI	KALINA	1014174806	PO	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-	-	-
4	AVNI	BEQIRI	1001772704	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
5	AVNI	SHABANI	1012468853	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
6	AZA	HOTI	1004080943	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
7	BARDHOK	JETISHI	1013250592	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
8	BESIAN	MURATI	1249900563	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
9	EGON	HOTI	1248101357	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
10	ENDRIT	MURATI	1247539855	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
11	FADIL	HOTI	1004080897	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
12	FATON	NISHEVCI	1004304116	JO	-	-	+	+	+	+	-	-	-	-	-	-
13	FERID	SHABANI	1173908527	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
14	FLEDI	HOTI	1248953639	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
15	GAZMEND	NISHEVCI	1003887916	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
16	HEKURAN	ADEMI	1242157199	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
17	ILIR	HASANI	1001437387	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
18	ILIRJANA	GASHI	1030859363	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
19	JAHIR	MORINA	1173767265	JO	-	-	-	-	-	-	+	+	-	-	-	-
20	JAHIR	MORINA	1173767265	PO	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-	-	-
21	KUSHTRIM	SHABANI	1235217682	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
22	LEUTRIM	ZEQIRI	1172285283	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
23	NEHAT	HAVOLLI	1004240312	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
24	RREZART	POTERA	1250438849	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-

					MUAJT											
NR	EMRI	MBIEMRI	NR PERSONAL	PRIM	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
25	VALDRIN	POTERA	1248080244	PO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-
26	VALTON	ALIU	1243484819	JO	+	+	+	+	+	+	+	+	-	-	-	-

Gmail Egon Hoti <egoelsa.shpk@gmail.com>

Njoftim
1 message

Egon Hoti <egoelsa.shpk@gmail.com> Wed, Nov 18, 2026 at 3:08 PM
To: Ekrem Fetahu <ekrem.fetahu@rks-gov.net>
Cc: Muhamet Behra <muhametbehra1@gmail.com>, Elvir.Azizi@rks-gov.net, arben.vitia@rks-gov.net

Të nderuar,

Duke pasur parasysh shqetësimet e ngritura dhe të elaboruara në kërkesën tonë për rishqyrtim, lidhur me procesin e vlerësimit dhe rekomandimit për dhënie të kontratës, dëshirojmë t'ju njoftojmë se konsiderojmë se qasja në dokumentacionin zyrtar të këtij aktiviteti të prokurimit është e domosdoshme për të garantuar transparencën dhe për të mundësuar verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve të Autoritetit Kontraktues.

Në këtë drejtim, duke pasur parasysh se Ligji për Prokurimin Publik parasheh detyrimin e operatorit ekonomik që, në rast se kërkon mbrojtjen e informacioneve si sekret afarist, të paraqesë deklaratën përkatëse dhe të identifikojë e arsyetojë informacionet që pretendon se duhet të mbrohen, konsiderojmë se kemi të drejtë legjitime të njihemi me këtë arsyetim.

Prandaj, kërkesa jonë muk ka të bëjë vetëm me qasjen në dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, por në mënyrë të veçantë edhe me qasjen në deklaratën për sekret afarist dhe arsyetimin konkret të paraqitur nga ky operator ekonomik, mbi bazën e të cilit është kërkuar që dokumente apo pjesë të caktuara të ofertës së tij të mos bëhen të qasshme për operatorët e tjerë ekonomikë.

Theksojmë se nuk po kërkojmë zbulimin e informacioneve që ligjërisht përbëjnë sekret afarist, por kërkojmë të njihemi me bazën dhe arsyetimin mbi të cilin është mbështetur ky pretendim, në mënyrë që të mund të vlerësojmë nëse kufizimi i qasjes është bërë në përputhje me kërkesat ligjore dhe nëse është zbatuar në mënyrë proporcionale.

Në rast se një pjesë e dokumentacionit përmban informacione të mbrojtura, kërkojmë që ato të redaktohen, ndërsa pjesa tjetër e dokumentacionit të na vihet në dispozicion.

Duke pasur parasysh rrethanat e ngritura në kërkesën tonë për rishqyrtim, ju lutemi që kësaj kërkese t'i kushtoni vëmendjen e duhur dhe të na mundësoni qasjen në dokumentacionin e kërkuar në formë elektronike.

Me respekt,
EGO ELSA SHPK

P.S. Ne attach gjeni kerkesen per rishqyrtim.

--

Egon Hoti
Mechanical Engineer
EGO ELSA SH.P.K.

Prishtine, Kosove
Tel: +383 49 230122

www.egoelsa.com

Banka për Biznes
RR. UKSHIN HOTI, NR. 128,
10000, Prishtinë
+383 38 620620
+383 38 620620
informata@bpbbank.com
www.bpbbank.com

Transaction Overview — Status: Approved

Transaction date	23.11.2026 16:22:58
Transaction ID	77702317685002
Ordering party	EGO ELSA SHPK
Ordering party account	1307001003043952EUR
Ordering party address	RRUGA E PEJES PN LLAPLLASELLE PRISHTINE
Beneficiary	Organi Shqyrtues I Prokurimit
Beneficiary account	1000430070005756
Beneficiary address	N/A
Transaction details	PPQDD1111111111H Organi Shqyrtues I Prokurimit-Pagese per depozit per sigurim te
Info	EGO ELSA SHPK
Purpose code	Pagesa Institucionale
Amount	9.000,00 EUR

23.11.2026 04:23:12 PM
Confirmed

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOSOVËS / SKUPŠTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PROCUREMENT REVIEW BODY

UNIREF

PPQDD1111111111H

PAGESE PËR DEPOZITË PËR SIGURIM TË ANKESËS
PLAĆANJE ZA SIGURNOST DEPOZITA ŽALBE
PAYMENT FOR THE SECURITY DEPOSIT OF THE COMPLAINT

Të dhënat e OE Podaci EO EO data	**EGO ELSA SH.P.K., Rruga e Pejes, pn , Llapllaselle, 10500 Kosove**
Përshkrimi Opis Description	**Renovimi i Objektit të Hemodializës në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës**
Numri i prokurimit Broj nabavke Procurement number	**220-26-7028-5-1-1**

Shuma / Iznos
Ammount

€ 9000 Euro 00 Ct Data / Datum / Date

Me fjalë / Rečima
In words

Xhirollogaria
Broj žiroračuna
Bank account

1 0 0 0 4 3 0 0 7 0 0 0 5 7 5 6

Lëshuar nga
Izdato od /
Issued by

OSHP

Nënshkrimi dhe vula e bankës
Potpis i pečat banke
Bank signature and stamp

14.2 Ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarife te ankesave ne OSHP. a. Kurdo qe ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërblim te një kontrate, shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) te vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro. b. Kurdo qe aneksa nderlidhet me njoftimin për kontratë, dokumentet e tenderit, shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) te vlerës se parashikuar, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.	14.2 U skladu sa članom 118 ZJN, svi podnosioci žalbe moraju platiti žalbu u TRN. a. Kad god se žalba odnosi na odluku o dodeli ugovora, iznos žalbene naknade iznosi jedan procenat (1%) od vrijednosti ponude, ali ne manje od 100 € i ne više od 5.000 €. b. Kad god se aneks odnosi na obaveštenje o ugovoru, tenderska dokumentacija, iznos naknade za žalbu iznosi jedan procenat (1%) od procenjene vrednosti, ali ne manje od 100 evra i ne više od 5.000 evra.